



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR 2025

Prishtinë, mars 2026

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu, (Ndërtesa is Fazita), kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

FJALA HYRËSE

Të nderuar,

Kam nder të veçantë që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqes Raportin vjetor të aktiviteteve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe të sektorit të energjisë që janë zhvilluar gjatë vitit 2025. Ky raporti vjetor është hartuar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe konform dispozitave ligjore i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim, shqyrtim e miratim.

Raporti paraqet një pasqyrë detale të aktiviteteve të zhvilluara dhe arritjeve kryesore të ZRRE-së, si edhe të sektorit të energjisë gjatë vitit kalendarik 2025, si dhe raportin financiar. Raporti përmban të dhëna dhe informacione të detajuara për veprimtarinë e ZRRE-së, për ngjarjet më të rëndësishme për tregun e energjisë, shqyrtimin e tarifave të energjisë, raportin financiar të ZRRE-së, si dhe të dhëna për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

ZRRE është agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku aktivitetin e saj e ka në fokus të sigurisë së furnizimit me energji me çmime të përballueshme, mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë, si dhe funksionimin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve të energjisë.

Në përputhje me detyrimet dhe kompetencat e saj ligjore dhe rregullatore, ZRRE si çdo vit tjetër edhe gjatë vitit 2025, ka ndikuar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë së furnizimit me energji dhe funksionimin e drejtë të tregut të energjisë.

Viti 2025 është shënuar me arritje të lartë të punës së mirë dhe profesionale të ZRRE, dhe kjo e arritur është evidentuar edhe në Raportin vjetor të zbatimit për vitin 2025 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në raportin e saj vjetor ka vlerësuar lartë punën e mirë dhe profesionale të ZRRE në zbatimin e detyrave që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe obligimeve ndërkombëtare, ku duhet veçuar menaxhimi i mirë i sigurisë së furnizimit, liberalizimi i tregut të energjisë, aprovimi i tarifave të energjisë elektrike e cila ka sjell stabilitet në sektorin e energjisë, funksionalizimi i mirë i bursës shqiptare të energjisë elektrike ALPEX dhe bashkimin e tregjeve Kosovë – Shqipëri, ndërmarrjen e veprimeve për nxitjen e investimeve në Burimet e Ripërtrishme, promovimin në mënyrë aktive të vet-konsumatorëve, si dhe aprovimin e shumë aktiviteteve tjera të cilat kanë qenë mëse të nevojshme që sektori i energjisë elektrik të jetë stabil dhe i qëndrueshëm.

Gjatë këtij viti, një ndër zhvillimet më të rëndësishme ishte vazhdimi i procesit të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke krijuar kushte më të favorshme për konkurrencë të ndershme, rritje të efikasitetit dhe zgjedhje më të mëdha për konsumatorët. Ky proces përbën një hap thelbësor drejt ndërtimit të një tregu të hapur dhe funksional, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Duhet theksuar se vetëm për një periudhë gjashtëmujore të procesit të vazhdimit të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, 8 furnizues të energjisë elektrike kanë qenë aktiv dhe kanë nënshkruar kontrata me konsumatorë.

Një arritje tjetër me rëndësi të veçantë është pranimi i ZRRE në Shoqatën e Entiteteve Lëshuese të Certifikatave të Origjinës), duke u bërë pjesë e platformës evropiane për Garancitë e Origjinës. Kosova adopton Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), duke siguruar që Garancitë e Origjinës të lëshuara në Kosovë të njihen në të gjithë Evropën. Kjo rrit transparencën dhe besueshmërinë e

certifikimit të energjisë së ripërtëritshme, duke mundësuar tregti ndërkufitare më efikase dhe duke hapur rrugë për investime të reja në sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Anëtarësimi gjithashtu konfirmon përkushtimin e Kosovës për harmonizim me Acquis Communautaire të BE-së dhe për integrim më të thellë në mekanizmat evropianë të energjisë dhe klimës.

Në vazhden e angazhimit për mbështetjen e energjisë së gjelbër, ZRRE ka hartuar dhe miratuar Rregullën për Mekanizmin Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Kjo rregullore paraqet një reformë nga modelet tradicionale të mbështetjes në një mekanizëm modern, të integruar me tregun dhe të qëndrueshëm financiarisht. ZRRE është vlerësuar lartë nga Energy Regulators Regional Association (ERRA) në kuadër të publikimit “Regulatory Story of the Quarter”, për reformimin e Mekanizmit Mbështetës për Energjinë e Ripërtëritshme në Kosovë.

Gjithashtu në vazhden e avancimit të ZRRE në arenën ndërkombëtare, duhet përmendur pranimin e ZRRE-së në Balkan Energy School, një platformë e rëndësishme për zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e përvojave në rajon. Ky anëtarësim dëshmon përkushtimin e ZRRE për ngritjen e kapaciteteve dhe për ndërtimin e një institucioni gjithnjë e më të avancuar dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Të gjitha këto arritje janë rezultat i punës së përkushtuar të stafit të ZRRE-së, bashkëpunimit të ngushtë me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe vizionit të përbashkët për një sektor energjetik të zhvilluar dhe të qëndrueshëm, ndaj në emrin tim dhe anëtarëve tjerë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, dua të shpreh mirënjohje ndaj të gjithë personelit të ZRRE dhe të sektorit të energjisë, për punën dhe përkushtimin e tyre në ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, gjatë këtij viti.

Për fund, ZRRE mbetet e përkushtuar në rrugën drejt një tranzicioni energjetik, në përputhje me synimet drejt integritimit në tregun evropian të energjisë, duke vendosur konsumatorin e energjisë në qendër të saj.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu,

Kryesues i Bordit

PËRMBAJTJA

| | | |
|----------|---|-----------|
| 1 | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 9 |
| 2 | ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI | 12 |
| 2.1 | Bordi i Rregullatorit..... | 12 |
| 2.2 | Struktura organizative dhe burimet njerëzore | 13 |
| 2.3 | Financimi i Rregullatorit..... | 17 |
| 3 | AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI | 18 |
| 3.1 | Licencimi i aktiviteteve të energjisë..... | 18 |
| 3.2 | Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë | 30 |
| 3.3 | Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)..... | 35 |
| 3.4 | Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja | 36 |
| 3.5 | Gjeneratorët për vetë-konsum | 39 |
| 3.6 | Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese | 41 |
| 3.7 | Integrimi i tregut | 42 |
| 3.8 | Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve | 46 |
| 3.9 | Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve | 62 |
| 4 | BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA | 69 |
| 4.1 | Përfshirja e Publikut në proceset rregullative përmes Konsultimeve Publike | 69 |
| 4.2 | Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës | 71 |
| 4.3 | Takimet me palët e tjera të interesit | 71 |
| 4.4 | Takimet e Grupit të Implementimit në kuadër të iniciativës për bashkimin e tregjeve SEE - MC..... | 73 |
| 4.5 | Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare | 74 |
| 4.6 | Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare | 75 |
| 4.7 | Aktivitetet e prokurimit | 81 |
| 5 | RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN | 82 |
| 5.1 | Të hyrat | 82 |

| | | |
|----------|---|------------|
| 5.2 | Buxheti | 82 |
| 5.3 | Shpenzimet buxhetore..... | 83 |
| 6 | SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE | 87 |
| 6.1 | Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike..... | 87 |
| 6.2 | Burimet primare të energjisë..... | 91 |
| 6.3 | Prodhimi i energjisë elektrike | 92 |
| 6.4 | Sistemi i transmetimit..... | 97 |
| 6.5 | Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike..... | 107 |
| 6.6 | Furnizimi me energji elektrike | 119 |
| 6.7 | Importi dhe eksporti i energjisë elektrike..... | 124 |
| 6.8 | Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike | 127 |
| 6.9 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Shoqëria Elektrosever” SHPK..... | 142 |
| 6.10 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Korporata Energjetike Kosovës” SH.A 145 | |
| 6.11 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “VoltKos” SHPK..... | 147 |
| 6.12 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Enerco” SHPK | 149 |
| 6.13 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “EDS International KS” | 150 |
| 6.14 | Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” SH.P.K” | 152 |
| 6.15 | Të dhënat e raportuara nga NQ Termokos..... | 152 |
| 6.16 | Të dhënat e raportuara nga NQ Gjakova..... | 153 |
| 7 | SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE | 154 |
| 7.1 | Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike | 154 |
| 7.2 | Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike | 155 |
| 7.3 | Performanca e ndërmarrjeve të energjisë termike | 160 |
| 7.4 | Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes | 164 |

Lista e shkurtesave

| | |
|--------------------|---|
| AIT | Average Interruption time (Koha mesatare e ndërprerjes) |
| ALPEX | Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike |
| AQP | Agjencia Qendrore e Prokurimit |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BRE | Burimet e Ripërtërithme të Energjisë |
| CCP | Customer Care Programme (Programi për përkujdesje të konsumatorëve) |
| CEER | Council of European Energy Regulators (Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji) |
| DETG | Departamenti për energji termike dhe gaz |
| DLL | Departamenti ligjor dhe i licencimit |
| DMK | Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve |
| DTÇ | Departamenti i tarifave dhe i çmimeve |
| DTE | Departamenti për treg të energjisë |
| EBRD | European Bank for Reconstruction and Development (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) |
| EC | European Commission (Komisioni Evropian) |
| ECRB (BRKE) | Energy Community Regulatory Board (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë) |
| EECS | European Energy Certificate System (Sistemi Evropian i Certifikimit të Energjisë) |
| EEX | European Energy Exchange (Bursa Evropiane e Energjisë) |
| EJL | Evropa Juglindore |
| EMS | Operatori i Sistemit të Transmetimit të Serbisë |
| ENS | Energy Not Supplied (Energjia e pafurnizuar) |
| ENTSO-E | European Network of Transmission System Operators for Electricity (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike) |
| ERC | Komisioni Rregullativ për Energji dhe Ujë i Republikës së Maqedonisë Veriore |
| ERE | Enti Rregullator të Energjisë të Republikës së Shqipërisë |
| ERRA | Energy Regulators Regional Association (Asociacioni Rajonal i Rregullatorëve të Energjisë) |
| FSHU | Furnizuesi me shërbim universal |
| GPG | Grupi Punues për Gaz |
| GPNL (PHLG) | Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (Permanent High Level Group) |
| GWh | Gigavatorë |

| | |
|------------------------|--|
| HC | Hydrocentral |
| HLM (MAR) | Të Hyrat e Lejuara Maksimale (Maximum Allowed Revenue) |
| IAP | Ion-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut |
| ITC | Inter TSO Compensation (Kompensimi ndërmjet OST-ve) |
| KE | Komuniteti i Energjisë |
| KEDS | Kompania Kosovare për Distribuim me energji elektrike (Kosovo Electricity Distribution and Services) |
| KEEJL | Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KESCO | Kompania për furnizim me energji elektrike e Kosovës (Kosovo Electricity Supply Company) |
| KESH | Korporata Energjetike e Shqipërisë |
| KfW | Banka Gjermane për Zhvillim |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| km | Kilometër |
| KOSTT | Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut |
| KPSC | Komisioni Rregullativ për Shërbime Publike Kentucky |
| kV | Kilovolt |
| kW | Kilovat |
| LP | Largpërçues |
| MAP | Ministria e Administratës Publike |
| MBE | Marrëveshja për Blerjen e Energjisë |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MVA | Megavoltamper |
| MW | Megavat |
| MWh | Megavatorë |
| MW_{TH} | Megavat termik |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| NARUC | National Association of Regulatory Utility Commissioners (Asociacioni Nacional i Komisionarëve të ndërmarrjeve Rregullative) |
| NJA | Njësia e administratës |
| NQ | Ngrohje Qendrore |
| NS | Nënstacioni |

| | |
|--------------|---|
| OSSH | Operator i Sistemit të Shpërndarjes |
| OST | Operator i Sistemit të Transmetimit |
| OT | Operator Tregu |
| PECI | Projects of Energy Community Interest (Projekti i Interesit të Komunit. Energjisë) |
| PRR | Periudha rregullative |
| RAB | Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve) |
| RoR | Rate of Return (Norma e kthimit) |
| SAIDI | Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem |
| SAIFI | Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem |
| SCADA | Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave) |
| SKE | Energy Community Secretariat (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë) |
| TAP | Trans-Adriatik-Pipeline – Gazsjellësi Përtej Adriatikut |
| TC | Termocentral |
| TF | Task Forcë |
| TKE | Traktati i Komunitetit të Energjisë |
| TM | Tensioni i Mesëm |
| TR | Transformator |
| TU | Tensioni i Ulët |
| TVSH | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar |
| UA | Udhëzimi administrativ |
| USAID | United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar) |
| WACC | Weighted Average Cost of Capital (Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit) |
| WBIF | Western Balkans Investment Framework (Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor) |
| ZK | Zona Kadastrale |
| ZRrE | Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) |

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), paraqet Raportin Vjetor për vitin 2025 për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky raport ofron një pasqyrë të plotë të aktiviteteve të Rregullatorit dhe zhvillimeve në sektorin e energjisë, duke përfshirë analizën e të dhënave të operatorëve të licencuar dhe zhvillimet e tregut të energjisë në Kosovë.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti financiar i buxhetit të Rregullatorit për vitin 2025.

Gjatë vitit 2025, ZRRE ka ushtruar mandatin e saj duke kontribuar në sigurimin e furnizimit stabil me energji, funksionimin efikas të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Bordi i ZRRE-së ka zhvilluar aktivitetet vendimmarrëse përmes mbledhjeve të rregullta dhe komunikimit elektronik.

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2025 ka qenë 5,298 GWh, prej të cilave 4,687 GWh janë nga termocentralet, ndërsa nga HC dhe BRE tjera janë 611.5 GWh, dhe në total ka një ulje prej 12.63% krahasuar me gjithsej prodhimin në vitin 2024.

Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2025 ka qenë 6,944 GWh, që paraqet një rritje prej 5.04% në krahasim me kërkesën në vitin 2024. Kjo kërkesë kryesisht është plotësuar nga prodhimi vendor, ku termocentralet kanë pjesëmarrjen më të madhe, derisa pjesa tjetër është mbuluar nga importet.

Sasia e përgjithshme e energjisë elektrike e shitur te konsumatorët fundor ka qenë 6,617 GWh, prej të cilave 3,393 GWh apo 59.66% janë për konsumatorët familjar, kurse pjesa tjetër 2,294 GWh apo 29.49% për konsumatorët jo-familjar, 617 GWh apo 10.85% për konsumatorët në treg të lirë.

Viti 2025 u karakterizua me një zhvillim i rëndësishëm në sektorin e energjisë elektrike, me daljen e konsumatorëve komercialë në tregun e lirë, në përputhje me kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Ky proces shënoi një hap të rëndësishëm drejt liberalizimit të tregut dhe rritjes së konkurrencës, duke u mundësuar bizneseve të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë. Gjatë këtij viti, konsumi total i energjisë nga kjo kategori arriti në 448 GWh, duke reflektuar peshën dhe rëndësinë e tyre në strukturën e përgjithshme të kërkesës për energji elektrike në vend.

Furnizimi i katër komunave në veri të Kosovës, gjatë vitit 2025 është bërë nga kompania e licencuar Elektrosever. Sasia totale e energjisë së konsumuar nga katër komunat në veri të Kosovës në këtë vit ka qenë 275,350 MWh, prej të cilave 168,977 MWh u janë faturuar konsumatorëve në veri të vendit, kurse pjesa tjetër është humbje në rrjetin e shpërndarjes në pjesën veriore të vendit.

Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë për vitin 2025.

Në vitin 2025, Bordi i ZRRE-së ka rritur tarifën e energjisë elektrike për 16.1% për të gjitha kategoritë e konsumatorëve të rregulluar tarifor.

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë elektrike për vitin 2025 (pa TVSH) ka qenë 8.17 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë elektrike është 10.46 €cent/kWh.

Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm 1.41 % ndaj tërë energjisë së futur në transmetim, apo 1.95% nda kërkesës nacionale, dhe janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë.

Humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes dallojnë krahasuar me vitet paraprake, dhe në vitin 2025 kanë qenë 995 GWh apo 15.05% ndaj kërkesës në shpërndarje, derisa në vitin 2024 kanë qenë 974 GWh apo 15.6%.

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2025 krahasuar me bilancin e vitit 2025 dhe me realizimin në vitin 2024, prej nga shihet se për balancimin e sistemit ndaj kërkesës është paraqitur nevoja për importe dhe eksporte.

Tab. 1.1 Të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2025

| | Njësia | Prodhimi | Kërkesa | Importi | Eksporti | Humbjet | |
|-----------------------|------------|--------------|--------------|--------------|------------|------------|-------------|
| | | | | | | Transmetim | Shpërndarje |
| Realizimi 2025 | GWh | 5,298 | 6,944 | 1,965 | 377 | 135 | 995 |
| Bilanci 2025 | GWh | 5,546 | 7,041 | 1,776 | 310 | 129 | 1,027 |
| Realizim/Bilanc | % | 95.53 | 98.62 | 110.62 | 121.57 | 104.95 | 96.90 |
| Realizimi 2024 | GWh | 6,059 | 6,611 | 1,385 | 748 | 124 | 974 |
| Raporti 2025/2024 | % | 87.44 | 105.04 | 141.90 | 50.39 | 109.59 | 102.20 |

Bllokimi i linjave interkonektive për operim komercial dhe mosalokimi i kapaciteteve transmetuese ndërkufitare në kufirin ndërmjet KOSTT-it dhe EMS-it kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2025. Si pasojë e këtij bllokimi, mungesa e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit vazhdon të krijojë vështirësi të konsiderueshme për tregtarët e energjisë, duke kufizuar tregtimin e energjisë elektrike në këtë kufi. Kjo situatë reflektohet në rritjen e çmimeve të kapaciteteve ndërkufitare në kufijtë e tjerë, si dhe në rritjen e koston së importit të energjisë për Kosovën dhe rajonin e Evropës Juglindore, duke ndikuar negativisht edhe në balancimin e sistemit energjetik.

Sa i përket sektorit të energjisë termike situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Projekti i kogjenerimit në NQ Termokos ka dhënë rezultate të mira duke ngritur cilësinë e ngrohjes për konsumatorët e kyçur në rrjet, ndërsa projekti i ngrohjes së re dhe kogjenerimit me biomase në NQ Gjakova është përfunduar.

- Prodhi neto i energjisë termike në sezonin 2024/2025, në NQ Termokos ka qenë 362 GWh_{Th}, ndërsa në NQ Gjakova 20.2 GWh;
- Konsumi i energjisë termike në sezonin 2024/2025, në NQ Termokos ka qenë 332 GWh_{Th}, ndërsa në NQ Gjakova 19.9 GWh;
- Humbjet ne rrjet të energjisë termike në sezonin 2024/2025, në NQ Termokos ka qenë 8.53 % (në rrjetin e transportimit të energjisë termike 2% dhe në rrjetin primarë të shpërndarjes 6.53%), ndërsa humbjet ne rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike të NQ Gjakova janë vlerësuar 15.03%.

Sa i përket zhvillimit projekteve të gjenerimit nga burimet e rinovueshme, gjatë këtij viti pas finalizimit të projekteve sipas Autorizimit nga Bordi i ZRrE -së, dhe pas pranimit teknik ka hyr në operim komercial gjashtë (6) projekte nga panelet solare, me fuqi totale të instaluar prej 21.48 MW. ZRrE, gjatë këtij viti ka trajtuar edhe kërkesat/aplikacionet për gjeneratorët për marrjen e statusit të

konsumatorit prodhues për vetë-konsum, të cilat pas plotësimit të kërkesave ligjore në pajtim me Rregullën e Autorizimit dhe Skemën mbështetëse, janë lejuar për të vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum 283 projekte dhe në total janë instaluar kapacitete pre 11,062 kW.

ZRrE -ja në vazhdimësi është e angazhuar për një bashkëpunim edhe më të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si një ndër partnerët kryesorë në përpilimin e legjislacionit primar dhe sekondar, Qeverinë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe të gjithë akterët e tjerë të sektorit të energjisë në vend e më gjerë.

Për të mbështetur zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme, ZRRE-ja ka përcaktuar çmimin maksimal të fiksuar për ankandin e energjisë së erës prej 100 MW në nivelin 80.2 EUR/MWh. Paralelisht, ZRRE-ja vazhdoi të promovonte gjeneratorët për vetëkonsum të energjisë elektrike, duke miratuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për instalimin e paneleve diellore nga qytetarët dhe bizneset. Në fushën e monitorimit dhe transparencës, legjislacioni dytësor për zbatimin e REMIT është në fuqi, dhe ZRrE-ja ka vazhduar me monitorimin e të licencuarve në sektor, duke siguruar mbikëqyrje dhe informim të vazhdueshëm për zhvillimet në tregun energjetik.

Këto përpjekje dhe arritje të ZRrE-së tregojnë angazhimin e tij për të garantuar një sektor energjetik më të qëndrueshëm dhe më të transparent, duke rritur efikasitetin dhe përputhshmërinë me normat dhe rregulloret ndërkombëtare.

2 ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) funksionon si një agjenci e pavarur, ligjërish dhe funksionalisht e ndarë nga çdo person fizik ose juridik që operon në sektorin e energjisë. Pavarësia e saj është themelore për të siguruar vendimmarrje transparente dhe të paanshme, duke mbrojtur interesin publik dhe promovuar konkurrencën në tregun energjetik.

Gjatë vitit, Rregullatori ka vazhduar të përmbushë mandatin e tij ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-084, duke siguruar funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të tregut të energjisë. Një nga fokuset kryesore ka qenë krijimi i një mjedisi tregu transparent dhe jo-diskriminues, ku të gjithë aktorët mund të operojnë në kushte të barabarta.

Rregullatori ka vazhduar të zbatojë procedurat për dhënien e licencave dhe autorizimeve për aktivitete energjetike, duke përfshirë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji, si dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike. Proceset e licencimit janë zhvilluar duke u bazuar në kriteret e qarta teknike, financiare dhe mjedisore, duke garantuar që çdo aktor të përmbushë standardet e nevojshme për siguri, efikasitet dhe qëndrueshmëri.

Monitorimi i tregut ka qenë një tjetër prioritet, ku Rregullatori ka ndjekur me kujdes veprimet e ndërmarrjeve energjetike për të parandaluar krijimin e pozitave dominuese dhe praktikat jo-konkurruese. Në të njëjtën kohë, janë marrë masa për të siguruar qasje të pa diskriminuar të përdoruesve të rrjetit dhe për të mbrojtur interesin e konsumatorëve.

Në fushën e tarifave, Rregullatori ka vendosur çmime të bazuara në metodologji transparente dhe të arsyeshme, duke reflektuar kostot reale të operimit dhe investimeve, dhe duke siguruar që tarifat të jenë të drejtë dhe të qëndrueshme. Po ashtu, janë trajtuar me efikasitet ankesat dhe kontestet e konsumatorëve dhe operatorëve, duke siguruar zgjidhje të bazuara në ligj dhe praktika të mira rregullatore.

Përveç këtyre aktiviteteve, Rregullatori ka vazhduar të harmonizojë kornizën rregullative me standardet ndërkombëtare, duke u angazhuar për përputhshmëri me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe për integrimin gradual të “acquis communautaire” të Bashkimit Evropian në sektorin energjetik. Ky proces ka mundësuar që tregu energjetik në Kosovë të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, efikase dhe konkurruese, duke garantuar siguri të furnizimit dhe çmime që reflektojnë kostot reale ekonomike.

Në përgjithësi, gjatë vitit, Rregullatori ka ruajtur një balancë mes promovimit të konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, duke funksionuar si institucion kyç për avancimin e një tregu energjetik të besueshëm.

2.1 Bordi i Rregullatorit

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ZRRE-së, sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë. Ai përbëhet nga Kryesuesi dhe katër anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për një mandat pesëvjeçar. Vendimet merren me shumicë votash dhe janë të vlefshme kur të paktën tre anëtarë janë të pranishëm dhe tre vota janë pro. Qëndrimet e Bordit shpallen në mbledhje publike, të njoftuara paraprakisht në faqen zyrtare të ZRRE-së.

Në fund të vitit 2025, Bordi përbëhej nga:

- Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit
- Lutfije Dervishi, Anëtare e Bordit
- Gani Buçaj, Anëtar i Bordit
- Arta Qorroli, Anëtare e Bordit
- Adnan Preniqi, Anëtar i Bordit

Gjatë vitit, Bordi mbajti 12 mbledhje publike, ku u diskutuan dhe u morën vendime për:

- Rregullimin e çmimeve;
- Licencimin e aktiviteteve të energjisë;
- Autorizimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit nga burimet e ripërtëritshme;
- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Aprovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve të sektorit;
- Çështje të tjera brenda përgjegjësisë të Bordit.

Të gjitha dokumentet shqyrtohen fillimisht në diskutim publik, sipas ligjit, dhe pas përfundimit të konsultimeve publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së.

Bordi mbështetet nga Drejtori Menaxhues, Njësia Administrative dhe pesë departamente:

- Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL)
- Departamenti i Tregut të Energjisë (DTE)
- Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve (DTÇ)
- Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK)
- Departamenti për Energi Termike dhe Gaz Natyror (DETG)

Gjithashtu, Bordi ka inkurajuar zhvillimin profesional të stafit të ZRRE-së përmes trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, duke synuar specializimin sipas profileve përkatëse.

2.2 Struktura organizative dhe burimet njerëzore

Rregullatori është i organizuar në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Kreu II i Ligjit) dhe Manualin e Operimeve të Rregullatorit. Bordi i Rregullatorit sipas përgjegjësisë të përcaktuara me ligj kryen aktivitete si në vijim:

- Miraton politikat rregullative dhe operacionale të Rregullatorit;
- Organizon dhe mbikëqyr punën e Rregullatorit;
- Mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Rregullatorit dhe miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- Organizon procedurat e rekrutimit dhe mbikëqyr punën e personelit të punësuar nga Rregullatori;
- Miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e Rregullatorit;

- Harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Rregullatorin e energjisë.

Struktura organizative e Rregullatorit është e përcaktuar nga Bordi i Rregullatorit bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat që parashihen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Struktura bazë përbëhet nga Drejtori menaxhues, Zyrtarja për asistencë të Bordit, Zyrtarja për marrëdhënie me publikun, pesë departamente dhe Njësia e administratës (NjA) të cilat janë themeluar në pajtim me detyrat operacionale të Rregullatorit.

2.2.1 Drejtori Menaxhues

Drejtori menaxhues i koordinon aktivitetet mes Bordit, stafit profesional dhe administrativ si dhe është përgjegjës për implementimin e të gjitha vendimeve të Bordit të Rregullatorit., Në mënyrë aktive informon dhe këshillon Bordin për zhvillimet në sektorin e energjisë, mbështet Bordin e Rregullatorit për të siguruar që të gjitha aktivitetet e Rregullatorit janë kryer në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat e Rregullatorit si dhe mbikëqyrë punën e departamenteve të Rregullatorit. Drejtori menaxhues i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Bordit, në pajtim me Manualin e operimeve të Rregullatorit.

2.2.2 Departamentet e Rregullatorit

Departamentet udhëhiqen nga udhëheqësit e departamenteve, të cilët organizojnë, kontrollojnë, planifikojnë, bashkëpunojnë, vlerësojnë stafin e tij/saj dhe mbajnë përgjegjësi për aktivitetet dhe përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara për punën e departamenteve. Udhëheqësi i departamentit është përgjegjës për delegimin e punëve të përditshme të stafit të departamentit.

Roli i anëtarëve të stafit të departamenteve është të kryejnë detyra, kurdo që është e nevojshme sipas kërkesave ligjore dhe përmes udhëheqësve të departamenteve i propozojnë në Bord. Në disa raste, anëtarët e stafit mund të autorizohen nga Bordi të kryejnë detyra të posaçme.

Anëtarët e stafit duhet të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin e departamentit dhe stafin tjetër profesional. Anëtari i stafit po ashtu duhet të ketë mundësi në ndjekjen e trajnimeve të disponueshme nga Rregullatori, për përmirësimin e aftësive dhe njohurive të tyre profesionale.

Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL)

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit sekondar, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënie autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

Departamenti i tregut të energjisë (DTE)

Departamenti i tregut të energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e performancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Departamenti i tarifave dhe çmimeve (DTÇ)

Departamenti i tarifave dhe çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara, monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes shqyrtimeve tarifore, ndërmerr të gjitha masat që tarifat të jenë kosto - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente, duke marrë në konsiderim përballueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK)

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat, të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror (DETG)

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror është përgjegjës për shqyrtimin dhe implementimin e strategjive, standardeve të performancës dhe praktikave tjera operationale, që kanë të bëjnë me këta sektorë. Ky departament kryen monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara përmes mbledhjes, analizës dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave përkatëse, e gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sistemeve raportuese të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore duke u fokusuar në elementet tekniko-teknologjike dhe në integrimin e masave nxitëse dhe caqeve për eficiencë. Po ashtu bashkëpunon me departamentet tjera të Rregullatorit duke dhënë mbështetjen dhe ekspertizën teknike për çështjet e ndërlidhura me energjinë termike dhe gazin natyror.

Njësia e administratës (NjA)

Njësia e administratës mbështet funksionimin e Rregullatorit, organizon rekrutimin efikas të stafit të Rregullatorit, koordinon trajnimet e stafit të Rregullatorit, furnizimin me pajisje të zyrës dhe mirëmbajtjen e tyre, ndihmon në rregullimin e zyrës, duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e Rregullatorit.

Personeli i ZRrE-së është i strukturuar në departamente organizative të përcaktuara në bazë të veprimtarive të veçanta operationale dhe administrative.




Fig. 2.1 Skema organizative e Rregullatorit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve, deri në fund të 31 dhjetorit 2025, është 23 punonjës. Në këtë numër përfshihen 5 anëtarët e Bordit dhe 18 anëtarë të personelit të punësuar brenda departamenteve profesionale dhe njësisë së administratës.

Përshkrimi i shkurtër i strukturës organizative me vendet e punës në vitin 2025 është dhënë në tabelën më poshtë.

Tab. 2.1 Struktura organizative

| Pozitat e vendeve të punës | Pozitat e planifikuara | Punësuar | Vende të lira |
|--|------------------------|-----------|---------------|
| Bordi i ZRRE-së | 5 | 5 | 0 |
| Drejtor menaxhues | 1 | 1 | 0 |
| Zyrtare për marrëdhënie me publikun | 1 | 0 | 1 |
| Zyrtare për asistencë të Bordit | 1 | 0 | 1 |
| Njësia e administratës | | | |
| Udhëheqëse e njësisë së administratës | | | |
| Zyrtar kryesor financiar | | | |
| Menaxhere e prokurimit | | | |
| Zyrtare e administratës | | | |
| Zyrtar për menaxhim të të dhënave | 9 | 7 | 2 |
| Ekspert për zhvillim të bazës së të dhënave | | | |
| Përkthyes e gjuhës angleze | | | |
| Recepcionist | | | |
| Mirëmbajtës/Vozitës | | | |
| Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL) | | | |
| Udhëheqës i dpt. Ligjor dhe të licencimit | | | |
| Ekspert për çështje ligjore dhe të monitorimit | 3 | 2 | 1 |
| Analiste për çështje ligjore dhe monitorim të licencave | | | |
| Departamenti i çmimeve dhe tarifave (DTÇ) | | | |
| Udhëheqës i dpt. për çmime dhe tarifa | | | |
| Ekspert ekonomik për çështje rregullative dhe të tarif. | 4 | 2 | 2 |
| Analist për tarifa dhe çmime | | | |
| Analist për strukturë tarifore | | | |
| Departamenti i tregut të energjisë (DTE) | | | |
| Udhëheqës i dpt. të tregut të energjisë | | | |
| Analiste për furnizim me energji dhe strukturë të tregut | 4 | 2 | 2 |
| Analist për sisteme elektroenergjetike | | | |
| Analist për monitorim të tregut | | | |
| Departamenti për energji termike dhe gaz (DTEG) | | | |
| Udhëheqës i dpt. për energji termike dhe gaz | 2 | 2 | 0 |
| Analist për energji termike | | | |
| Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK) | | | |
| Udhëheqës i dpt. për mbrojtje të konsumatorëve | | | |
| Zyrtar për mbrojtje të konsumatorëve | 3 | 2 | 1 |
| Analist për përmbushje të standardeve | | | |
| Gjithsej | 33 | 23 | 10 |

Personeli i Rregullatorit është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësi që ata mbulojnë.

2.3 Financimi i Rregullatorit

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gëzon statusin e "agjensionit të pavarur". Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon që agjencitë e pavarura, janë institucione të krijuara nga Kuvendi bazuar në ligjet përkatëse që rregullojnë krijimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Kjo do të thotë që ZRRE-ja duhet të ketë pavarësi të plotë në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, gjegjësisht të hyrave të dedikuara të saj, të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Çështja e pavarësisë financiare është rregulluar kryesisht nga Direktivat e BE-së, të cilat parashikojnë që shtetet anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet rregullative ose agjencitë e pavarura duhet të jenë në gjendje të marrin vendime autonome në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik, përfshirë mënyrat përmes të cilave ato ushtrojnë mandatet e tyre, punonjësit që duhet të rekrutojnë etj. Kjo do të thotë që Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të gëzojë pavarësi financiare, e cila mundësohet përmes inkasimit të të hyrave vetanake dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Legjislacioni aktual parashikon qartë se të hyrat e ZRRE-së janë "të hyra të dedikuara", dhe, në lidhje me këtë, ZRRE ka të drejtë të mbledhë "të hyra të dedikuara" nga burime të caktuara, të cilat në rastin e ZRRE-së përfshijnë taksat e licencimit. Kjo gjithashtu parashikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili përcakton se "të ardhurat e dedikuara" janë ato të ardhura që rrjedhin nga një burim i caktuar i të ardhurave, dhe këto agjenci, vetëm në rastet kur këto të ardhura janë të pamjaftueshme, mund të kërkojnë ndarje buxhetore plotësuese nga buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja mbledh të hyra nga:

- Taksat fillestare dhe vjetore të licencimit;
- Taksat nga aplikacionet për lëshimin dhe modifikimin e licencave;
- Taksat për lëshimin e certifikatave të origjinës;
- Taksa për shqyrtim/rishikim të aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

3 AKTIVITETET E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

3.1 Licencimi i aktiviteteve të energjisë

Operimi i pjesëmarrësve në tregun e energjisë në Kosovë për aktivitetet e prodhimit të energjisë, shpërndarjes, furnizimi, tregtimitt, transmetimit etj., mund të bëhet vetëm nga operatorët e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për aktivitetin përkatës. Se deri në sa MW apo kW nevojitet licenca, kjo çështje është e përshkruar më në detaje edhe në legjislacionin në fuqi, më konkretisht në Nenin 28 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe poashtu në Nenin 3 paragrafitn 1 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, datë 31.03.2017).

Bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi, deri më tani Rregullatori ka lëshuar licenca për këto aktivitete: prodhimin e energjisë elektrike; prodhimin e energjisë termike; bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe termike; transmetimin e energjisë elektrike përfshirë operimin e sistemit të transmetimit; shpërndarjen e energjisë elektrike duke përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes; shpërndarjen e energjisë termike; furnizimin me energji elektrike dhe energji termike, duke përfshirë transitin, importin ose eksportin e energjisë elektrike; furnizimin me shumicë (tregtimin) e energjisë elektrike; si dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Siç u cek në paragrafin e sipërpërmendur, ka raste kur nuk kërkohet të lëshohet licencë nga Zyra e Rregullatorit për Energji, për disa aktivitete të cilat nuk kanë ndikim shumë të madh në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Pra aktivitetet të cilat nuk kanë nevojë për licencë janë:

- prodhimi i energjisë elektrike në lokacionin energjetik me kapacitet total që nuk tejkalon pesë (5) MW;
- prodhimi i energjisë termike të prodhuar nga ngrohtoret për konsum vetanak apo me kapacitet që nuk tejkalon 1 MW;
- prodhimi i energjisë elektrike për konsum vetanak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmetimit apo shpërndarjes.

Përkundër që Rregullatori nuk lëshon Licencë për aktivitetet në pikat e sipërpërmendura, megjithatë asnjë person juridik apo fizik nuk mund të ndërtojë kapacitete të tilla, pavarësisht kapacitetit, pa marr Autorizim për Ndërtim të Kapacitetit Gjenerues, i cili Autorizim lëshohet nga Rregullatori në pajtim me legjislacionin në fuqi, proces ky, para licencimit.

Që nga themelimi e deri më tani Rregullatori ka licencuar rreth njëqind e njëzetë (120) ndërmarrje për aktivitetet të ndryshme të energjisë dhe me kohëzgjatje të ndryshme të licencës, varësisht nga jetëgjatësia e aseteve, ku rreth nëntëdhjetë (90) kanë pasur licencë aktive gjatë vitit 2025 me të cilën kanë pasur të drejtë të operojnë në tregun e energjisë në Kosovë, e të cilat janë nën monitorimin e Rregullatorit për aktivitetin e tyre.

Edhe gjatë vitit 2025 sikurse edhe viteve paraprake, ZRRE ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve të palëve të interesuara për licencim të aktiviteteve të energjisë. Krahasuar me vitin 2024 numri i aplikacioneve të trajtuara nga Rregullatori ka qenë shumë më i lartë për aktivitetin e furnizimit dhe po ashtu atë të tregtimitt të energjisë elektrike në Kosovë. Kështu që gjatë vitit 2024 kemi shqyrtuar vetëm katër (4) aplikacione për furnizim me energji elektrike, përderisa këtë vit janë shqyrtuar dymbëdhjetë (12) aplikacione për këtë aktivitet. Poshtu për tregtim të energjisë elektrike

gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar dy (2) aplikacione përderisa këtë vit për këtë aktivitet janë shqyrtuar tetë (8) aplikacion. Gjithashtu vlen të ceket se këtë vit është vazhduar aplikimi për njohje reciproke të licencave me Republikën e Shqipërisë e poashtu, Kosova ka filluar për herë të parë edhe njohjen reciproke e licencave të furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike me Maqedoninë e Veriut, kjo si rezultat i Memorandumit të mirëkuptimit për njohje reciproke të licencave tregtare në mes të autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë Veriore, të datës 17.07.2023.

Numri i licencave të trajtuara, në proces apo të lëshuara gjatë vitit 2025 ishte njëzet e pesë (25) ndërsa gjatë vitit 2024 në total ishin trembëdhjetë (13). Nga njëzet e pesë (25) licencat e trajtuara për aktivitete të ndryshme, tetë (8) nga to kanë qenë për Njohje Reciproke të licencave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, sipas parimit të reciprocitetit.

Shiq mund të shihet, fokusi i licencave të trajtuara gjatë këtij viti nga Rregullatori ka qenë tek furnizimi me energji elektrike dhe poashtu tregtimi me energji elektrike, pasuar nga prodhimi i energjisë elektrike nga panelet solare fotovoltaike dhe uji, etj. Siç mund të shihet edhe nga tabelat më poshtë, disa licenca kanë mbetur ende në proces, si pasojë e mos plotësimit të kushteve për licencim nga aplikantët, të cilat do të trajtohen në vitin në vijim.

Në vijim do të trajtohen më në detaje licencat e lëshura nga rregullatori, ato në proces etj., për aktivitetet e prodhimit të energjisë elektrike, furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike për vitin 2025.

3.1.1 Licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe termike

Bazuar në Nenin 29 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, aktiviteti i prodhimit të energjisë elektrike nuk mund të kryhet pa pasur licencë të lëshuar nga Rregullatori për gjeneratorët që janë me kapacitet më të madh se 5 MW, ndërsa nën këtë kapacitet Rregullatori lëshon vetëm autorizim për ndërtim kapaciteti. Ndërsa sa i përket energjisë termike, sipas po të njëjtit nen, licenca kërkohet për kapacitet mbi 1 MW.

Edhe këtë vit licencimi i aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, posaqërisht nga Hidrocentralet ka mbetur sfidues ku disa nga licencat e disa ndërmarrjeve kanë kaluar nëpër procese gjyqësore për arsye të ndryshme. Sa i përket këtij aktiviteti, gjatë këtij viti Rregullatori ka pranuar ka vazhduar shqyrtimin e tri (3) aplikacioneve për prodhim të energjisë nga uji, të cilat kanë mbetur ende në proces, përdersa dy (2) aplikacione për prodhim të energjisë nga panelet solare fotovoltatike kanë plotësuar kushtet për licencim dhe janë licencuar nga ZRRE për periudhë prej njëzet e pesë (25) vitesh (2025-2030). Gjithashtu janë mbajtur takime me palë të ndryshme të interesuara për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese të prodhimit të energjisë nga era, uji, panelet solare, biomasa etj.

Rregullatorit përveç që ka licencuar gjeneratorët të cilët kanë qenë të ndërtuar para themelimit të Rregullatorit, po ashtu ka licencuar edhe gjeneratorë të tjerë të rinj të cilën janë ndërtuar përmes Procedurës së Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja, të udhëhequr nga Rregullatori, siç janë Energy Development Group Kosova L.L.C dhe Eco Park Group SH.P.K., të licencuar gjatë këtij viti.

Në tabelën më poshtë janë paraqitura të dhënat e ndërmarrjeve për prodhim të energjisë elektrike dhe termike, të cilët kanë filluar aplikimin për licencim të aktivitetit e tyre gjatë vitit 2025, si dhe të

atyre që janë ende në proces të licencimit për shkak se nuk kanë plotësuar ende kërkesat për t'u licencuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Tab. 3.1 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca dhe janë në proces të licencimit për aktivitet të prodhimit të energjisë elektrike dhe energjisë termike

| Nr. | Emri i ndërmarrjes | Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar | Numri i licencës | Adresa, selia e të licencuarit | Vlefshmëria e licencës |
|-----|--|--|--------------------------------|---|---|
| 1 | "KelKos Energy" SH.P.K (HC Lumbarthi I-ish kozhnjer) | Prodhim i energjisë elektrike (nga uji) | ZRRE/Li_98/24 | Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës | 27.03.2024 - në proces të licencimit... |
| 2 | Matkos Group Sh.P.K. (HC Sharri) | Prodhim i energjisë elektrike (nga uji) | ZRRE/Li_74/21 | Rr. Shpetim Robaj, Prishtine, Republika e Kosoves (selia Shterpece), Republika e Kosovës. | 23.02.2021 - në proces të licencimit |
| 3 | "KelKos Energy" SH.P.K (HC Lumbarthi II) | Prodhim i energjisë elektrike (nga uji) | ZRRE/Li_64/18 ZRRE/Li_64/20 | Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës | 14.10.2019 - 13.10.2020 Licencë e përkohshme 14.10.2019 - në proces të licencimit ... |
| 4 | Energy Development Group Kosova L.LC | Prodhim ose bashkëprodhim i energjisë elektrike (nga panelet solare) | ZRRE/Li_106/25 | Madanaj, pn, Gjakovë, Republika e Kosovës | 05.09.2025 - 04.09.2050 - Lëshim Licence |
| 5 | Eco Park Group SH.P.K. | Prodhim i energjisë elektrike (nga panelet solare) | ZRRE/Li_111/25 | Madanaj, Rr. Qata p.n. Gjakovë, Republika e Kosovës | 18.12.2025 - 17.12.2050 - Lëshim Licence |
| 6 | Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" Sh.A | Prodhim i energjisë termike (nga mazuti) | ZRRE/Li_10/17 | Rr "28 Nëntori" pn-Dardani Prishtinë, Republika e Kosovës | 23.03.2021 - në proces të licencimit... |

Kelkos Energy Sh.P.K. (HC Lumbarthi – ish kozhnjer) – ka qenë e licencuar si "TRIANGLE GENERAL CONTRACTORS-INC" Branch Kosova (HC Lumëbardhi), me kapacitet të instaluar prej **8.3MW**, me numër licence ERO_Li_09/06, e vlefshme prej datës 04 tetor 2006 deri 29 prill 2024 (për periudhë 20 vjeçare sa zgjat Marrëveshja mbi Qiranë dhe Marrëveshja mbi Blerjen e Energjisë e nënshkruar me KEK-un me 29 prill 2004). E njëjta është transferuar te "Kelkos Energy" Sh.P.K. HC Lumëbardhi (ish Kozhnjer) me numër licence ZRRE/Tr_01/Li_09/06, me afat të njëjtë deri 29.04.2024. Kjo licencë është modifikuar në vitin 2012 me numër licence ZRRE/Tr_01/Li_09/12. Licenca do të mund të vazhdohej, pas plotësimit të kushteve për licencim dhe në rast se do të aplikonte gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës sipas Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Ndërmarrja nuk ka arritur të aplikoj brenda këtij afati, ndaj e njëjta është udhëzuar të aplikoj për licencim (si aplikim i ri, e jo vazhdim licence). Ndërmarrja ka aplikuar me datë 27.03.2024 për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë nga uji dhe e njëjta gjatë këtij viti ka sjellur disa dokumente shtesë, simodos sa i përket qështjes së kontratës së qirasë, mirëpo të njëjtat nuk kanë qenë të mjaftueshme për t'u pajisur me licencë të prodhimit të energjisë elektrike, andaj e njëjta ka mbetur në proces të shqyrtimit tutje të aplikacionit nga ZRRE.

Matkos Group Sh.P.K. (HC Sharri) – ka aplikuar në Rregullator për licencë të prodhimit të energjisë elektrike (nga uji) nga Hidrocentrali HC Sharri me datë 23 shkurt 2021, për kapacitet të instaluar prej **6.453MW**. Ky hidrocentral është ende në proces të licencimit, pasi që kjo ndërmarrje ende nuk ka plotësuar kushtet mjedisore të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi, përkundër që hidrocentrali është ndërtuar sipas procedurës së autorizimit të udhëhequr nga Rregullatorit. Lënda është pjesë e proceseve gjyqësore (shih Aktgjykimin KA.nr.697/2025), rrjedhimisht në proces të shqyrtimit të aplikacionit nga ZRRE.

Kelkos EnergySH.P.K (HC Deçani, HC Belaje dhe HC Lumbardhi II) – kjo ndërmarrje e cila kishte aplikuar në Rregullator për tri (3) njësi prodhuese, kishte plotësuar të gjitha kërkesat për licencim sipas udhëzimeve të Rregullatorit për dy (2) njësi prodhuese nga: Hidrocentrali “Deçani” me kapacitet prej 8.06 MW dhe Hidrocentrali “Belaje” me kapacitet prej 9.8 MW, për çka edhe është licencuar nga Bordi i Rregullatorit për këto dy (2) njësi. Sa i përket njësisë së Hidrocentralit “Lumbardhi II” me kapacitet prej **6.2 MW**, në mungesë të plotësimit të kushteve të cilat kërkohen sipas legjislacionit në fuqi, kjo njësi nuk është pajisur me licencë të prodhimit të energjisë elektrike, duke mbetur kështu në proces të licencimit që nga 21 dhjetor 2018.

Energy Development Group Kosova L.L.C – ka aplikuar për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë nga panelet solare fotovoltatike me lokacion në projektin në Madanaj të Komunës së Gjakovës. Ndërtimi i këtij gjeneratori është bërë përmes procedurës së autorizimit të udhëhequr nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Duke qenë se gjeneratori është mbi 5 MW dhe për këtë kërkohet licencë sipas legjislacionit në fuqi, e njëjta ka aplikuar me datë 2.7.2025 për licencim të kapacitetit gjenerues prej 6MW. Pas plotësimit të gjitha kërkesave sipas aplikacionit, ky gjenerator është licencuar për periudhë prej prej 05.09.2025 – deri 04.09.2050, periudhë kjo e konsideruar varësisht nga jetëgjatësia e aseteve të përdorura për kryerjen e këtij aktiviteti.

Eco Park Group SH.P.K. – ka aplikuar për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë nga panelet solare fotovoltatike me lokacion në projektin poashtu në Madanaj të Komunës së Gjakovës. Edhe ndërtimi i këtij gjeneratori është bërë përmes procedurës së autorizimit të udhëhequr nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Duke qenë se edhe ky gjenerator është mbi 5 MW, subjekti ka aplikuar me datë 6.10.2025 për licencim të kapacitetit gjenerues prej 6MW. Pas plotësimit të gjitha kërkesave sipas aplikacionit, ky gjenerator është licencuar për periudhë prej prej 18.12.2025 - 17.12.2050, periudhë kjo e konsideruar varësisht nga jetëgjatësia e aseteve të përdorura për kryerjen e këtij aktiviteti.

Ngrohtorja e Qytetit “Termokos” Sh.A – sikurse për aktivitetet e energjisë elektrike, Rregullatori është kompetent edhe për licencimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteve të energjisë termike. Termokos është e vetmja ndërmarrje në kryeqytet e cila furnizon konsumatorët me energji termike, sipas Marrëveshjes për Furnizim me Energji Termike nga termocentrali Kosova B e cila i transporton energjinë termike përmes rrjetit të transportit të energjisë termike. Ky aktivitet kryhet në pajtim me Licencën për Bashkëprodhim të Energjisë Elektrike me atë Termike, të cilën ZRRE i ka lëshuar KEK-ut, TC Kosovës B në vitin 2017 me afat vlerfshmie deri me 04 tetor 2026.

Ngrohtorja e Qytetit “Termokos” Sh.A, pavarësisht që ka aplikuar brenda afatit ligjor për vazhdim licence për prodhim të energjisë termike (nga mazuti), nuk ka arritur të plotësoj kushtet për vazhdim licence për këtë aktivitet dhe si pasojë nuk është licencuar nga Bordi i Rregullatorit as gjatë vitit 2025, pasi që është vlerësuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit/Institutit të Inxhinierisë Mekanike dhe

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, se dy kaldajat me mazut me kapacitet 116MW_{TH} (2x56MW)), rezervuaret dhe oxhaku nuk janë funksionale.

3.1.2 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me energji elektrike

Siç është cekur edhe më lartë, këtë vit interesimi i palëve për t'u licencuar për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike në Kosovë ka qenë shumë më i lartë se vitin paraprak. Shkak mund të ketë qenë edhe hapja e tregut të energjisë, ku sipas Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike 04/L-085, të drejtën e furnizimit si shërbim universal, nuk e gëzojnë të gjithë konsumatorët, por vetëm konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës. Kështu, pas aplikimit dhe plotësimit të kushteve për licencim, Bordi i Rregullatorit i ka licencuar njëmbëdhjetë (11) subjekte juridike, tri (3) nga të njohura sipas parimit të reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë ndërsa një (1) e njohur sipas parimit të reciprocitetit me Maqedoninë e Veriut.

Pra, për dallim nga vitet paraprake, këtë vit numri i të licencuarve që kanë hyrë (janë kyçur) në treg të energjisë elektrike është rritur dukshëm, kështu përveç KESCO-s, gjatë vitit 2025 edhe ndërmarrjet si FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., VoltKos SH.P.K., EDS International KS L.L.C, Enerco LLC. SH.P.K., dhe Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. kanë furnizuar me energji elektrike konsumatorët e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Këta furnizues kanë furnizuar me energji elektrike me çmime të tregut të gjithë konsumatorët me të cilët kanë lidhur kontrata, e të cilët nuk kanë pasur mundësi të furnizohen nga furnizuesi me Obligim të Shërbimit Publik.

Sa i përket furnizimit me energji elektrike nga furnizuesit të cilët kanë qenë aktiv gjatë këtij viti (si në paragrafin më lartë), duhet cekur se sipas vendimit V_1925_2024 të datës 02 prill 2024, të nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së, KESICO-s i është vendosur të kryej Obligimin e Shërbimit Publik edhe për vitin 2024 deri në mars të vitit 2026, për të gjithë konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të Shërbimit Universal, e të cilët janë: të gjithë konsumatorët familjar, dhe të gjithë konsumatorët jo-familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë milion euro (10,000,000.00€), ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës. Pavarësisht kësaj, të gjithë konsumatorët fundor kanë të drejtë të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues, sipas legjilacionit në fuqi, të Kosovës.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur furnizuesit e licencuar nga ZRRE gjatë vitit 2025 dhe në proces të licencimit, ku shihet se numri i tyre është shumë më i lartë se vitet paraprake, e që padyshim është si rezultat i hapjes së tregut të energjisë.

Tab. 3.2 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca dhe janë në proces të licencimit për aktivitet të furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2025

| Nr. | Emri i ndërmarrjes | Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar | Numri i licencës | Adresa, selia e të licencuarit | Vlefshmëria e licencës |
|-----|--|---------------------------------------|--|---|--|
| 1 | VoltKos SH.P.K. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_101/25 | Rr.Perandori Dioklecion Nr.17, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës | 27.05.2025 - 26.05.2030 Lëshim Licence |
| 2 | Energy for Change L.L.C. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_104/25 | Rr.Sali Nivica Nr.1, Prishtinë, Prishtinë, Republika e Kosovës | 05.09.2025 - 04.09.2030 - Lëshim Licence |
| 3 | Management & Development Associates L.L.C. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_103/25 | Rr.Xheladin Hana, Blloku A17, Hyrja 1#4, Prishtinë, Republika e Kosovës | 10.07.2025 - 09.07.2030 - Lëshim Licence |
| 4 | BE Power SH.P.K. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_107/25 | Llapnasellë, Nr. 166, Graçanicë, Republika e Kosovës | 05.09.2025 - 04.09.2030 - Lëshim Licence |
| 5 | Norwegian PX Kosovë SH.P.K | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_105/25 | Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, Rr. Aziz Abrashi Nr.86, Prishtinë, Republika e Kosovës | 05.09.2025 - 04.09.2030 - Lëshim Licence |
| 6 | SWISS SOLAR PARK L.L.C. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_109/25 | Rr. Mbretëresha Tetuta, PN, Gjakovë, Republika e Kosovës | 07.11.2025 - 06.11.2030 - Lëshim Licence |
| 7 | SolarNeo SH.P.K. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_110/25 | Zona Industriale P.N., Prishtinë, Republika e Kosovës | 07.11.2025 - 06.11.2030 - Lëshim Licence |
| 8 | Al EnergyX Dega në Kosovë | Furnizim me energji elektrike | Seria F23 Numri i Licencës 545 | Rr. Elez Berisha p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 13 mars 2023 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 27.05.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). Në fuqi nga 25 nëntor 2022 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 13.08.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). |
| 9 | Alb Energy Trade Dega në Kosovë | Furnizim me energji elektrike | Seria F22 Numri i Licencës 532 | Rr. Bekim Fehmiu, Icon Tower Kati 11, Nr.2, Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 10 dhjetor 2024 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 20.10.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). |
| 10 | Volton Shpk Dega në Kosovë | Furnizim me energji elektrike | Seria F24 Numri i Licencës 600 | ALI PASHË TEPELENA, Hy 31, Kati 2, Nr.4, Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 25 maj 2023 për periudhë prej 10 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 05.09.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Maqedoninë e Veriut) |
| 11 | MEGA KONCEPT Branch in Kosovo | Furnizim me energji elektrike | nr.regjistrit të licencës së lëshuar: EE-SNAB-1017-2023 | Rr.Qamile Jaka 20, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 25 maj 2023 për periudhë prej 10 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 05.09.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Maqedoninë e Veriut) |
| 12 | EKO LED SH.P.K. | Furnizim me energji elektrike | ZRRE/Li_112/25 | Rr. Lidhja e Pejës, Nr.289, Prishtinë, Republika e Kosovës | 05.11.2025...në proces të licencimit. |

“VoltKos SH.P.K.”, “Energy for Change L.L.C.”, “Management & Development Associates L.L.C.”, “BE Power SH.P.K.”, “Norwegian PX Kosovë SH.P.K.”, “SWISS SOLAR PARK L.L.C.” dhe “SolarNeo SH.P.K.”. – kanë aplikuar gjatë vitit 2025 në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, duke plotësuar kështu Aplikacionin me të gjitha dokumentet e kërkuara për licencim të këtij aktiviteti, përfshirë pagesën e taksës fillestare për licencim dhe publikimin e njoftimit në

gazeta (portale). Pas këtij procesi, të njëjtat janë licencuar nga Bordi i Rregullatorit për periudhë prej pesë (5) vitesh, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ku parashihet se khëzgjatja e licencës së furnizimit në Kosovë përcaktohet varësisht nga gjendja financiare e aplikantit me kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh.

“Al EnergyX Dega në Kosovë”, “Alb Energy Trade Dega në Kosovë”, “Volton Shpk Dega në Kosovë” – të gjitha të licencuara në Shqipëri për furnizim me energji elektrike janë regjistruar në Kosovë si “dega në Kosovë” dhe kanë aplikuar në Rregullator për njohje reciproke të licencës, sipas parimit të reciprocitetit. Të njëjtat janë udhëzuar të dorëzojnë dokumentacionin sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë dhe memorandumit të mirëkuptimit të lidhur mes Rregullatorit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë. Pas plotësimit të kushteve përkatës, Rregullatori u ka njohur licencat sipas parimit të reciprocitetit dhe e njëjtat kanë fituar të drejtën të furnizojnë konsumatorët me energji elektrike në Kosovë për periudhë prej pesë (5) vitesh, duke llogaritur datën e lëshimit të licencës nga Enti Rregullator i Shqipërisë.

“MEGA KONCEPT Branch in Kosovo” – e licencuar në Maqedoninë e Veriut për furnizim me energji elektrike, e regjistruar poashtu si *MEGA KONCEPT*, e njëjta është udhëzuar për t’u regjistruar në Kosovë, e që është regjistruar si *MEGA KONCEPT Branch in Kosovo*. Me 12 gusht ka aplikuar në Rregullator për njohje reciproke të licencës sipas parimit të reciprocitetit. Të njëjtës i është kërkuar të dorëzojë dokumentacionin sipas Rregullës për Licencim dhe memorandumit të mirëkuptimit të lidhur mes Rregullatorit të Kosovës dhe atij të Maqedonisë së Veriut. Pas plotësimit të kushteve, Rregullatori me 5.9.2025 i ka njohur licencën sipas parimit të reciprocitetit dhe e njëjta mund të furnizojë konsumatorët me energji elektrike në Kosovë për periudhë prej dhjetë (10) vitesh, duke llogaritur datën 25 maj 2023, ashtu siç edhe është e licencuar nga Komisioni Rregullator për Energjetikë dhe Shërbime të Ujit, i Maqedonisë së Veriut.

“EKO LED SH.P.K.” – ka aplikuar gjatë vitit 2025 në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike. Aplikacioni është shqyrtuar nga ZRRE, mirëpo e njëjta në pamundësi për të dorëzuar të gjitha dokumentet të cilat kërkohen sipas aplikacionit për këtë aktivitet, ka mbetur në proces të licencimit.

Të gjithë furnizuesit e licencuar, në mënyrë që të furnizojnë me energji elektrike konsumatorët e tyre, fillimisht lidhin marrëveshje/kontratë për furnizim, në pajtim me licencën dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm në Kosovë.

Duhet cekur se furnizuesit të cilët kanë licencë për furnizim, të lëshuar nga ZRRE, përveç furnizimit me energji të konsumatorëve në Kosovë, të njëjtit mund të kryejnë edhe aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, në pajtim me licencat e lëshuara nga ZRRE dhe legjislacioni tjetër në fuqi.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të tridhjetë (30) furnizuesit të cilët janë licencuar gjatë viteve paraprake, e të cilët gjatë vitit 2025 kanë pasur licenca aktive, pra, të njëjti kanë pasur të drejtë të furnizojnë konsumatorët me energji elektrike gjatë vitit 2025.

Tab. 3.3 Ndërmarrjet që kanë të drejtë të furnizojnë me energji elektrike konsumatorët në Kosovë sipas licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji

| Ndërmarrja e regjistruar në Kosovë | Afati i licencës |
|---|-------------------------|
| 1 Kosovo Electricity Supply Company (KESICO) J.S.C | 13.04.2017-04.10.2036 |
| 2 GSA ENERGJI SH.P.K. | 11.11.2021-10.11.2026 |
| 3 FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. | 13.04.2023-12.04.2028 |
| 4 KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.A | 20.12.2018-19.12.2043 |
| 5 Društvo Elektroever D.O.O. | 24.06.2022-23.06.2027 |
| 6 EDS International KS L.L.C | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 7 HEP Energjia SH.P.K. | 27.10.2021-26.10.2026 |
| 8 MCM COMMODITIES SH.P.K. | 31.03.2022-30.03.2027 |
| 9 NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë | 02.12.2021 për 5 vite |
| 10 ETMT ENERGY SH.P.K. | 12.10.2022-11.10.2027 |
| 11 SharrCem SH.P.K. | 05.05.2023-04.05.2028 |
| 12 Eurosol&Energy LTD SH.P.K | 18.08.2023-17.08.2028 |
| 13 SPB ENERXHI PRODAKSHN DOOEL Branch in Kosovo | 06.09.2021 për 10 vite |
| 14 INFINIT ENERGY DOOEL Dega në Kosovë | 01.06.2023 për 10 vite |
| 15 INFINIT POWER SOLUTION SH.P.K. | 28.12.2023-27.12.2028 |
| 16 EZ5 ENERGY SHPK -Dega në Kosovë | 08.03.2024 për 5 vite |
| 17 Protergia Energy Albania Dega në Kosovë | 12.04.2024 për 5 vite |
| 18 Enerco LLC. SH.P.K. | 12.11.2024-11.11.2029 |
| 19 TREDINT GROUP L.L.C | 12.11.2024-11.11.2029 |
| 20 VoltKos SH.P.K. | 27.05.2025-26.05.2030 |
| 21 AI EnergyX Dega në Kosovë | 13.03.2023 për 5 vite |
| 22 Management & Development Associates L.L.C. | 10.07.2025-09.07.2030 |
| 23 Energy for Change L.L.C. | 05.09.2025-04.09.2030 |
| 24 Norwegian PX Kosovë SH.P.K | 05.09.2025-04.09.2030 |
| 25 BE Power SH.P.K. | 05.09.2025-04.09.2030 |
| 26 Alb Energy Trade Dega në Kosovë | 25.11.2022 për 5 vite |
| 27 MEGA KONCEPT Branch in Kosovo | 25.05.2023 për 10 vite |
| 28 SWISS SOLAR PARK L.L.C. | 07.11.2025-06.11.2030 |
| 29 SolarNeo SH.P.K. | 07.11.2025-06.11.2030 |
| 30 Volton Shpk Dega në Kosovë | 10.12.2024 për 5 vite |

3.1.3 Licencimi i aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike

Për dallim nga vitet tjera, këtë vit numri i aplikimeve për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë është rritur shumë. Gjatë vitit 2024 ZRRE kishte shqyrtuar vetëm dy (2) aplikacione për licencim të këtij aktiviteti dhe kishte lëshuar vetëm një licencë dhe atë njohje reciproke me Shqipërinë, përderisa gjatë vitit 2025 Rregullatori ka shqyrtuar tetë (8) aplikacione, ku ka lëshuar tri (3) licenca për aktivitet të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike. Gjithashu ka njohur katër (4) licenca sipas parimit të reciprocitetit me Shqipërinë ndërsa një (1) poashtu sipas parimit të reciprocitetit me Maqedoninë e Veriut.

Sa i përket parimit të reciprocitetit, duhet shtuar se Ligji për energjinë elektrike parasheh që licencat e lëshuara për tregtimin e energjisë elektrike në Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Furnizuesit e tillë të licencuar do të kenë të drejtë të tregtojnë energjinë elektrike pa pasur nevojë për licencë shtesë. Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale. Procesi i aplikimit sipas parimit të Reciprocitetit në detaje është paraqitur edhe në rregullën e amendamentuar nga ZRRE për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Rregulla ZRRE/Nr.02/20221.

Sipas kësaj rregulle, ZRRE mund të njoh një licencë, në rast se një subjekt juridik ka një licencë të lëshuar nga një autoriteti Rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar i Bashkimit Europian, ose një vendi tjetër, me kusht që me atë shtet (autoritet rregullator) ZRRE të ketën lidhur marrëveshje dypalëshe për njohjen reciproke të licencave dhe sigurisht, pasi të ketë dorëzuar në Rregullator dëshmitë që parashihen sipas legjisllacionit në fuqi

¹ https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Licencat/2017.03.31_2022_Amendament_Rregulla_per_Licencimin_e_Aktiviteteve_te_Energjise_ne_Kosove.ALB.pdf

Tab. 3.4 Ndërmarrjet që janë licencuar, u është vazhduar licenca apo janë në proces të licencimit për aktivitet të furnizimit me shumicë (tregti) të energjisë elektrike gjatë vitit 2025

| Nr. | Emri i ndërmarrjes | Përshkrimi i aktivitetit të Licencuar | Numri i licencës | Adresa, selia e të licencuarit | Vlefshmëria e licencës |
|-----|---|---|--|--|--|
| 1 | Statkraft Markets GmbH Branch in Kosovo | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | ZRRE/Li_100/24 | Rruga Sylejman Vokshi, 50/3, Prishtinë, Republika e Kosovës | 28.03.2025 - 27.03.2030 Lëshim Licence |
| 2 | ALFA COMPANY SH.P.K. ☒ | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | ZRRE/Li_108/25 | Rr. M2, Veternik, Prishtinë, Republika e Kosovës | 07.11.2025 - 06.11.2030 - Lëshim Licence |
| 3 | Energy Kosova V.B. SH.P.K. | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | ZRRE/Li_102/25 | Rr. Hysë Selimi, Nr.18, Pejë, Republika e Kosovës | 10.07.2025 - 09.07.2030 - Lëshim Licence |
| 4 | Al EnergyX Dega në Kosovë | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | Seria T23 Numri i Licencës 544) | Rr. Elez Berisha p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 03.03.2023, për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 22.04.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Shqipërinë) |
| 5 | Alb Energy Trade Dega në Kosovë ☒ | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | Seria T22 Numri i Licencës 540 | Rr. Bekim Fehmiu, Icon Tower Kati 11, Nr.2, Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 28 dhjetor 2022 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 05.09.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). |
| 6 | Volton Shpk Dega në Kosovë | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | Seria T25 Numri i Licencës 615 | ALI PASHË TEPELENA, Hy 31, Kati 2, Nr.4, Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 03 shkurt 2025 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 20.10.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). |
| 7 | Green Value Dega në Kosovë ☒ | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | Seria T25 Numri i Licencës 636 | Dardanet, 21, Çakllavicë, Prishtinë, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 30 shtator 2025 për periudhë prej 5 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 30.12.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Republikën e Shqipërisë). |
| 8 | MEGA KONCEPT Branch in Kosovo ☒ | Furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike | nr.regjistrin të licencës së lëshuar: EE-TRG-1016-2023 | Rr.Qamile Jaka 20, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës | Në fuqi nga 25 maj 2023 për periudhë prej 10 vitesh. (E NJOHUR nga ZRRE me datë 05.09.2025 SIPAS PARIMIT TË RECIPROCITETIT me Maqedoninë e Veriut). |

Subjektet juridike **“Statkraft Markets GmbH Branch in Kosovo”, “ALFA COMPANY SH.P.K.” dhe “Energy Kosova V.B. SH.P.K.”** – kanë aplikuar në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike gjatë vitit 2025. Të njëjtave, pas dorëzimit të dëshmimeve përkatëse sipas Aplikacionit për furnizim me shumicë (tregti) të energjisë elektrike në Kosovë, u është lëshuar licenca për këtë aktivitet për periudhë prej pesë (5) vitesh (2025-2030). Afati i tillë u është lejuar në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ku parashihet që për aktivitetet e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, licenca mund të lëshohet në bazë të rrethanave financiare të parashtruesit të kërkesës, por jo më shumë se pesë (5) vite dhe jo për më pak se një (1) vit.

Subjektet juridike **“AI EnergyX Dega në Kosovë”, “Alb Energy Trade Dega në Kosovë”, “Volton Shpk Dega në Kosovë” dhe “Green Value Dega në Kosovë”** – janë të licencuara në Republikën e Shqipërisë për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, e që të njëjtat pas kërkesës për licencim, janë udhëzuar të regjistrojnë subjektin e tyre si **“Dega në Kosovë”**, të sjellin dëshminë përkatëse dhe të aplikojnë në Rregullator për njohje reciproke të licencës. Të njëjtat pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës sipas Rregullës për Licencim dhe memorandumit të mirëkuptimit të lidhur mes Rregullatorit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë, ZRRE u ka njohur licencën sipas parimit të reciprocitetit, për periudhë prej pesë (5) vitesh, duke filluar nga data e lëshimit të licencës së tyre nga Enti Rregullator i Republikës së Shqipërisë.

Subjekti juridik, i regjistruar në Kosovë si **“MEGA KONCEPT Branch in Kosovo”** – poashtu është i licencuar në Maqedoninë e Veriut për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike si **“MEGA KONCEPT”**, e që i njëjti pas kërkesës për licencim, është udhëzuar të regjistrojnë subjektin e tij në Kosovë si **“Dega në Kosovë”**, të sjellë dëshminë përkatëse dhe të aplikojnë në Rregullator për njohje reciproke të licencës. I njëjti pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës sipas Rregullës për Licencim dhe memorandumit të mirëkuptimit të lidhur mes Rregullatorit të Kosovës dhe atij të Maqedonisë së Veriut, ZRRE i ka njohur licencën sipas parimit të reciprocitetit, filluar nga data e lëshimit të licencës nga Komisioni Rregullator për Energjetikë dhe Shërbime të Ujit, i Maqedonisë së Veriut, për periudhë prej dhjetë (10) vitesh.

Numri i lartë i aplikimeve gjatë këtij viti, si dhe licencimet e viteve paraprake për aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike në Kosovë, përfshirë njohjet reciproke të licencave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, kanë rritur numrin e të licencuarve që kanë pasur të drejtë të tregtojnë me energji elektrike në Kosovë, nga katërdhjetë e dy (42) sa ishte në 2024, në gjashtëdhjetë e tre (63) në vitin 2025. Në vijim është paraqitur tabela e subjekteve juridike, të cilat kanë pasur të drejtë të tregtojnë energji elektrike në Kosovë gjatë këtij viti.

Tab. 3.5 Ndërmarrjet që kanë të drejtë të tregtojnë energji elektrike, sipas licencave të lëshuara nga ZRRE

| Ndërmarrja e regjistruar në Kosovë | Numri i Licencës | Afati i licencës |
|--|----------------------------------|-------------------------|
| 1 Kosovo Electricity Supply Company (KESICO) J.S.C | ZRRE/Tr_2014/Li_07/17 | 13.04.2017-04.10.2036 |
| 2 "GEN-I TIRANA" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË | ZRRE/Li_34/12 | 11.11.2021-10.11.2026 |
| 3 "Danske Commodities Kosovo" SH.P.K. | ZRRE/Li_39/17 | 22.04.2023-21.04.2028 |
| 4 "GSA ENERGJI" SH.P.K. | ZRRE/Li_48/15 | 11.11.2021 - 10.11.2026 |
| 5 "GSA ENERGJI" SH.P.K. | ZRRE/Li_51/17 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 6 FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE DYNAMICS) | ZRRE/Li_55/16 | 13.04.2023 - 12.04.2028 |
| 7 "Interenergo d.o.o-Kosova" SH.P.K. | ZRRE/Li_56/16 | 27.02.2022-26.02.2027 |
| 8 Korporata Energjetike e Kosovës | ZRRE/Li_60/17 | 20.12.2018-19.12.2043 |
| 9 BALKAN ENERGY L.L.C. | ZRRE/Li_67/20 | 23.06.2020 - 22.06.2025 |
| 10 BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K | ZRRE/Li_68/20 | 30.09.2020 - 29.09.2025 |
| 11 RENRGY TRADING GROUP PRISTINA SH.P.K | ZRRE/Li_69/20 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 12 Društvo Elektrosever D.O.O. | ZRRE/Li_70/20 | 24.06.2022-23.06.2027 |
| 13 "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C. | ZRRE/Li_71/20 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 14 FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE Dynamics) | ZRRE/Li_72/21 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 15 Axpo Kosovo L.L.C | ZRRE/Li_73/21 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 16 ETMT ENERGY SH.P.K. | ZRRE/Li_76/21 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 17 EDS International KS L.L.C | ZRRE/Li_77/21 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 18 MCM COMMODITIES SH.P.K | ZRRE/Li_71/21 | 31.03.2022-30.03.2027 |
| 19 NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë | ZRRE/Li_80/21 | 02.09.2021-01.09.2026 |
| 20 HEP Energjia SH.P.K. | ZRRE/Li_83/21 | 27.10.2021-26.10.2026 |
| 21 ETMT ENERGY SH.P.K. | ZRRE/Li_84/22 | 12.10.2022-11.10.2027 |
| 22 SONEL 888 LTD Branch in Kosovo | ZRRE/Li_85/22 | 16.11.2022-15.11.2027 |
| 23 MFT Energy Kosovo L.L.C | ZRRE/Li_86/22 | 16.11.2022-15.11.2027 |
| 24 MCM COMMODITIES SH.P.K | ZRRE/Li_87/23 | 18.08.2023 - 17.08.2028 |
| 25 SharrCem SH.P.K. | ZRRE/Li_88/23 | 05.05.2023-04.05.2028 |
| 26 Eurosol&Energy LTD SH.P.K (Eurosol&Energy LTD) | ZRRE/Li_89/23 | 15.05.2023 - 14.05.2028 |
| 27 Eurosol&Energy LTD SH.P.K (Eurosol&Energy LTD) | ZRRE/Li_90/23 | 18.08.2023 - 17.08.2028 |
| 28 MONTING SH.P.K. | ZRRE/Li_91/23 | 18.08.2023 - 17.08.2028 |
| 29 Yildirim Energy Europe Kosovo SH.P.K (Yildirim Energy Europe) | ZRRE/Li_92/23 | 01.12.2023 - 30.11.2028 |
| 30 SOLE 24 SHPK Dega në Kosovë | ZRRE/Li_93/23 | 21.09.2023 - 20.09.2028 |
| 31 INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K. (INFINIT POWER SOLUTIONS) | ZRRE/Li_94/23 | 21.09.2023 - 20.09.2028 |
| 32 INFINIT POWER SOLUTION SH.P.K. (INFINIT POWER SOLUTIONS) | ZRRE/Li_95/23 | 28.12.2023 - 27.12.2028 |
| 33 Enerco LLC. SH.P.K. | ZRRE/Li_96/24 | 12.11.2024-11.11.2029 |
| 34 TREDINT GROUP L.L.C | ZRRE/Li_99/24 | 12.11.2024-11.11.2029 |
| 35 NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li. 494) | 02.12.2021 për 5 vite |
| 36 EZ5 ENERGY SHPK -Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li. 439) | 08.03.2024 për 5 vite |
| 37 NRG Power Shpk Dega në Kosovë (NRG Power Shpk) | RECIPROCITET (Nr.Li. 514) | 13.07.2022 për 5 vite |
| 38 SPB ENERXHI PRODAKSHN DOOEL Branch in Kosovo | RECIPROCITET (Nr.Li. 439) | 06.09.2021 për 10 vite |
| 39 INFINIT ENERGY DOOEL Dega në Kosovë | RECIPROCITET (EE-SNAB-1027-2023) | 01.06.2023 për 10 vite |

| Ndërmarrja e regjistruar në Kosovë | Numri i Licencës | Afati i licencës |
|---|-------------------------------------|-------------------------|
| 40 INFINIT ENERGY DOOEL Dega në Kosovë | RECIPROCITET (EE-TRG-972-2023) | 04.05.2023 për 10 vite |
| 41 Protergia Energy Albania Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li.576) | 12.04.2024 për 5 vite |
| 42 Protergia Energy Albania Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li. 575) | 12.04.2024 për 5 vite |
| 43 Statkraft Markets GmbH Branch in Kosovo | ZRRE/Li_100/24 | 28.03.2025 - 27.03.2030 |
| 44 Al EnergyX Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li. 544) | 3.3.2023 për 5 vite |
| 45 VoltKos SH.P.K. | ZRRE/Li_101/25 | 27.05.2025 - 26.05.2030 |
| 46 Al EnergyX Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li. 545) | 13.3.2023 për 5 vite |
| 47 Energy Kosova V.B. SH.P.K. | ZRRE/Li_102/25 | 10.07.2025 - 09.07.2030 |
| 48 Management & Development Associates L.L.C. | ZRRE/Li_103/25 | 10.07.2025 - 09.07.2030 |
| 49 Energy for Change L.L.C. | ZRRE/Li_104/25 | 05.09.2025 - 04.09.2030 |
| 50 Norwegian PX Kosovë SH.P.K. | ZRRE/Li_105/25 | 05.09.2025 - 04.09.2030 |
| 51 Energy Development Group Kosova L.L.C | ZRRE/Li_106/25 | 05.09.2025 - 04.09.2030 |
| 52 BE Power SH.P.K. | ZRRE/Li_107/25 | 05.09.2025 - 04.09.2030 |
| 53 ALFA COMPANY SH.P.K. | ZRRE/Li_108/25 | 07.11.2025 - 06.11.2030 |
| 54 Alb Energy Trade Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li 532) | 25.11.2022 për 5 vite |
| 55 Alb Energy Trade Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li 540) | 28.12.2022 për 5 vite |
| 56 MEGA KONCEPT Branch in Kosovo | RECIPROCITET (Nr.EE-SNAB-1017-2023) | 25.05.2023 për 10 vite |
| 57 MEGA KONCEPT Branch in Kosovo | RECIPROCITET (Tr.EE-TRG-1016-2023) | 25.05.2023 për 10 vite |
| 58 SWISS SOLAR PARK L.L.C. | ZRRE/Li_109/25 | 07.11.2025-06.11.2030 |
| 59 SolarNeo SH.P.K. | ZRRE/Li_110/25 | 07.11.2025 - 06.11.2030 |
| 60 Volton Shpk Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li 600) | 10.12.2024 për 5 vite |
| 61 Volton Shpk Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li 615) | 03.02.2025 për 5 vite |
| 62 Eco Park Group SH.P.K. | ZRRE/Li_111/25 | 18.12.2025 - 17.12.2050 |
| 63 Green Value Dega në Kosovë | RECIPROCITET (Nr.Li 636) | 30.9.2025 për 5 vite |

3.2 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë

Monitorimi/mbikqyrja e ndërmarrjeve të energjisë është një ndër kompetencat kryesore të Rregullatorit të energjisë, përgjegjësi e cila parashihet me Kreun XII të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjisllacionin sekondar.

Kështu, Rregullatori, si edhe viteve tjera edhe këtë vit ka vazhduar me monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara për aktivitetet e energjisë, duke u siguruar nëse ndërmarrjet janë duke vepruar në pajtueshmëri me kushtet e licencës, zbatimin e rregullave, akteve individuale dhe vendimeve tjera të lëshura nga Rregullatori apo legjisllacioni tjetër në fuqi. Monitorimi bëhet duke kërkuar raporte dhe të dhëna nga të licencuarit, duke mbajtur takime, si dhe duke vizituar (monitoruar) të licencuarit, me apo pa paralajmërim.

Edhe gjatë vitit 2025, Rregullatori ka monitoruar ndërmarrjet e licencuara të energjisë, posaqërsht ato mbi 5 MW, por po ashtu ka monitoruar edhe ndërmarrjet që janë në proces të ndërtimit përmes procedurës së autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja.

Monitorimi sipas Doracakut të Raportimit në Sektorin e Energjisë – sipas këtij doracaku, ndërmarrjet e licencuara të energjisë kanë dërguar në Rregullator raporte të menjëhershme, tremujore, apo vjetore, varësisht nga kërkesat e përshkurara në këtë doracak apo kërkesat e Rregullatorit.

Për disa nene të licencës, të një rëndësie më të veçantë, pra shkelje të kushteve të licencës që mund të kenë ndikim serioz mbi politikën qeveritare, të konsumatorët ose në koston për kompensim, i licencuari duhet ta njoftojë menjëherë Rregullatorin. Në rast se një njoftim i tillë nuk bëhet me kohë, Rregullatori ka të drejtë të vendos masa administrative ose gjoha në pajtim me Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Monitorimi i Programit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS Sh.A) – ky program është në fuqi që nga viti 2015 (V_750_2015), i cili është i aprovuar nga Bordi i Rregullatorit. Pas kërkesës së Rregullatorit, i njëjti është modifikuar dhe aprovuar nga Bordi i Rregullatorit gjatë vitit 2020 (V_1223_2020), ku sipas të cilit Zyrtari i Pajtuëshmërisë i KEDS (i aprovuar me vendimin V_1256_2020) ka raportuar në Rregullator lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë program.

Monitorimi i Programit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (KOSTT Sh.A) – ky program është në fuqi nga dt. 27 nëntor 2019, përmes vendimit V_1203_2019, i cili është i aprovuar nga Bordi i Rregullatorit. Pas propozimit nga KOSTT, Bordi i Rregullatorit me datë 14 tetor 2019 përmes Vendimit V_1186_2019 ka emëruar Zyrtarin e Pajtuëshmërisë së KOSTT-it i cili ka raportuar në Rregullator lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë program të pajtuëshmërisë.

Garancitë e Origjinës (GO) – sipas Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Garancia e Origjinës është një dokument elektronik që ka funksionin e vetëm të ofrojë dëshmi për konsumatorin fundor se një pjesë ose sasi e caktuar e energjisë prodhohet nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe e cila mund të përdoret edhe për qëllime shitjeje. Sipas po të njëjtit ligj, Zyra e Rregullatorit për Energji është autoritet kompetent për lëshimin e Garancive të Origjinës. Gjithashtu ZRRE sipas këtij ligji dhe ligjit për Rregullatorin e Energjisë mban regjistrin për GO, nxjerr tarifa për GO si dhe është përgjegjëse për korrektësinë, besueshmërinë dhe mbrojtjen nga mashtrimi, për këtë çështje.

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, ZRRE ka mandat të mbikëqyrë lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtërishme, dhe duhet të krijojë mekanizma përkatës për të siguruar lëshimin, transferimin dhe anulimin elektronik të garancive të origjinës si dhe për të siguruar se ato janë të sakta, të besueshme dhe të pafalsifikueshme.

Pra ZRRE në kuadër të këtyre përgjegjësisë, të dhëna me legjislacionin në fuqi, gjatë vitit 2025, përmes projektit KSV/024 *“Tranzicioni Energjistik dhe Zbutja e Ndikimeve Klimatike”*, i financuar nga Qeveria e Dukës së Madh të Luksemburgut dhe i zbatuar nga Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor (LuxDev), ka hartuar draft rregullën për garanci të origjinës, e cila është dërguar te palët e interesit për komente. Gjithashtu është zhvilluar vizitë studimore në Rregullatorin e Suedisë lidhur me funksionimin e garancive të origjinës.

Vlen të ceket se ZRRE gjatë vitit 2024 ka aktivizuar sistemin e Garancive të Origjinës përmes platformës GREXEL, e cila është pjesë e EEX që nga viti 2019, ndërsa nga 1 janar 2026 do të jetë pjesë e integruar në platformën EEX (www.eex.com). Regjistri në këtë platformë është i lidhur me regjistrat tjerë të Komunitetit të Energjisë dhe teknikisht është plotësisht në përputhje me Standardin AIB EECs.

Duke qenë një proces jo i lehtë dhe mjaft kompleks, gjatë vitit 2025, nuk ka pasur aplikime për garanci të origjinës në ZRRE.

Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë termike – Duke qenë se monitorimi është ndër aktivitetet e rregullta që ndërmerren në vazhdimësi nga ZRRE, në vitin 2025 janë monitoruar realizimet dhe performanca e ndërmarrjeve NQ Termokos dhe NQ Gjakova; monitorimi i realizimeve ka përfshirë:

- Bilancin e energjisë: prodhimin dhe furnizimin me energji termike si dhe humbjet në rrjet;
- Realizimin e të hyrave (faturimit dhe arkëtimit) dhe kostove operative;
- Realizimin e kostove kapitale – konkretisht investimeve të reja të lejuara;
- Kyçjet e reja dhe kontratat e furnizimit të konsumatorëve;
- Shfrytëzimin e pa-autorizuar dhe shkyçjet; dhe
- Ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe adresimi i tyre nga ndërmarrjet respektive.

3.2.1 Kontestet gjyqësore administrative

Gjatë vitit 2025, një pjesë e vendimeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji, të nxjerra nga Bordi i ZRRE-së, në ushtrimin e kompetencave rregullative në fushën e tarifave dhe të hapjes së tregut të energjisë elektrike, kanë qenë objekt i kontestimit gjyqësor në Gjykatën Themelore, Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative.

Kontestet gjyqësore të trajtuara në këtë pjesë lidhen me vendimmarrjen e Bordit të ZRRE-së, në çështje me ndikim rregullativ, përfshirë aprovimin e tarifave dhe zbatimin e masave për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Këto vendime janë nxjerrë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe në ushtrim të kompetencave të përcaktuara për rregullatorin.

ZRRE ka mbrojtur ligjshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vendimeve të Bordit në këto procese gjyqësore, duke vepruar në përputhje me parimet e administrimit të drejtë, sigurisë juridike dhe praktikës rregullative të konsoliduar. Për një pjesë të rasteve, gjykatat kanë vendosur duke lënë në fuqi vendimet e Bordit të ZRRE-së, ndërsa për raste të tjera procedurat gjyqësore janë ende në zhvillim.

Në vijim do të paraqiten rastet individuale të kontesteve gjyqësore administrative që lidhen me vendimmarrjen e Bordit në tarifatat dhe hapjen e tregut, me përshkrim të përmbledhur të objektit të kontestit dhe statusit procedural.

Vendimi i ZRRE-së, V 2703 2025 dt. 16 prill 2025, në lidhje aprovimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 01 maj 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor, i cili është kontestuar nga Organizata Jo Qeveritare “Ta pastrojmë Kosovës”, Organizata Jo Qeveritare “Konsumatori”, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, deri në vendosjen definitive nga ana e gjykatës.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur për kërkesën për pezullim të zbatimit të vendimit V_2703_2025, me datë 12.05.2025, ka nxjerr Aktvendim A. Nr. 1476/2025 dhe ka refuzuar kërkesën e paditësit, si të pa bazuar. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative pas pranimit të ankesës së paditësve dhe përgjegjës në ankesë me Aktvendimin AA.nr. 488/2025 të dt. 26.05.2025 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 1476/2025 dt. 12.05.2025.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të cilën kanë kërkuar anulimin e Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, me kërkesën për sigurimin e padisë, me të cilën ka kërkuar pezullimin e Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar mbi këtë konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur për kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë të Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, ka nxjerr Aktvendim A. Nr. 1839/2025 me datë 19.06.2025 me të cilën ka refuzuar kërkesën e paditësit, si të pa bazuar. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative pas pranimit të ankesës së paditësit dhe përgjegjës në ankesë me Aktvendimin e ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 1839/2025 me datë 19.06.2025.

Partia Demokratike e Kosovës, ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me të cilën kanë kërkuar anulimin e Vendimit V_2724_2025 dhe ndërprerjen e zbatimit të Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, me të cilën kanë kërkuar pezullimin e Vendimit V_2724_2025 të datës 12 qershor 2025 dhe pezullimin e zbatimit të Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për padinë e paditësit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur për kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit V_2724_2025 të datës 13.02.2026 dhe Njoftimit publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë të datës 12 mars 2025 të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), deri në vendosjen e çështjes sipas padisë, ka nxjerr Aktvendim A. Nr. 2124/2025 me datë 04.07.2025 me të cilën ka refuzuar kërkesën e paditësit, si të pa bazuar. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative pas pranimit të ankesës së paditësit dhe përgjegjës në ankesë me Aktvendimin AA. Nr. 718/2025 të datës 30.07.2025 e ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 2124/2025 me datë 04.07.2025.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Shoqata e Prodhuesve të Kosovës, kanë parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me të cilën kanë kërkuar anulimin e Njoftimit publik të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, me kërkesën për sigurimin e padisë, me të cilën ka kërkuar pezullimin e Njoftimit publik të

Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikuar me datë 12 mars 2025, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar mbi këtë konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur për kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë për pezullimin e Njoftimit publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë të datës 12 mars 2025 të lëshuar nga Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka nxjerr Aktvendim A. Nr. 2141/2025 me datë 04.07.2025 me të cilën ka refuzuar kërkesën e paditësit, si të pa bazuar. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative pas pranimit të ankesës së paditësit dhe përgjegjës në ankesë me Aktvendimin AA.nr. 719/2025 të datës 30.07.2025 e ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e paditësit, ndërsa ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A. Nr. 2141/2025 me datë 04.07.2025.

Oda Ekonomike e Kosovës po ashtu ka parashtruar padi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia, dhe të shfuqizohet akti nënligjor normativ –Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë i datës 18.01.2017 (përkatësisht neni 8) dhe Udhëzuesi për ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me datë 13 qershor 2018, si dhe më datë 30 tetor 2018, dhe i miratuar më 28 mars 2019 (përkatësisht neni 2), si dhe aktin njoftimin publik i ZRRE për liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë, i publikuar më datë 12.03.2025, me kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullimin në tërësi dhe ndalimin e përkohshëm të implementimit të kushteve të vendosura sipas aktit të njoftimit publik të datës 12 mars 2025.

Gjykata Supreme e Kosovës fillimisht përmes Aktvendimit P.A. nr. 18/2025 të datës 26.08.2025 ka hedhur poshtë kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të parashtruar nga paditësi: Oda Ekonomike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar pezullimin dhe ndalimin e përkohshëm të implementimit të kushteve të vendosura sipas aktit njoftimit publik të datës 12.03.2025, si të palejueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit P.nr. 18/2025 të datës 05.11.2026 fillimisht ka shfuqizuar drejtpërdrejt Nenin 8 të Udhëzuesit të vitit 2017 dhe Nenin 2 të ndryshimeve dhe plotësimeve të viteve 2018–2019, duke konstatuar se këto dispozita kanë krijuar paqartësi juridike për konsumatorët për shkak të mungesës së arsytimit të mjaftueshëm dhe interpretimit të kuadrit ligjor në raport me Direktivën 2009/72/EC. Por, Gjykata Supreme përmes këtij Aktgjykimi ka bërë interpretimin e detyrueshëm të Nenit 37 paragrafi 2, në lidhje me Nenin 3 paragrafi 1.72 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në përputhje me Nenin 3(3) të Direktivës 2009/72/EC, duke sqaruar se e drejta për shërbim universal u takon konsumatorëve familjarë dhe vetëm ndërmarrjeve të vogla që i plotësojnë kumulativisht kriteret ligjore për numrin e punonjësve dhe qarkullimin vjetor. Prandaj ZRRE ka vazhduar zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike në përputhje me Nenin 3(3) të Direktivës 2009/72/EC, ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata Supreme, pa zgjerim apo kufizim përtej kriterëve të përcaktuara nga ligji primar, duke i konstatuar edhe me Vendimin V_2994_2025 të datës 18 dhjetor 2025, veprimet e ndërmarra për zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në përputhje me Direktivës 2009/72/EC.

ZRRE ka trajtuar edhe kërkesa tjera, ku ka paraqitur prapësime procedura në paditë dhe kërkesëpaditë e paditëse juridik dhe atyre fizik, ankesa dhe përgjigje në padi dhe në ankesa si dhe ka parashtruar edhe kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshme të vendimeve gjyqësore edhe në lëndë tjera, për të cilat është në pritjet të aktvendimeve dhe aktgjykimeve meritore nga gjykatat e rregullta.

3.3 Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)

Zhvillimi dhe promovimi i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE) në Republikën e Kosovës rregullohet përmes një kornize ligjore dhe strategjike të konsoliduar, e cila synon shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialeve vendore të energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmbushjen e obligimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në sektorin e energjisë.

Politika për zhvillimin e BRE-ve, është e përcaktuar me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081, i cili përcakton parimet bazë për promovimin e shfrytëzimit ekonomik dhe të qëndrueshëm të burimeve të energjisë, si pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës. Kjo politikë synon diversifikimin e miksit energjetik dhe mbështetjen e investimeve në teknologji të pastra të gjenerimit të energjisë.

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, si dhe i infrastrukturës përkatëse energjetike, realizohet përmes procedurave të autorizimit të administruar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në bazë të kritereve objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, është forcuar më tej korniza ligjore për zhvillimin e BRE-ve, duke përcaktuar masa për rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtërishme në sektorin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes, si dhe në sektorin e transportit. Ky ligj synon përmbushjen e nevojave për energji, rritjen e sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe kontribuon në harmonizimin gradual të legjislacionit vendor me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë.

Republika e Kosovës, si palë nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, ka marrë obligime të detyrueshme për zhvillimin e sektorit të energjisë, përfshirë arritjen e caqeve për energjinë nga burimet e ripërtërishme. Në këtë kontekst, zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE përbën një element kyç për përmbushjen e këtyre obligimeve dhe për tranzicionin drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 përcakton burimet e ripërtërishme të energjisë si një nga shtyllat kryesore për diversifikimin e miksit të gjenerimit dhe për uljen graduale të varësisë nga prodhimi i bazuar në linjit. Në përputhje me këtë strategji, parashihet që kapacitetet e reja gjeneruese nga BRE, përmes teknologjive ekzistuese dhe inovative, të kontribuojnë në tranzicionin energjetik afatgjatë.

Në zbatim të kësaj kornize ligjore dhe strategjike, janë nxjerrë akte nënligjore përkatëse nga Ministria e Ekonomisë dhe ZRRE, të cilat rregullojnë llojet e burimeve të ripërtërishme të energjisë, kushtet teknike dhe procedurale për shfrytëzimin e tyre, si dhe mekanizmat mbështetës për realizimin e projekteve nga BRE, përfshirë edhe skemat e vetë-konsumit.

3.4 Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja

Zyra e Rregullatorit për Energji, gjatë vitit 2025 ka vazhduar zbatimin e procedurave të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi. Procedura e autorizimit përbën instrumentin kryesor rregullativ për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm, të kontrolluar dhe transparent të projekteve energjetike në Republikën e Kosovës.

Procesi i autorizimit për ndërtim të projekteve energjetike zhvillohet mbi bazën e kriterëve objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, duke përfshirë verifikimin e dokumentacionit ligjor, administrativ, teknik dhe financiar të aplikuesve. Në këtë kuadër, ZRRE siguron që ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të jetë në përputhje me interesin publik, sigurinë e sistemit energjetik dhe zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë.

Autorizimi për ndërtim lëshohet vetëm pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara me rregullën përkatëse dhe pas sigurimit të lejeve relevante nga institucionet kompetente, në përputhje me veprimtarinë për të cilën është parashtruar kërkesa. ZRRE, përmes këtij procesi, ushtron rolin e saj rregullativ në zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

ZRRE gjatë vitit 2025 nga subjektet e ndryshme juridike gjenerator komercial ka pranuar 10 aplikacione për marrje të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE me një kapacitet total prej 128.483 MW. Janë pranuar dhe shqyrtuar 283 kërkesa të personave fizik dhe juridik për marrjen e Autorizimit për gjeneratorët për vet-konsum me një kapacitet total prej 11.062 MW.

3.4.1 Aplikacionet që janë në proces të shqyrtimit në Rregullator

Gjatë vitit 2025, ZRRE ka trajtuar edhe aplikacione për autorizim që ndodhen në faza të ndryshme të shqyrtimit dhe kompletimit. Këto aplikacione i nënshtrohen procedurës së verifikimit të dokumentacionit dhe plotësimit të kushteve të përcaktuara me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

Projektet në proces shqyrtimi janë në faza të ndryshme të shqyrtimit administrativ, aspekteve ligjore, teknike dhe financiare si dhe të dokumenteve administrative të lejeve dhe pëlqimeve të lëshuara nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës. ZRRE, në këtë fazë, ofron udhëzime procedurale dhe siguron trajtim të barabartë të të gjithë aplikuesve, në përputhje me parimet e administrimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Tab. 3.6 Shoqëritë që janë në proces të shqyrtimit për marrjen e vendimit për autorizim

| Nr. | Subjekti Juridik | Objekti | Lokacioni | Kapaciteti i instaluar | Statusi i aplikimit |
|-----|---------------------------|------------|-------------------------------|------------------------|-----------------------|
| 1 | MDYNAMIC SOLUTIONS L.L.C. | Solare | Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë | 7.18 MW | Proces të kompletimit |
| 2 | ESHA ENERGY L.L.C. | Solare | Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë | 2.32 MW | Proces të kompletimit |
| 3 | ESHA ENERGY L.L.C. | Solare | Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë | 8.12 MW | Proces të kompletimit |
| 4 | EUROKOS DD SH.P.K | Reverzibil | DRINI PSHP/ Prizren | 250 MW | Proces të kompletimit |
| 5 | NIN TECHNOLOGY SH.P.K. | Biomasa | Ferizaj | 5.2 MW | Proces të kompletimit |
| 6 | DARDANA INVEST SH.P.K. | Wind/ERA | WIND PARK KITKA 2/Kamenica | 33 MW | Proces të kompletimit |

3.4.2 Projektet në proces të ndërtimit sipas Autorizimit

Projektet që janë pajisur me Autorizim nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe që ndodhen në proces të ndërtimit realizohen në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimet përkatëse, si dhe me planet dinamike të realizimit të aprovuara. Këto projekte përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe në avancimin e objektivave strategjike të sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2025, projektet në proces ndërtimi sipas Autorizimit janë përcjellë nga ZRRE përmes mekanizmave rregullativ të monitorimit, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së realizimit të tyre me kushtet e autorizimit, respektimit të afateve kohore dhe përmbushjes së obligimeve teknike, administrative dhe financiare. Në këtë kuadër, është kushtuar vëmendje e veçantë realizimit të projekteve në përputhje me planet dinamike të deklaruara nga investitorët.

Projektet në ndërtim sipas Autorizimit përfshijnë iniciativa të zhvilluara si përmes mekanizmave të tregut, ashtu edhe përmes skemave mbështetëse të përcaktuara nga politika publike në sektorin e energjisë. Këto projekte kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve gjeneruese nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe në diversifikimin e miksit energjetik.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2025 është pajisur me Autorizim edhe projekti solar i përzgjedhur përmes procedurës së ankandit për energji të ripërtëritshme, i zhvilluar nga Ministria e Ekonomisë në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi. Ky projekt përfaqëson një model të zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese përmes mekanizmave konkurrues dhe transparente, me qëllim të sigurimit të çmimeve të përballeshme dhe rritjes së sigurisë së furnizimit.

ZRRE, në ushtrimin e kompetencave të saj rregullative, ka shqyrtuar dhe miratuar autorizimin për ndërtimin e këtij projekti në përputhje me rregulloren për procedurën e autorizimit, duke siguruar që kushtet teknike, administrative dhe ligjore të jenë të përmbushura. Projekti pritet të realizohet sipas afateve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës dhe në planin dinamik të realizimit, duke kontribuar në arritjen e objektivave strategjike për energjinë nga burimet e ripërtëritshme.

Tab. 3.7 Projektet që janë në proces të ndërtimit me autorizim

| Nr. | Subjekti Juridik | Objekti | Lokacioni | Kapaciteti i instaluar | Data e Lëshimit të Autorizimit |
|-----|-----------------------------------|--------------------|--|------------------------|--------------------------------|
| 1 | SVB SH.P.K. | Solare | Sinajë, Komuna e Istogut | 3 MW | 12 qershor 2025 |
| 2 | QAZIM R. GASHI B.I. | Solare | Babimoc, Projekti 1 Komuna e Obiliqit | 1.5 MW | 05 shtator 2025 |
| 3 | QAZIM R. GASHI B.I. | Solare | Babimoc, Projekti 2 Komuna e Obiliqit | 1 MW | 05 shtator 2025 |
| 4 | QAZIM R. GASHI B.I. | Solare | Babimoc, Projekti 3 Komuna e Obiliqit | 1.5 MW | 05 shtator 2025 |
| 5 | EBE ENERGY SH.P.K. | Solare | Shtime, Komuna e Shtimes | 3 MW | 05 shtator 2025 |
| 6 | LINDJA SOLAR L.L.C. | Solare | Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit | 100 MW | 05 shtator 2025 |
| 7 | ERIS SOLAR SH.P.K. | Solare | Bellopojë, Komuna e Istogut | 3.5 MW | 07 nëntor 2025 |
| 8 | DIOBES SOLAR SH.P.K. | Solare | Sojevë, Komuna e Ferizajt | 9 MW | 18 dhjetor 2025 |
| 9 | EV Wind Park SH.P.K. | Wind Park ZATRIC 1 | Zatric, Komuna e Rahovecit | 35 MW | 07 gusht 2024 |
| 10 | EV Wind Park SH.P.K. | Wind Park ZATRIC 2 | Zatric, Komuna e Rahovecit | 35 MW | 07 gusht 2024 |
| 11 | SOLAR GATE L.L.C | Solare | Lllashticë e Epërme, Komuna e Podujevës | 3 MW | 12 nëntor 2024 |
| 12 | SOLAR ENERGY GROUP EUROPE SH.P.K. | Solare | Projekti SEGE, Lok. ZK BEC - VRANIQ, Komuna e Gjakovës | 150 MW | 18 gusht 2023 |
| 13 | 2 Korriku SH.P.K. | Hidro | HC Soponica, Komuna e Kaçanikut | 3.75 MW | 24 qershor 2022 |

3.4.3 Hyrja në operim e gjeneratorëve nga BRE

Hyrja në operim e gjeneratorëve nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë realizohet pas përfundimit të ndërtimit të projekteve dhe pas përmbushjes së të gjitha kushteve teknike, administrative dhe rregullative të përcaktuara me autorizim. Ky proces përfshin pranimin teknik të objekteve gjeneruese dhe verifikimin e përputhshmërisë me kodet e rjetit dhe kriteret teknike në fuqi, të menaxhuara nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes, varësisht nga niveli i kycjes.

ZRRE, në bashkëpunim me operatorët përkatës të sistemit, siguron që hyrja në operim e kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në mënyrë të sigurt dhe të koordinuar, duke respektuar kërkesat për funksionimin stabil të sistemit energjetik. Energjia e prodhuar nga këta gjenerator do të shitet në kushte të tregut.

Tab. 3.8 Projektet që kanë hyr në operim gjatë vitit 2025

| Nr. | Subjekti Juridik | Objekti | Lokacioni | Kapaciteti i instaluar | Hyrja në operim |
|-----|---|---------|---|------------------------|-----------------|
| 1 | Energy Development Group - Kosova SH.P. | Solare | Lokacioni, Kusar, Komuna e Gjakovës | 6 MW | Tetor 2025 |
| 2 | Eko Park Group SH.P.K | Solare | Lokacioni, Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës | 6 MW | Nëntor 2025 |
| 3 | Vita Energy SH.P.K. | Solare | Lokacioni, Madanaj, Komuna e Gjakovës | 3 MW | Nëntor 2025 |
| 4 | VBS SH.P.K. | Solare | Lokacioni, Madanaj, Komuna e Gjakovës | 3 MW | Dhjetor 2025 |
| 5 | ELEKTROHETA SH.P.K | Solare | Varosh, komuna e Ferizajt | 3 MW | Dhjetor 2025 |
| 6 | LURN SH.P.K. | Solare | Shajkoc, Komuna e Podujevës | 0.483 MW | Dhjetor 2025 |

Fig. 3.1 Pamje nga realizimi i një gjeneratori Solar – ELEKTROHETA SH.P.K. Kapaciteti 3000 kW, Ferizaj



3.5 Gjeneratorët për vetë-konsum

Gjeneratorët për vetë-konsum përbëjnë një segment të rëndësishëm në zhvillimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në Republikën e Kosovës, duke u mundësuar konsumatorëve të energjisë elektrike që të prodhojnë energji për nevojat e tyre vetanake, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.

Gjatë vitit 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues për vetë-konsum. Këto kërkesa janë paraqitur nga persona fizikë dhe juridikë dhe janë trajtuar në përputhje me procedurat e përcaktuara me rregulloret përkatëse, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i vendimeve të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së, dhe kapaciteti total i instaluar për gjeneratorët për vetë-konsum gjatë vitit 2025.

Tab. 3.9 Autorizimet për vetë-konsum

| Vendime për vetë-konsum | Nr. i vendimeve të lëshuara |
|---------------------------------------|-----------------------------|
| Solare | 283 |
| Totali kapacitete të instaluar | 11.062 MW |

Procesi i trajtimit të kërkesave për vetë-konsum ka përfshirë verifikimin e dokumentacionit përkatës, shqyrtimin e përputhshmërisë teknike të projekteve, si dhe koordinimin me operatorët e rrjetit përkatës, me qëllim të sigurimit të funksionimit të sigurt të sistemit energjetik. ZRRE, në këtë kontekst, ka ushtruar rolin e saj rregullativ duke balancuar interesin e konsumatorëve për vetë-prodhim me nevojën për stabilitet dhe besueshmëri të rrjetit.

Gjeneratorët për vetë-konsum mund të funksionojnë brenda skemave mbështetëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si dhe jashtë këtyre skemave, në bazë të marrëveshjeve kontraktuale

ndërmjet konsumatorëve prodhues dhe furnizuesve të energjisë elektrike. Në të dy rastet, aplikuesit janë të obliguar të përmbushin kushtet teknike dhe procedurale, si dhe të respektojnë rregullat për menaxhimin e tepricave të energjisë së prodhuar.

ZRRE ka vijuar me monitorimin e zbatimit të autorizimeve për vet-konsum, duke përcjellë realizimin e projekteve dhe përputhshmërinë e tyre me kriteret e përcaktuara. Ky proces ka kontribuar në rritjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, në fuqizimin e rolit aktiv të konsumatorëve në tregun e energjisë dhe në mbështetjen e objektivave të tranzicionit energjetik.

Në këtë kontekst, vetë-konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme të Energjisë, pavarësisht nëse janë pjesë e skemës mbështetëse apo jashtë saj, i nënshtrohen obligimit për të kontribuar në kostot e sistemit dhe të rrjetit, në përputhje me dispozitat e rregulloreve në fuqi, me qëllim të menaxhimit të ndikimit të tyre në rrjet dhe sigurimit të funksionimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të sistemit energjetik.




Fig. 3.2 Pamje nga realizimi i një gjeneratori për vet-konsum subjekt juridik 200 kW



Fig. 3.3 Pamje nga realizimi i një gjeneratori për vet-konsum Person Fizik 7 kW.

ZRRE, po ashtu ka pranuar edhe kërkesa tjera nga personat fizik dhe juridik, të cilat janë në fazë të shqyrtimit dhe sipas procedurave në fuqi, pas kompletimit do të lejohen në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga gjeneratorët për vetë-konsum.

3.6 Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese

Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese realizohet në kuadër të kompetencave rregullative të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe përbën një komponent thelbësor të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimeve për autorizim. Qëllimi i këtij procesi është të sigurojë që projektet energjetike të zhvillohen në përputhje me kushtet e autorizimit, kornizën ligjore në fuqi dhe parimet e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe interesit publik.

Gjatë vitit 2025, monitorimi i projekteve në ndërtim është realizuar përmes mekanizmave administrativ të përcaktuar me legjislacionin sekondar dhe vendimet përkatëse të ZRRE-së. Ky monitorim ka përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga subjektet e autorizuar, raportimet mbi progresin e punimeve, verifikimin e respektimit të planeve dinamike të realizimit, si dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe administrative që rrjedhin nga autorizimet e lëshuara.

Në kuadër të procesit të monitorimit, ZRRE ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektet e autorizuar, duke kërkuar sqarime shtesë dhe përditësime lidhur me fazat e realizimit të projekteve, kurdoherë që është vlerësuar e nevojshme. Po ashtu, monitorimi ka përfshirë bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet tjera kompetente, përfshirë operatorët e sistemit dhe autoritetet publike përkatëse, në funksion të sigurimit të përputhshmërisë së projekteve me kërkesat ligjore dhe teknike.

ZRRE ka trajtuar kërkesat për shtyrje të afateve të autorizimit dhe për përditësimin e planeve dinamike të realizimit, duke i vlerësuar ato në përputhje me dispozitat e rregullores për procedurën e autorizimit dhe duke siguruar që çdo vendim i marrë të bazohet në kriteret objektive, transparente dhe të verifikueshme. Në këtë proces, është kushtuar vëmendje e veçantë respektimit të obligimeve që lidhen me garancionet financiare dhe kushtet e tjera të autorizimit.

Monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese ka shërbyer gjithashtu si bazë për identifikimin e çështjeve me rëndësi rregullative, përfshirë nevojën për përmirësimin e procedurave, sqarimin e kërkesave administrative dhe harmonizimin e mëtejshëm të praktikës rregullative. Ky proces ka kontribuar në forcimin e sigurisë juridike për subjektet e autorizuar dhe në rritjen e transparencës së veprimeve rregullative.

ZRRE do të vazhdojë me zbatimin dhe zhvillimin e mekanizmave të monitorimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, në përputhje me zhvillimet në sektorin e energjisë dhe objektivat.

Pas vlerësimit të situatës në vend punishtet, është vërtetuar se aplikuesit ishte duke realizuar punimet sipas planit dinamik të prezantuar nga ana e tij, mirëpo për të finalizuar projektin duhet të vazhdohet afati i vlefshmërisë sipas planit dinamik të ri, dhe të silltet garancioni financiar i vazhduar në pajtim me nenin 18 të Rregullës së Autorizimit

Me vendimet V_2559_2024 dhe V_2603_2024 janë aprovuar kërkesat për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimeve për Autorizim për vazhdim të ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese nga panelet solare sipas planeve dinamike të propozuara nga aplikuesit.

ZRRE do të vazhdojë me monitorimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, duke i respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3.7 Integrimi i tregut

3.7.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike Alpex dhe Bashkimi i Tregut Kosovë- Shqipëri

Në 27 prill 2016, me qëllim përmbushjen e objektivave të Pakos së Tretë të BE-së për krijimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe bazuar në angazhimet e marra në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Vjenë (27 gusht 2015), Kosova dhe Shqipëria nisën procesin për krijimin e operatorëve të tregut (bursave) dhe bashkimin e tregjeve të Ditës në Avancë (DAM) dhe Brenda Ditës (IDM). Ky proces u avancua më tej me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në qershor 2018 ndërmjet OST, KOSTT dhe rregullatorëve përkatës, si dhe me marrëveshjet e mëvonshme rregullatore dhe operacionale. Në dhjetor 2020, ZRRE miratoi delegimin e kompetencave tek ALPEX për organizimin e tregut për Kosovën, ndërsa në maj 2021 u hap dega e ALPEX në Prishtinë. Marrëveshja Kornizë e vitit 2021 dhe miratimi i rregullave të përbashkëta në dhjetor 2022, si dhe amendamentet e vitit 2024, krijuan bazën e plotë rregullative për operimin e tregjeve të integruara ndërmjet dy vendeve.

ALPEX operon si Operator i Emëruar i Tregut (NEMO) për Shqipërinë dhe Kosovën, duke menaxhuar tregjet e organizuara me shumicë të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2025, tregu i Ditës në Avancë arriti një volum të tregtuar prej 1,641,291.86 MWh, me çmim mesatar klerues 118.38 €/MWh dhe faturim total rreth 369 milionë euro, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak.

Rrjedha ndërkufitare arriti në 351,152.95 MWh, me dominim të flukseve nga Shqipëria drejt Kosovës 209,779.02 MWh dhe 141,373.92 MWh në drejtim të kundërt, duke reflektuar integrim të avancuar dhe përdorim efikas të kapaciteteve ndërkufitare.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 u konsolidua edhe Tregu i Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë (CRIDA), ku u tregtua një volum prej 29,442.24 MWh me çmim mesatar 139.17 €/MWh. Rrjedhat ndërkufitare në këtë treg arritën në 22,945.73 MWh, të shpërndara pothuajse në mënyrë të balancuar ndërmjet dy vendeve. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së fleksibilitetit të sistemit dhe optimizimit të pozicioneve të tregut në afat të shkurtër.

Në aspektin institucional dhe të zhvillimit të tregut, ALPEX ka vijuar zgjerimin e pjesëmarrjes dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke u përfshirë në iniciativat evropiane si ENTSO-E, SDAC dhe SIDC. Operimi i suksesshëm i tregjeve të bashkuara Shqipëri–Kosovë, pa raste të ndarjes së plotë dhe me konvergencë të çmimeve në mbi 99% të kohës, dëshmon për një treg të konsoliduar, në rritje dhe në përputhje të vazhdueshme me standardet e tregut të përbashkët evropian të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025 ALPEX anëtarësoi 11 Anëtarë të rinj Burse dhe 1 Anëtar të ri të Përgjithshëm Klerimi, duke arritur numrin total prej 45 Anëtarë Burse dhe 5 Anëtarë të Përgjithshëm Klerimi në fund të vitit.

Treguesit Vjetore të tregtimit të ALPEX gjatë vitit 2025 për tregun një ditë para janë si më poshtë:

- Volumi total i tregtuar në Tregun Një Ditë Para prej 1,641,291.86 MWh me një çmim klerues mesatar prej 118.38 €/MWh.
- Rrjedha e energjisë:
 - o Nga Shqipëria drejt Kosovës: 209,779.02 MWh
 - o Nga Kosova drejt Shqipërisë: 141,373.92 MWh.
- Oferta në blerje: 2,811,090.48 MWh.
- Oferta në shitje: 2,719,930.84 MWh.
- Rekordi i tregtimit për një Njësi Kohore të Tregut (MTU) ishte 728.49 MWh më 27 tetorj 2025.
- Rekordi ditor i tregtimit i faturuar për anëtarët e bursës ishte 9,422.84 MWh në 27 nëntor 2025.
- Rekordi mujor i tregtimit ishte 175,121.52 MWh në muajin gusht.
- Rekordi për rrjedhën e energjisë u regjistrua në nëntor me 49,260.91 MWh nga Kosova drejt Shqipërisë.

Figura e mëposhtme paraqet volumet e tregtuara dhe çmimet mesatare të klerimit në baza mujore për Tregun Një Ditë Para për vitin 2025.




Fig. 3.4 Volumet e tregtuara dhe çmimi mesatar i klerimit për tregun një ditë para

Performanca e Tregut të Ankandëve Brenda Ditore (IDM) është paraqitur si më poshtë:

- Volumi total i tregtuar në Tregun Brenda Ditor prej 29,442.24MWh me një çmim klerues mesatar prej 139.17 €/MWh
- Rrjedha e energjisë:
 - Nga Shqipëria drejt Kosovës: 11,396.36MWh.
 - Nga Kosova drejt Shqipërisë: 11,549.37MWh

3.7.2 Procesi i Liberalizimit të Tregut të Energjisë Elektrike

Zyra e Rregullatorit për Energji në seancën e mbajtur me datë 11 prill 2025, me Vendimin V_2698_2025 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizimit me Shërbim Universal për vitin tarifor 2025, ku përmes këtij procesi janë aprovuar edhe të hyrat e operatoreve të rregulluar siç janë: KOSTT SH.A. (Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut), KEDS SH.A.(Operatori i Sistemit të Shprërndarjes) dhe KESCO SH.A. (Furnizuesi i Shërbimit Universal), dhe me Vendimin V_1703_2025 janë reflektuar te tarifat me pakicë për konsumatorët që furnizohen me të drejtën e Furnizimit me Shërbim Universal për vitin 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor, duke vendosur sipas Ligjit për Energjinë Elektrike konsumatorët (ndërmarrjet ekonomike) që i kanë plotësuar kriteret ligjore për dalje në treg të hapur, dhe kostot për këto ndërmarrje ekonomike janë larguar nga faturat e konsumatorëve familjar.

ZRRE përmes Raportit konsultativ ka trajtuar procesin e de-rregullimit të konsumatorëve, ku janë paraqitur obligimet ligjore të ZRRE-së, obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, procesin e de-rregullimit dhe liberalizimit të tregut, si dhe efektin e pritshëm tek konsumatorët.

Për sa i përket obligimeve ligjore në lidhje me tregun e organizuar të energjisë si dhe për liberalizimin e tregut, obligimet janë të definuara në Nenin 5, 7, 26, 37 dhe 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Ndërsa në lidhje me obligimet e Kosovës si palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka pasur obligim të transpozimit të " Acquis Communautaire" për energji në legjislacionin vendor, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë. Ky transpozim përfshin tetë akte ligjore të BE-së, duke përfshirë Direktivën (EU) 2019/944 mbi rregullat e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren (EU) 2019/941 mbi gatishmërinë për rrezikun në sektorin e energjisë elektrike. Një nga obligimet kryesore të Republikës së Kosovës është zbatimi i parimeve të përcaktuara në Direktivën (EU) 2019/944. Neni 27 i kësaj Direktive, parasheh që Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur shtetet anëtare e gjykojnë të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla, të gëzojnë shërbimin universal, përkatësisht të drejtën për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar brenda territorit të tyre në mënyrë konkurruese, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, çmime transparente dhe jo diskriminuese.

ZRRE përmes këtij procesi, ka theksuar se synohet që tregu i energjisë elektrike të bëhet më fleksibil, më i orientuar drejt konsumatorëve dhe më i decentralizuar, duke kontribuar në sigurinë e furnizimit dhe tranzicionin energjetik të qëndrueshëm. Duhet theksuar se Direktiva 2009/72, përkatësisht Neni 3, paragrafi 3, ka theksuar se Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjithë konsumatorët familjarë dhe, kur shtetet anëtare e gjykojnë të përshtatshme, ndërmarrjet e vogla, të gëzojnë shërbimin universal, përkatësisht të drejtën për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar brenda territorit të tyre në mënyrë konkurruese, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, çmime transparente dhe jo diskriminuese. Gjithashtu Direktiva 2009/72 përkufizon se ndërmarrjet e vogla si ndërmarrje që punëson më pak se 50 persona dhe qarkullimi vjetor i së cilës dhe/ose totali i qarkullimit vjetor nuk i kalon 10 milionë euro.

Në kuadër të këtij procesi, është vendosur që konsumatorët jofamiljarë (ndërmarrjet ekonomike), të cilët nuk i plotësojnë kriteret për furnizim me shërbim universal, të dalin në tregun e hapur të energjisë elektrike duke filluar nga 1 qershori 2025, në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe vendimet përkatëse të ZRRE-së. Ky hap ka pasur për qëllim zhvillimin e konkurrencës në treg, rritjen e efikasitetit dhe mundësimin e zgjedhjes së furnizuesit nga ana e konsumatorëve.

Gjithashtu, në vijim të zhvillimeve ligjore dhe gjyqësore, procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike është konfirmuar edhe nga sistemi gjyqësor. Në veçanti, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, përmes Aktgjykimit P.A.nr.18/2025, ka sqaruar interpretimin e dispozitave ligjore lidhur me shërbimin universal, duke theksuar se e drejta për furnizim në kuadër të shërbimit universal u takon vetëm konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve të vogla që i plotësojnë kriteret ligjore në mënyrë kumulative (numri i të punësuarve dhe qarkullimi vjetor). Gjykata ka konstatuar se tregu i energjisë elektrike është ligjërisht i hapur, dhe se zbatimi i mëtejshmë i ligjit primar dhe acquis-it të BE-së nuk kërkon ndërhyrje shtesë normative nga Rregullatori.

Poashtu, edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me Aktvendimin në rastin KI252/25, ka shpallur si të papranueshme kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë, duke mos konstatuar shkelje të të drejtave kushtetuese në lidhje me procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Refuzimi i kërkesës si i papranueshëm konfirmon se pretendimet e ngritura nuk kanë arritur të dëshmojnë cenim të të drejtave kushtetuese dhe, rrjedhimisht, nuk vënë në dyshim ligjshmërinë e veprimeve institucionale në këtë proces. ZRRE konsideron se, zhvillimet rregullatore dhe vendimmarrja gjyqësore në nivel të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese kanë kontribuar në

forcimin e sigurisë juridike, duke konfirmuar drejtimin e reformave për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin vendor dhe obligimet ndërkombëtare.

Vlen të theksohet se në fillim të vitit 2025, ZRRE-ja nisi një fushatë gjithëpërfshirëse informimi të konsumatorëve që synonte konsumatorët jo të kualifikuar. Ky proces kishte për qëllim të informonte konsumatorët e prekur për afatet kohore të zbatueshme, kërkesat rregullatore dhe procedurat për kalim në furnizim në tregun e hapur të energjisë elektrike. Në këtë kontekst, ZRRE-ja organizoi dhe mori pjesë në disa takime dhe punëtori me përfaqësues të konsumatorëve, duke përfshirë Odën Ekonomike, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike Gjermane, Aleancën Kosovare të Biznesit, si dhe dhomat ndërkombëtare të tregtisë që operojnë në Kosovë dhe palë të tjera të interesit në sektorin e energjisë.

Paralelisht, operatorët e sistemit KEDS dhe KESCO identifikuan konsumatorët që nuk janë të kualifikuar për FSHU (konsumatorë të derregulluar) dhe kanë ndërmarrë masat e nevojshme teknike, operacionale dhe komerciale për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre efektive në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Tabela 5 më poshtë paraqet numrin e pikave matëse të konsumatorëve në tregun e lirë që kanë lidhur kontrata furnizimi me furnizues të licencuar të energjisë elektrike.

Tab. 3.10. Furnizuesit e licencuar dhe pikat matëse të konsumatorëve në tregun e lirë

| Furnizues | Numri i pikave matëse |
|-------------------|------------------------------|
| KESCO | 4,641 |
| KEK | 3,955 |
| Voltkos | 539 |
| Enerco | 330 |
| EDS International | 68 |
| Future Dynamics | 2 |
| Totali | 9,535 |

3.8 Aktivitetet e Rregullatorit në fushën e rregullimit të çmimeve

3.8.1 Shqyrtimi tarifor

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) bazuar në kompetencat e dhëna në legjislacionin primar dhe legjislacionin sekondar për sektorin e energjisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për përcaktimin e tarifave për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë. Përmes një procesi të hapur, transparent dhe të bazuar në metodologjitë rregullatore në fuqi, ZRRE përcakton të hyrat e lejuara dhe tarifatat për operatorët e rregulluar. Kjo përgjegjësi, përveç se është e përcaktuar në legjislacionin vendor, rrjedh edhe nga kërkesat e Direktivës 2009/72/EC për rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, ZRRE ka realizuar procesin e përshtatjeve të rregullta vjetore të tarifave në përputhje me Rregullat për të Hyrat në sektorin e energjisë elektrike. Ky proces përfshin shqyrtimin e aplikimeve të operatorëve të rregulluar për përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave për aktivitetet përkatëse, duke u bazuar në analizën e detajuar të kostove të lejuara, investimeve të planifikuara, parametrave të efikasitetit dhe faktorëve të tjerë ekonomikë dhe teknikë.

Shqyrtimi tarifor është një proces kompleks dhe transparent, ku ZRRE merr parasysh faktore të ndryshëm që ndikojnë në çmimet e energjisë, siç janë rritja e kërkesës për energji elektrike, çmimet e energjisë në tregjet ndërkombëtare që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në kostot e blerjes së energjisë elektrike për konsumatorët Kosovarë.

Shqyrtimi i aplikimeve për të hyrat dhe tarifat e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike ndër të tjera ka përfshirë: aktivitetet e blerjes së energjisë me shumicë nga gjeneratorët vendor, çmimet e energjisë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, kostot e importit të energjisë elektrike, aktivitetin e operatorit sistemit, transmisionit dhe operatori i tregut, aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Këta elementë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kostot e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët në Kosovë.

Procesi i shqyrtimit tarifor është zhvilluar përmes një procedure transparente dhe konsultative, duke përfshirë publikimin e dokumenteve relevante dhe konsultimin me palët e interesit. ZRRE me rastin e përcaktimit të të hyrave dhe tarifave për operatorët e rregulluar, ka marrë parasysh dokumentet të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:

- Nga data 24 deri më 31 janar 2025, ZRRE ka pranuar aplikimet për shqyrtimin e të hyrave të lejuara maksimale nga Furnizuesi me Shërbim Universal (KESCO), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), si dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT);
- Raportet Konsultative të ndara për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për Furnizuesin me Shërbim Universal, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, janë publikuar më datën 14 mars 2025;
- Raportet përfundimtare për të hyrat e lejuara maksimale, së bashku me përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit, për Furnizuesin me Shërbim Universal, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, janë publikuar më 11 prill 2025.

Gjatë këtij procesi, ZRRE ka analizuar në mënyrë të detajuar strukturën e kostove të operatorëve të rregulluar, duke vlerësuar kostot operative, kostot e blerjes së energjisë, investimet në rrjet dhe parametrat e efikasitetit. Qëllimi i këtij procesi është të sigurohet që tarifat e energjisë elektrike të reflektojnë kostot reale dhe të arsyeshme të ofrimit të shërbimeve, duke nxitur njëkohësisht efikasitetin operacional dhe investimet në zhvillimin e sektorit energjetik.

Procesi i përcaktimit dhe miratimit të të hyrave dhe tarifave ka rëndësi të veçantë për funksionimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë elektrike. Përmes këtij procesi sigurohet një balancë ndërmjet mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, krijimit të kushteve për investime të nevojshme në infrastrukturën energjetike dhe garantimit të një furnizimi të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike.

Gjatë vitit 2025, tregu i energjisë elektrike në Evropë është përballur me sfida të konsiderueshme, të karakterizuara nga rritja e çmimeve dhe pasiguritë në furnizim. Këto zhvillime kanë ndikuar edhe në

vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Në këtë kontekst, zhvillimet në tregjet ndërkombëtare kanë reflektuar në kostot e furnizimit me energji elektrike dhe në nevojën për menaxhim të kujdesshëm të kostove brenda procesit rregullator.

Në të njëjtën kohë, këto zhvillime kanë theksuar rëndësinë e investimeve në burime të ripërtëritshme të energjisë, rritjen e efikasitetit energjetik dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, me qëllim sigurimin e një furnizimi më të qëndrueshëm dhe konkurrues me energji elektrike në të ardhmen.

Realizimi i parashikimeve për furnizimin me energji elektrike varet në masë të madhe nga performanca e termocentraleve vendase. Në vitet e fundit, ruajtja e një niveli të qëndrueshëm të prodhimit ka qenë sfiduese, kryesisht për shkak të vjetërsisë së njësive gjeneruese dhe nevojës për investime të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe mbajtjen e tyre në operim. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë investime të ndryshme teknike, përfshirë edhe instalimin dhe përmirësimin e filtrave mjedisorë, të cilat kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2025. Megjithatë, për shkak të sfidave operacionale dhe investive, performanca e këtyre kapaciteteve prodhuese mbetet e ndikuar nga faktorë të ndryshëm, të cilët mund të vazhdojnë të ndikojnë në realizimin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike edhe në periudhat e ardhshme.

3.8.2 Blerjet e Energjisë në tregun me shumicë

Çmimet e energjisë elektrike në tregjet e energjisë edhe gjatë vitit 2025 kanë mbetur relativisht të larta. Tabela në vijim paraqet krahasimin ndërmjet vlerave të realizuara dhe atyre të lejuara nga ZRRE për furnizimin me energji elektrike për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU). Nga analiza e të dhënave vërehen devijime si në sasinë e energjisë së furnizuar ashtu edhe në koston totale të blerjes së energjisë elektrike. Energjia e furnizuar nga KEK përbën burimin kryesor të furnizimit për FSHU, ku sasia e realizuar ka arritur në rreth 3,924.7 GWh, krahasuar me 3,876.1 GWh të lejuara, ndërsa çmimi mesatar ka mbetur 29.5 €/MWh. Si rezultat, kostoja e furnizimit nga KEK ka arritur në rreth 115.8 milion euro, duke mbetur afërsisht në linjë me vlerën e lejuar nga ZRRE.

Megjithatë, gjatë periudhës së analizuar prodhimi vendor është ndikuar edhe nga sfidat operacionale të njësive gjeneruese në termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Vjetërsia e këtyre impianteve, funksionimi përtej jetëgjatësisë së projektuar dhe ndërprerjet e paplanifikuara kanë ndikuar në disponueshmërinë e prodhimit vendor. Për më tepër, njësitë kanë qenë të angazhuara në periudha të caktuara në mirëmbajtje dhe investime rehabilituese për të ruajtur funksionimin e tyre afatgjatë. Këta faktorë kanë kufizuar në disa raste prodhimin vendas dhe kanë rritur nevojën për sigurimin e energjisë shtesë nga tregu.

Një nga komponentët kryesorë që ka ndikuar në koston totale të furnizimit është importi i energjisë elektrike. Importi është përdorur kryesisht për të mbuluar kërkesën gjatë periudhave të pikut të konsumit dhe gjatë periudhave kur njësitë prodhuese vendase kanë qenë në mirëmbajtje ose kanë pasur disponueshmëri të kufizuar. Çmimi mesatar i realizuar i importit ka arritur në 146.2 €/MWh, duke reflektuar kushtet e tregut rajonal të energjisë. Si rezultat, kostoja totale e importit ka arritur në rreth 75.2 milion euro, duke përbërë një nga komponentët kryesorë të koston së furnizimit.

Në total, kostoja e realizuar e blerjes së energjisë elektrike për FSHU ka arritur në rreth 234.1 milion euro, ndërsa pas përfshirjes së marzhës me pakicë prej 2.54%, kostoja totale e furnizimit arrin në rreth 240 milion euro, krahasuar me rreth 193 milion euro të lejuara nga ZRRE.

Burimet e energjisë elektrike në tregun me shumicë nga të cilat bëhet mbulimi i kërkesës së energjisë në vend janë: prodhimi i energjisë nga KEK-u, hidrocentralet, centralet solare, turbinat me erë dhe blerjet e energjisë nga importi. Të dhënat energjetike dhe financiare të tregut me shumicë të lejuara për vitin 2025 janë të përmbledhura në tabelën në vijim:

Tab. 3.11 Kostot e lejuara për blerje të energjisë

| Kostot e blerjet së energjisë për FSHU | RealizuarGWh | Realizuar€/MWh | Realizuar€000 | LejuarGWh | Lejuar€/MWh | Lejuar€000 |
|--|----------------|----------------|------------------|----------------|-------------|------------------|
| Sasitë e furnizuara nga KEK | 3,924.7 | 29.5 | 115,779.4 | 3,876.1 | 29.5 | 114,346.4 |
| Gjenerimi në nivel të OST | 418.3 | 68.5 | 28,644.6 | 501.7 | 67.1 | 33,676.8 |
| Gjeneratorë në nivel të OSSh-së | 11.7 | 55.5 | 650.7 | 16.3 | 63.8 | 1,036.7 |
| Importi | 514.5 | 146.2 | 75,234.5 | 243.8 | 161.3 | 39,312.9 |
| Eksporti | -1.5 | 123.9 | -188.8 | -1.3 | 130.3 | -171.0 |
| Taksa për tarifat e ALPEX | | | 34.76 | - | - | 46.3 |
| Kostot e jobalanceve | | | 13,924.3 | | | |
| Total sasitë e furnizuara | 4,867.8 | 48.1 | 234,079.6 | 4,636.6 | 40.6 | 188,248.0 |
| Marzha me pakicë 2.54% | | | 2.54% | | | 2.54% |
| Kostoja e Margjinës së FSHU | | | 5,945.6 | | | 4,781.5 |
| Gjithsej kostot e blerjës së energjisë për FSHU | | | 240,025.2 | | | 193,029.5 |


Siç paraqitet në Figurën në vijim, gjatë vitit 2025 janë evidentuar devijime të rëndësishme ndërmjet parashikimit dhe realizimit të konsumit, importit, prodhimit nga BRE dhe furnizimit nga KEK. Konsumi ka qenë më i lartë se parashikimi, ndërsa prodhimi nga BRE më i ulët, duke rritur nevojën për importe. Po ashtu, furnizimi nga KEK ka pasur luhajtje për shkak të kufizimeve teknike. Edhe pse në total vjetor duket se KEK ka furnizuar më shumë energji, gjatë orëve të pikut prodhimi vendor nuk ka qenë i mjaftueshëm, duke detyruar import në momente me çmime më të larta. Ndërkohë, prodhimi më i lartë ka ndodhur jashtë pikut, kur çmimet janë më të ulëta, duke rritur kështu kostot mesatare të furnizimit.

Si rezultat, rritja e kostos së blerjes së energjisë është ndikuar nga rritja e konsumit (+351 GWh), rritja e importeve (+270 GWh) dhe ulja e prodhimit nga BRE (-88 GWh).

Edhe pse çmimet mesatare të realizuara të importit gjatë vitit 2025 kanë qenë më të ulëta se ato të lejuara, kostot totale të blerjes së energjisë kanë rezultuar më të larta se niveli i lejuar. Kjo për shkak se ndikimin kryesor në koston totale nuk e ka pasur vetëm çmimi për njësi, por edhe sasia dukshëm më e madhe e energjisë së importuar. Mungesa e prodhimit vendor në periudha të caktuara, veçanërisht gjatë orëve të pikut, së bashku me rritjen e konsumit të përgjithshëm, ka rritur nevojën për importe shtesë. Për më tepër, prodhimi më i ulët nga BRE ka kontribuar gjithashtu në zgjerimin e hendekut ndërmjet energjisë së disponueshme nga burimet vendore dhe kërkesës reale. Si rezultat, megjithëse çmimi mesatar i importit ka qenë më i favorshëm krahasuar me atë të lejuar, volumi më i lartë i importit dhe rritja e konsumit kanë bërë që kostot e realizuara të blerjes së energjisë të jenë më të mëdha se kostot e lejuara.

Në përgjithësi, rritja e kostove në vitin 2025 lidhet me rritjen e kërkesës, prodhimi vendor i pamjaftueshëm dhe varësinë më të madhe nga importi, e ndikuar edhe nga ndërprerjet në TC Kosova A dhe Kosova B.

Fig. 3.5 Parashikimi dhe realizimi i blerjeve të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar tarifor për vitin 2025



3.8.3 Të hyrat e lejuara maksimale për konsumatorët e rregulluar tarifor

Kostot e arsyeshme që përdoren për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për konsumatorët e rregulluar me obligim të shërbimit universal përfshijnë disa kategori kryesore të kostove. Këto përfshijnë kostot me pakicë të furnizuesit, kostot e bartshme (kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes), kostot e blerjes së energjisë elektrike, kapitalin punues, borxhin e keq si dhe përshtatjet që lidhen me kostot e realizuara. Të hyrat e furnizuesit me shërbim universal janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë mbulimin e kostove përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë aktivitetet e gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë. Në këtë mënyrë, furnizuesi mbledh nga konsumatorët e rregulluar fundorë kostot e përgjithshme të furnizimit përmes faturave të energjisë elektrike dhe më pas i transferon ato tek operatorët dhe palët përkatëse në përputhje me kostot e shërbimeve të ofruara.

Një element i rëndësishëm i procesit të përshtatjeve është që kostot e pakontrollueshme, kostot e blerjes së energjisë me shumicë dhe kostot e bartshme do të përditësohen rregullisht bazuar në informacionin aktual nga operatorët e rrjetit. Ky informacion është thelbësor për përcaktimin e tarifave të reja dhe për të reflektuar ndonjë ndryshim të mundshëm në shpenzime si rezultat i zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare të energjisë, si dhe ndryshimeve në kostot e operimit të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes.

Në tabelën në vijim kemi një krahasim të hyrave të kërkuara nga FSHU në vlerë 447.99 milion euro, të lejuara nga ZRRE në vlerë 435.92 milion euro, derisa si kosto të realizuara si të raportuara janë në vlerë prej 488.03 milion euro, duke treguar se kostot reale të furnizimit kanë qenë dukshëm më të larta se të hyrat e lejuara nga rregullatori.

Devijimet më të mëdha ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre të realizuara vërehen në komponentin e blerjes së energjisë elektrike me shumicë, ku kostoja e lejuar nga ZRRE për vitin 2025 ishte 193.03 milion euro, ndërsa vlera e realizuar ka arritur në 240.03 milion euro. Ky ndryshim reflekton kryesisht zhvillimet në tregjet e energjisë dhe nevojën për sigurimin e energjisë shtesë nga tregu në periudha të caktuara.

Në përgjithësi, dallimet ndërmjet kostove të realizuara dhe të hyrave të lejuara janë pjesë e procesit të rregullt të përshtatjes tarifore, përmes të cilit ZRRE analizon ndryshimet në strukturën e kostove dhe përcakton tarifën e reja në mënyrë që të sigurohet mbulimi i kostove të arsyeshme të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e shërbimit universal. Detajet e këtyre kostove dhe krahasimi ndërmjet vlerave të kërkuara, të lejuara dhe të realizuara për vitin 2025 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Detajet e këtyre kostove për vitin 2025 janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tab. 3.12 Të hyrat e lejuar maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal

| Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për FSHU | Njësia | ZRRE të Lejuara 2025 | Aplikimi i FSHU-së 2025 | ZRRE Aktuale 2025 |
|---|--------|----------------------|-------------------------|-------------------|
| OPEX-i | €m | 6.71 | 6.745 | 6.22 |
| Zhvlerësimi | €m | 0.13 | 0.361 | 0.134 |
| Kostot e bartshme OST | €m | 33.43 | 34.83 | 30.61 |
| Kostot e bartshme OSSH | €m | 141.2 | 141.73 | 147.25 |
| Kostot e bartshme për fondin e BRE | €m | 13.76 | 13.756 | 14.82 |
| Kapitali Punues | €m | 2.22 | 2.268 | 2.53 |
| Kostot e blerjes së energjisë me shumicë | €m | 193.03 | 196.52 | 240.03 |
| Taksa e lejuar | €m | 0.02 | 0.019 | 0.019 |
| Borxhi i keq | €m | 8.03 | 8.291 | 9.04 |
| <i>Përshtatje të tjera - Kostot e HC</i> | €m | -0.15 | -0.15 | -0.15 |
| Përshtatjet (2023) | €m | 37.38 | 43.65 | 37.53 |
| Të Hyrat e Lejuara Maksimale | €m | 435.92 | 447.989 | 488.03 |

3.8.4 Tarifat e rregulluara për konsumatorët me shërbim universal

Përcaktimi i tarifave në sektorin e energjisë elektrike përbën një proces të rëndësishëm rregullator, pasi tarifën duhet të balancojnë disa objektiva kryesore: sigurimin e përbalueshmërisë për konsumatorët, mbulimin e kostove të arsyeshme të operatorëve të sektorit dhe krijimin e sinjaleve ekonomike që nxisin përdorimin efikas të energjisë elektrike.

Tarifat e rregulluara për vitin relevant tarifor 2025 janë projektuar për të mbuluar kostot e shërbimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët e furnizuar nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU). Konsumatorët që furnizohen me tarifa të rregulluara janë kryesisht konsumatorët e kyçur në nivelet e tensionit 35 kV, 10 kV dhe 0.4 kV, ndërsa konsumatorët e kyçur në nivelet 220 kV dhe 110

kV dhe konsumatorët që nuk plotësojnë kriteret e furnizimit në kushte të shërbimit universal furnizohen në tregun e lirë me çmime të parregulluara.

ZRRE bazuar në legjislacion duhet të përcakton tarifat e rregulluara për konsumatorët që e gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Kriteret se cilët konsumatorë e gëzojnë këtë të drejtë janë të vendosura në Ligjin për Energjinë Elektrike, sipas të cilit: “Të drejtën e furnizimit me shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar, dhe jo familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës”. Megjithatë, për shkak të mungesës së konkurrencës në tregun e energjisë elektrike, çmimeve të larta në tregje shumë konsumatorë biznesor të planifikuar nuk arritën të kalojnë në tregun e deregulluar.

Struktura e tarifave me pakicë për konsumatorët me shërbim universal është dizajnuar në mënyrë që të mbulojë të hyrat e lejuara të FSHU-së, të cilat për vitin përkatës tarifor janë përcaktuar në vlerë prej rreth 435.92 milion euro. Dizajnimi i tarifave synon të arrijë dy objektiva kryesore. Objektivi i parë është reflektimi i kostos reale të furnizimit, i cili është një parakusht për funksionimin e qëndrueshëm të sektorit dhe për mbulimin e kostove të arsyeshme të operatorëve të përfshirë në zinxhirin e furnizimit me energji elektrike. Objektivi i dytë është dërgimi i sinjaleve ekonomike të duhura tek konsumatorët, me qëllim inkurajimin e përdorimit më efikas të energjisë elektrike.

Duke qenë se energjia elektrike ka karakteristika të veçanta fizike dhe ekonomike krahasuar me mallrat e zakonshme, është e rëndësishme që tarifat të japin sinjale që nxisin konsumatorët të menaxhojnë më mirë konsumin e tyre të energjisë. Në mungesë të këtyre sinjaleve ekonomike, konsumatorët nuk do të kishin motivim të mjaftueshëm për të reduktuar konsumin gjatë periudhave të kërkesës së lartë ose për të përdorur energjinë në mënyrë më efikase.

Për këtë arsye, struktura tarifore për konsumatorët e rregulluar përfshin blloqe tarifore, të cilat përfaqësojnë një praktikë të zakonshme ndërkombëtare në rregullimin e sektorit të energjisë. Blloqet tarifore mundësojnë që çmimet e energjisë të reflektojnë më mirë nivelin e konsumit dhe të dërgojnë sinjale ekonomike për menaxhimin e kërkesës për energji elektrike. Kjo qasje ndihmon në promovimin e efikasitetit energjetik dhe në menaxhimin më të mirë të ngarkesës në sistem.

Në kuadër të procesit të përshtatjeve të rregullta tarifore për vitin përkatës, ZRRE ka kryer analizë të detajuar teknike dhe ekonomike të të hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal. Bazuar në këtë analizë dhe në përputhje me Rregullat për të Hyrat në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së ka marrë vendim për rritjen e tarifave prej 16.1% për të gjitha kategoritë e konsumatoreve të rregulluar tarifor.

Struktura e tarifave për konsumatorët e rregulluar është paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tab. 3.13 Struktura e tarifave të rregulluara për konsumatorët fundor për vitin 2025

| Grupi Tarifor | Niveli i tensionit të furnizimit | Elementi Tarifor | Njësia | Koha gjatë ditës | Tarifa |
|---------------|---|------------------------------------|-------------------|------------------|--------|
| 1 | 35 kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 14.54 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 7.61 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.40 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 4.11 |
| | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.87 | |
| 2 | 10 kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 6.00 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW | | 6.56 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 7.44 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 4.80 |
| | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.87 | |
| 3 | 0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 3.34 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW | | 3.87 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 8.70 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 6.46 |
| | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.87 | |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 3.87 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e vetme | 11.47 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Lartë | 13.92 |
| | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Ulët | 6.90 | |
| 5 | 0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.32 |
| | | 0-800kWh (Blloku i parë) | €/kWh | Tarifë e Lartë | 9.05 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 3.88 |
| | | >800kWh (Blloku i dytë) | €/kWh | Tarifë e Lartë | 15.43 |
| €/kWh | Tarifë e Ulët | | 7.28 | | |
| 6 | 0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.32 |
| | | 0-800 (Blloku i parë) | €/kWh | Tarifë e Ulët | 7.12 |
| | | >800 (Blloku i dytë) | €/kWh | Tarifë e vetme | 12.39 |
| 7 | 0.4kV (familjarë pa matës) | Konsumi i vlerësuar: | | | |
| | | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.32 |
| 8 | Ndriçimi Publik | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë mesatare | 9.05 |
| | | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 4.17 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e vetme | 12.01 |

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

Para dizajnit të tarifave duhet përcaktuar edhe kostot e bartshme të FSHU-së, siç janë kostot për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes.

3.8.5 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe tregut

Gjatë vitit 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka kryer procesin e përshtatjeve të rregullta vjetore për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), duke marrë në konsideratë një sërë faktorësh që ndikojnë në përcaktimin e kostove dhe tarifave të shërbimit të transmetimit dhe operimit të sistemit. Ndër faktorët kryesorë të përfshirë në këtë proces janë: faktori i efikasitetit, indeksimi i kostove për normën e inflacionit që aplikohet për shpenzimet operative, riparimet dhe mirëmbajtje, si dhe përshtatjet që lidhen me kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjet. Gjithashtu, janë marrë parasysh kostot e kthimit në kapital dhe zhvlerësimi, të cilat burojnë nga investimet e planifikuara në përputhje me planet investive dhe zhvillimore.

Periodha rregullatore përbën një element thelbësor në përcaktimin e tarifave, pasi ajo siguron stabilitet dhe parashikueshmëri për parametrat kryesorë rregullatorë. Përcaktimi i objektivave të performancës për OST/OT kërkon kohë të mjaftueshme për realizim, duke qenë se këto objektiva lidhen ngushtë me investimet në rrjet, përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit, reduktimin e humbjeve teknike dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Në këtë kontekst, planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë i investimeve mbetet një komponent kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit.

Sa i përket kostove të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të lejuara në rrjetin e transmetimit, vërehet një rritje ndërmjet vlerave të lejuara dhe atyre të realizuara. Për vitin 2025, kostot e lejuara për mbulimin e humbjeve kanë qenë rreth 13.11 milion euro, ndërsa kostot e realizuara kanë arritur në 13.65 milion euro, duke reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Këto kosto janë llogaritur në përputhje me parimet e Rregullave për të Hyrat dhe janë përfshirë si pjesë e përshtatjeve tarifore për vitin relevant 2025.

Çmimi mesatar i energjisë (nga KEK dhe ALPEX) është rritur nga 99.18 €/MWh sa ishte parashikuar nga ZRRE në 106.97 €/MWh, ose rreth 8% e cila do të përshtatet në kostot e vitit 2026.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së për vitin relevant tarifor 2025 për OST/OT.

Të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT do të mblidhen përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE, në përputhje me Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të sistemit të transmetimit, operimit të sistemit dhe operimit të tregut. Këto tarifa janë të strukturuar në mënyrë që të reflektojnë kostot reale të shërbimit dhe të sigurojnë shpërndarje të drejtë të kostove ndërmjet përdoruesve të rrjetit.

Në përgjithësi, zhvillimet në kostot e energjisë dhe në parametrat e tregut kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e të hyrave dhe tarifave për OST/OT, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje rregullatore të kujdesshme dhe fleksibile për të adresuar ndryshimet në sektorin e energjisë elektrike.

Tab. 3.14 Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT

| Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për KOSTT | Njësia | ZRRE të Lejuara 2025 | Aplikimi i KOSTT-it 2025 | ZRRE Aktuale 2025 |
|--|--------|-------------------------|-----------------------------|----------------------|
| OPEX-i | €m | 7.86 | 7.86 | 7.86 |
| Zhvlerësimi | €m | 14.49 | 14.49 | 14.49 |
| <i>Kostot e kthimit (RTNct)</i> | €m | 10.96 | 10.96 | 10.96 |
| Kostot e humbjeve (LSSct) | €m | 13.11 | 14.96 | 13.65 |
| <i>Fondi i BRE-ve - Korigjimet</i> | €m | 17.34 | 17.34 | -5.64 |
| Shërbimet ndihmëse | €m | 37.72 | 49.55 | 39.64 |
| Të hyrat e parregulluara | €m | -8.31 | -8.31 | -15.75 |
| Mekanizmi ITC | €m | -0.40 | -0.40 | 0.89 |
| Përshtatjet për 2022 dhe PRR2 | €m | -5.42 | -5.42 | -5.42 |
| $KREvt = (AACat-1 - ARRt-1) * (1+ It)$ | €m | 0.85 | 0.85 | 0.85 |
| Gjithsej të Hyrat me Fond | €m | 88.20 | 101.88 | 61.53 |
| Gjithsej të Hyrat pa Fond | €m | 70.86 | 84.54 | 67.17 |

Në tabelën në vijim është prezantuar struktura e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, Operimin e Sistemit dhe dhe tregut për vitin relevant tarifor 2025.

Tabela paraqet strukturën e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut, të ndara sipas grupeve të ndryshme të përdoruesve të rrjetit. Tarifat janë të dizajnuara në përputhje me metodologjinë rregullatore dhe synojnë mbulimin e kostove të arsyeshme të operimit të sistemit, duke siguruar një shpërndarje të drejtë të kostove ndërmjet prodhuesve, operatorëve të rrjetit dhe furnizuesve.

Struktura tarifore reflekton dallimet në përdorimin e rrjetit nga kategori të ndryshme, ku prodhuesit, operatorët e shpërndarjes dhe furnizuesit kontribuojnë në mbulimin e kostove në varësi të rolit dhe nivelit të përdorimit të sistemit të transmetimit dhe tregut. Për më tepër, përfshirja e komponentëve të veçantë tariforë mundëson mbulimin e kostove për operimin e tregut dhe mbështetjen e politikave energjetike, përfshirë zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme.

Në përgjithësi, kjo strukturë tarifore kontribuon në funksionimin efikas të sistemit elektroenergjetik dhe në krijimin e sinjaleve të duhura ekonomike për përdorimin racional të rrjetit dhe pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike.

Tab. 3.15 Struktura e tarifave të OST/OT për vitin 2025

| Grupi tarifor | Elementi tarifor | Njësia | Tarifa 2025 |
|---------------------------------|---------------------------------|----------|-------------|
| Prodhimi i kyçur në Transmetim | Tarifa e Operatorit të Sistemit | €/MWh | 5.682 |
| | Tarifa e Operatorit të Tregut | €/MWh | 0.022 |
| Prodhimi i kyçur në Shpërndarje | Tarifa e Operatorit të Sistemit | €/MWh | 0.157 |
| | Tarifa e Operatorit të Tregut | €/MWh | 0.022 |
| Operatori i Shpërndarjes | Tarifa e Operatorit të Sistemit | €/MWh | 4.644 |
| | Tarifa e Operatorit të Tregut | €/MWh | 0.018 |
| Furnizimi | Tarifa e SHST 400/220 kV | €/kW/vit | 2.087 |
| | Tarifa e SHST 110 kV | €/kW/vit | 4.939 |
| | Tarifa e Operatorit të Sistemit | €/MWh | 4.644 |
| | Tarifa e Operatorit të Tregut | €/MWh | 0.018 |
| | Tarifa e Fondit të BRE | €/MWh | 2.924 |

3.8.6 Të hyrat dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes

Pas shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë OSSH-së, ZRRE ka vlerësuar në mënyrë të detajuar kostot e parashikuara dhe ato të realizuara, duke u bazuar në treguesit teknikë, ekonomikë dhe financiar, si dhe dispozitat e Rregullës për të Hyrat e OSSH-së. Ky proces ka përfshirë edhe konsultimin publik me palët e interes, pas të cilit janë përcaktuar të hyrat e lejuara maksimale për vitin tarifor 2025.

Siç paraqitet në tabelë, të hyrat e lejuara nga ZRRE për vitin 2025 arrijnë në rreth 180.65 milion euro, ndërsa të hyrat aktuale janë në nivel prej 193.28 milion euro, duke reflektuar përshtatjet e nevojshme bazuar në kostot reale. Aplikimi i OSSH-së ka qenë më i lartë 214.45 milion euro, megjithatë ZRRE ka

bërë rregullime për të siguruar që vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuar të përfshihen në të hyrat e lejuara.

Devijimet kryesore vërehen në kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve, ku vlera aktuale është dukshëm më e lartë krahasuar me atë të lejuar. Kjo rritje lidhet kryesisht me çmimet më të larta të energjisë në treg dhe me mungesën e prodhimit vendor, që ka detyruar operatorin të mbështetet më shumë në import. Po ashtu, vërehet një rritje në komponentin e pagesave për KOSTT për shërbimet e operimit të sistemit dhe tregut.

Çmimi mesatar i energjisë (nga KEK dhe Importi) është rritur nga 95.39 €/MWh sa ishte parashikuar nga ZRRE në 108.42 €/MWh, ose rreth 13.7% e cila do të përshtatet në kostot e vitit 2026. Rritja e çmimit është pasojë e faktorëve të ndryshëm si rritja e kërkesës për energji, mungesa e prodhimit vendor, dhe zëvendësimi i saj me energji të importuar dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare të energjisë.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat e lejuara maksimale dhe ato të realizuar për vitin relevant tarifor 2025 për OSSH-së.

Tab. 3.16 Të hyrat e lejuara maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2025

| Komponenti | Njësia | Lejuar ZRRE 2025 | Aplikimi OSSH 2025 | Aktuale ZRRE 2025 |
|--|--------|------------------------|--------------------------|-------------------------|
| OPEX | € mil | 29.25 | 40.82 | 29.25 |
| <i>Zhvlerësimi</i> | € mil | 22.63 | 22.63 | 22.63 |
| Kthimi i Lejuar | € mil | 18.62 | 18.62 | 18.62 |
| <i>Blerja e Energjisë për Humbjet</i> | € mil | 86.04 | 97.93 | 99.72 |
| Pagesat për KOSTT për OS dhe OT | € mil | 3.28 | 3.59 | 3.70 |
| Taksat e Licencimit | € mil | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Të Hyrat e Parregulluara | € mil | -5.41 | -2.74 | -6.89 |
| Përshtatjet e mëparshme (2022 dhe PRR) | € mil | 0.09 | 0.09 | 0.09 |
| KREV 2024 | € mil | 26.16 | 33.41 | 26.16 |
| Totali | € mil | 180.65 | 214.45 | 193.28 |

KEDS në aplikimin e tyre ka kërkuar investime kapitale për katër komunitat e veriut të Republikës së Kosovës. ZRRE ka lejuar këto kosto kapitale në vlerë prej 2.3 milionë euro që ndërlidhen me ofrimin shërbimeve të parapara si në rrjet, nënstatione, transformatorë, paisje dhe instrumente matëse, kamionë, kranë etj.

Pas përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, ZRRE ka përcaktuar tarifatat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes në mënyrë që të sigurohet mbledhja e këtyre të hyrave në përputhje me Metodologjinë përkatëse rregullatore. Tarifatat janë të strukturuar sipas nivelit të tensionit, duke reflektuar kostot reale të shërbimit dhe karakteristikat teknike të rrjetit.

Siç paraqitet në tabelë, tarifatat ndryshojnë në varësi të nivelit të tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët. Konsumatorët e lidhur në nivelin 35 kV përballen me tarifa më të ulëta, pasi ky nivel karakterizohet me humbje më të vogla teknike dhe efikasitet më të lartë të rrjetit. Në nivelin 10 kV tarifatat janë më të larta për shkak të rritjes së kostove të shpërndarjes, ndërsa konsumatorët në tension të ulët 0.4 kV përballen me tarifatat më të larta, si rezultat i humbjeve më të mëdha dhe kostove më të larta operative dhe investive në këtë nivel të rrjetit.

Kjo strukturë tarifore siguron një shpërndarje të drejtë dhe proporcionale të kostove ndërmjet kategorive të konsumatorëve, duke reflektuar nivelin e përdorimit të rrjetit dhe kostot përkatëse të shërbimit. Në të njëjtën kohë, ajo krijon sinjale ekonomike për përdorim më efikas të energjisë elektrike dhe nxit konsumatorët që të menaxhojnë më mirë kërkesën e tyre për energji.

Tab. 3.17 *Struktura e tarifave për OSSH për vitin 2025*

| Tarifat e konsumatorëve të kyçur në OSSH | | |
|--|--------|--------|
| Niveli i tensionit | Njësia | Tarifa |
| 35 kV | €/kWh | 1.74 |
| 10 kV | €/kWh | 2.33 |
| 0.4 kV | €/kWh | 3.46 |

3.8.7 Çmimet mesatare të energjisë elektrike pa taksa

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur çmimet mesatare për konsumatorët familjar dhe jo-familjar të realizuara për periudhën 2015 - 2025.

Nga analiza vërehet një trend rritës i çmimeve, veçanërisht pas vitit 2021, si rezultat i zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare të energjisë. Për vitin 2025, çmimi mesatar për konsumatorët familjar arrin në rreth 8.17 €cent/kWh, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2024 (7.39 €cent/kWh). Ndërsa për konsumatorët jo-familjar, çmimi mesatar është rreth 10.46 €cent/kWh, me një rritje krahasuar me vitin paraprak.

Rritja e çmimeve mesatare në vitin 2025 lidhet kryesisht me rritjen e kostove të furnizimit, përfshirë çmimet e importit dhe kostot e balancimit të sistemit, si dhe me strukturën e konsumit më të lartë të shpenzimit të energjisë.




Fig. 3.6 *Çmimet mesatare për konsumatorët familjar dhe jo-familjarë për periudhën 2015- 2025 (pa TVSH)*


Në figurën e dhënë, janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë (për konsumatorë me brezin e konsumit 1000 kWh – 2499 kWh) për vitin 6 mujorin parë të vitit 2025, për shtete të ndryshme, duke përfshirë edhe Kosovën të nxjerra nga EUROSTAT. Nga të dhënat rezultojnë

se Kosova vazhdon të mbetet ndër vendet me çmimin më të ulët të energjisë elektrike në Evropë. Krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian, si Gjermania, Irlanda dhe Danimarka, të cilat paraqesin nivelet më të larta të çmimeve, Kosova ka një avantazh të dukshëm në aspektin e përballueshmërisë së energjisë për konsumatorët familjar.

Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova gjithashtu paraqet çmime më të ulëta ose të krahasueshme, duke reflektuar ndikimin e gjenerimit vendor dhe strukturën e rregulluar të tarifave.

Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë në Kosovë për vitin 2025 është 0.071 €cent për kilovat-orë, që është një nga çmimet më të ulëta në Evropë dhe rajon. Çmimet më të larta të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë kanë Irlanda (0.427 €cent/kWh), Holanda (0.405 €cent /kWh), dhe Luksemburgu (0.327 €cent /kWh).

Në krahasim me shtetet e tjera të rajonit, Kosova gjithashtu ka një çmim më të ulët se shtetet si Maqedonia e Veriut (0.109 €cent/kWh), Shqipëria (0.096 €cent/kWh), Mali i Zi (0.095 €cent/kWh), Serbia (0.092 €cent/kWh).



*Burimi i të dhënave nga EUROSTAT


Fig. 3.7 Çmimet mesatare për konsumatorët familjar për vitin 2025 (pa TVSH)

Në figurën e dhënë, shihen çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljar (për konsumatorë me brezin e konsumit 500MWh – 2000MWh) për 6 mujorin e parë të vitit 2025 në shtete të ndryshme bazuar në të dhënat e Eurostat (për shtetin e Kosovës të dhënat janë marr nga KESCO ngase ato nuk kanë qenë të publikuara). Çmimi për kilovat-orë pa taksa është ndarë për disa shtete të Evropës dhe rajonin, ku Kosova ka vlerën më të ultën për vitin 2025 krahasuar me shtete tjera.

Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë në Kosovë për vitin 2025 është 0.080 €cent/kWh, që është një çmim relativisht më i ulët krahasuar me shumë shtete evropiane, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian dhe disa shtete të tjera në rajon.

Kosova ka një çmim të energjisë elektrike shumë më të ulët se shumë shtete evropiane si Irlanda (0.263 €cent/kWh), Kroacia (0.216 €cent/kWh), dhe Lihtenshtanji (0.197 €cent /kWh).

Në rajon, Kosova ka një çmim të energjisë elektrike më të ulët sesa shtetet si: Shqipëria (0.142 €cent/kWh), Maqedonia e Veriut (0.126 €cent/kWh), Serbia (0.124 €cent /kWh) dhe Mali i Zi (0.081 €cent/kWh).



*Burimi i të dhënave nga EUROSTAT

Fig. 3.8 Çmimet mesatre për konsumatorë jofamiljar të mesëm dhe mëdhenj për vitin 2025 (pa TVSH)

Në përgjithësi, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë një pozicion relativisht të favorshëm për sa i përket çmimeve të energjisë për konsumatorët jo-familjar, duke kontribuar në konkurrueshmërinë e sektorit ekonomik.

3.8.8 Tarifat e energjisë termike

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave.

Skematikisht, Metodologjia tarifore tregohet si më poshtë:




Fig. 3.9

Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Nga paraqitja skematike vërehet se kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësoj asetet e veta, koston e humbjeve të rrjetit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Procesi i përcaktimit të tarifave dhe aprovimit të tyre për sezonin 2025/2026 është bërë në dy hapa:

1. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale, bazuar në: i) informatat dhe të dhënat e parashikuara në aplikacionin për tarifa; ii) informatat e paraqitura gjatë raportimit rregullativ të realizimeve në sezonin e kaluar 2024/2025; dhe iii) bashkërendimi mes realizimeve aktuale dhe atyre të projektuara, që është bazuar në dallimin midis të hyrave të planifikuara dhe atyre aktuale të sezonit të kaluar të ngrohjes.
2. Llogaritja e tarifave bazuar në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe në strukturën tarifore.

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të ndërmarrjeve të energjisë termike (ngrohjes qendrore) për sezonin 2024/2025, në pajtim Rregullën për Vendorsjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZrRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i aseteve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitali punues; dhe
 - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostonë së lejuar për humbjet në rrjet.

ZRRE-ja ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ndërmarrjet. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësimi i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) sa më i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2025/2026.

Në kuadër të shqyrtimit tarifor për ndërmarrjet e energjisë termike: NQ Termokos dhe NQ Gjakova, ZRRE ka hartuar Raportet Rregullative për përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara dhe për përcaktimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2025/2026.

Pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse të shqyrtimit tarifor, në seancën e mbajtur me 30 dhjetor 2025, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për NQ Termokos për sezonin 2025/2026, në vlerë prej 11,463,803€. Po ashtu në të njëjtën seancë janë miratuar tarifat e reflektuara nga HLM të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2025/2026.

Vendimet e nxjerra:

- V_3013_2025 -për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) për NQ Termokos që do të mblidhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2025/2026;
- V_3014_2025 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2025/2026;

Gjithashtu për NQ Gjakovën, pas shqyrtimit të raporteve dhe dokumenteve përkatëse, në seancën e Bordit të ZRRE-së të datës 30 dhjetor 2025 janë aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM_ në vlerë 964,160€. Po ashtu në të njëjtën seancë janë miratuar tarifat e NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2025/2026.

Vendimet e nxjerra:

- V_3015_2025 -për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) për NQ Gjakova që do të mblidhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2025/2026;
- V_3016_2025 -për aprovimin e tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2025/2026;

Struktura dhe nivelet e tarifave të Energjisë termike për NQ Termokos dhe NQ Gjakova është paraqitur si më poshtë. Lidhur me këtë duhet theksuar se tarifat me matje të NQ Termokos janë zvogëluar për rreth 4%, ndërsa ato sipas sipërfaqes ngrohëse kanë mbetur të njëjta sikur në sezonin e kaluar. Ndërsa tarifat NQ Gjakova janë zvogëluar mesatarisht për 4.5% Struktura dhe nivelet e tarifave të Energjisë termike për NQ Termokos dhe NQ Gjakova është paraqitur si më poshtë.

Tab. 3.18 Struktura e tarifave të energjisë termike për vitin 2025/2026

| Tarifat e energjisë termike - Sezoni 2025/2026 | | | | | |
|--|-----------------------------|----------------------|------------------------|----------------------|------------------------|
| Komponentët e tarifës me matje | Njësia | NQ Termokos | | NQ Gjakova | |
| Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse) | [€/kW/muaj] | 0.73 | | 0.86 | |
| Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile) | [€/MWh] | 33.65 | | 51.18 | |
| Komponentët e tarifës pa matje | Njësia | Konsumatorë shtëpiak | Konsumatorë Kom.&Inst. | Konsumatorë shtëpiak | Konsumatorë Kom.&Inst. |
| Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse) | [€/m ² për muaj] | 0.11 | 0.14 | 0.12 | 0.17 |
| Tarifa për Furnizim/Konsum të En. Term. (komponenta variabile) | [€/m ² për muaj] | 0.65 | 0.81 | 0.73 | 1.02 |
| Gjithsej tarifa për konsumatorët pa matje | [€/m ² për muaj] | 0.76 | 0.95 | 0.85 | 1.19 |

3.9 Aktiviteti i Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori është përgjegjës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Përveç kompetencave tjera të dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Sipas dispozitave të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë që të parashtrorjnë ankesa që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga furnizuesi ose operatori i sistemit dhe këto ankesa fillimisht duhet t'i drejtohen furnizuesit ose operatorit të sistemit, si organ i shkallës së parë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe nxjerr përgjigje brenda afatit ligjor. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga te licencuarit, nëse nuk është i kënaqur, mund t'i drejtohet Rregullatorit për shqyrtim të mëtejshëm të ankesës së tij.

Rregullatori gjatë vitit 2025 i ka regjistruar 418 ankesa zyrtare të konsumatorëve dhe aplikuesve për kycje të reja të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të kundërshtuar përgjigjet e lëshuara nga ana e Furnizuesit të energjisë elektrike me shërbim universal, Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike dhe energjisë termike si dhe furnizuesve me energji termike. Ndërkaq, i ka kthyer në rishqyrtim 125 ankesa tek Furnizuesit dhe Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes, si dhe 42 kërkesa/ankesa të konsumatorëve lidhur me shqyrtimin e saktësisë së matjes i ka proceduar tek OSSh, të cilat edhe janë shqyrtuar në tërësi. Vlen të theksohet se në kuadër të numrit të përgjithshëm të ankesave të parashtruar nga konsumatorët, 110 ankesa kanë pasur të bëjnë me konsumatorët të cilët i kanë plotësuar kriteret ligjore për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, Rregullatori përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacioneve, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postë elektronike, si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Numri i ankesave të pranuar sipas kategorive të konsumatorëve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab. 3.19 Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive, 2025

| Ankesat e konsumatorëve sipas kategorive | Numri | Përqindja [%] |
|--|-------|---------------|
| Konsumator shtëpiak | 280 | 66.99 |
| Konsumator komercial | 138 | 33.01 |
| Gjithsej | 418 | 100.00 |

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve të parashtruara në ZRrE sipas natyrës së tyre.




Fig. 3.10 Numri i ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Më poshtë është paraqitur sqarimi i natyrave të ankesave të konsumatorëve të regjistruara për vitin 2025:

- **Kontestimi i faturave të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për rastet e gabimeve në lexim dhe leximeve jo të rregullta, e që me këtë rast konsiderohet se kanë dhënë një pasqyrim jo të saktë të gjendjes reale të shpenzimit të energjisë elektrike.
- **Kontestimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve, të cilët ndërmarrja e energjisë i ka ngarkuar me fatura për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve). ZRrE në bazë të Ligjit për Energjinë elektrike dhe dispozitave ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, për këto raste të ankesave është jokompetente, dhe i ka udhëzuar konsumatorët që t'u adresohen organeve kompetente për veprime të mëtejme.
- **Kontestimi i lidhjeve/kyçjeve të reja**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilëve ju është mohuar e drejta për lidhje të re nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Në këto raste

- të ankesave, konsumatorët për të realizuar lidhjen e re janë detyruar nga ndërmarrja që së pari të kryejnë pagesat e borxheve në shifrën e vjetër e cila ka ekzistuar më herët.
- **Kontestimi i ngarkesave shtesë**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve lidhur me faturimet shtesë nga faturimi i rregullt. Këto ankesa janë si rezultat i mos regjistrimit të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike, si rrjedhojë e defektit të ndonjë sistemi matës.
 - **Kontestimi i borxhit të energjisë elektrike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me problemet rreth mos definimit të saktë të borxhit të energjisë elektrike të pa inkasuar nga ana e furnizuesit në rastet e shitblerjes së pronës, dhe për pronat që kanë qenë të uzurpuara.
 - **Kontestim i grupit tarifor**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve për ndërrim të grupit tarifor, e ku konsumatorët kërkojnë që për arsye të ndryshme të ndërrojnë grupin tarifor.
 - **Kontestimi i Pëlqimeve Elektroenergjetike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve apo edhe të aplikuesve për lidhje të re e të cilët kanë të bëjnë me zgjidhjet teknike të ofruara nga operatori i sistemit.
 - **Kontestimi i faturave të energjisë termike**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilët kanë kontestuar faturat e energjisë termike, sipërfaqen ngrohëse, cilësinë e ngrohjes, borxhet e mëhershme, çështjet e parashkrimit të borxheve.
 - **Ankesat kundër Liberalizimit të Tregut**, ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve të cilët e kanë kundërshtuar procesin e ligjshmërisë së hapjes së tregut, si dhe i kanë kontestuar kriteret ligjore për të kaluar në tregun e hapur.

Gjatë vitit 2025, Rregullatori ka zgjidhur 369 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi i energjisë elektrike me shërbim universal, Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike dhe energjisë termike si dhe furnizuesve me energji termike, të cilat kryesisht kanë pasur të bëjnë me lidhje të reja, pëlqime elektroenergjetike, inspektime të njehsorit, ndërrim të njehsorit, pasivizim, ndërrim i emrit të llogarisë, korrigjime financiare, zbatim i vendimeve gjyqësore si dhe kërkesat e tjera të konsumatorëve. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të zgjidhura, 224 prej tyre janë vendosur në favor të konsumatorëve apo shprehur në përqindje 60.7%, ndërsa 142 ankesa të konsumatorëve apo 38.48% janë refuzuar si të pabaza si dhe 3 ankesa apo 0.81% të ankesave të zgjidhura kanë qenë jashtë kompetencave të ZRrE. Të gjitha ankesat e shqyrtuara nga ana e operatorëve, e të cilat janë proceduar tek Rregullatori, janë rishqyrtuar edhe njëherë nga Rregullatori me qëllim të zgjidhjes së plotë të ankesave sipas kërkesave të konsumatorëve, si dhe janë njoftuar konsumatorët. Në të gjitha rastet e rishqyrtuara konsumatorët janë pajtuar me zgjidhjet e ofruara.

Duke filluar nga data 1 qershor 2025, konsumatorët të cilët i kanë plotësuar kriteret ligjore sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe Direktivën e Bashkimit Evropian, kanë kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike. Përgjatë këtij procesi, ZRrE ka pranuar disa ankesa të konsumatorëve, të cilët e kanë kundërshtuar kalimin në tregun e hapur, me arsyetimet përkatëse si në ankesat e parashtruara. Fillimisht, duke qenë se janë në pyetje kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike si dhe Direktivën e BE-së, dhe duke qenë se, Vendimi i Bordit të ZRrE-së V_2703_2025 datë 16.04.2025 për tarifën me pakicë, ka përcaktuar konsumatorët të cilët e gëzojnë të drejtën e furnizimit me shërbim universal, si vendim përfundimtar në procedurë administrative,

ZRrE i kishte njoftuar konsumatorët që, në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, vendimet përfundimtare në procedurë administrative, nuk mund të atakohen përmes ankesave, tek institucioni i njëjtë i cili e ka nxjerrë atë vendim, dhe çdo kundërshtim tjetër lidhur me këtë proces, mund të parashtrohet në gjykatat kompetente, përmes inicimit të konfliktit administrativ, me padi. Përgjatë vitit 2025, ZRrE i ka pranuar gjithsej 110 ankesa të subjekteve juridike dhe sipas një Aktgjykimi të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, ka filluar me shqyrtimin e tyre dhe lëshimin e vendimeve gjegjëse, duke vepruar sipas obligimit ligjor për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përkundër qëndrimit fillestar të ZRrE-së që ky proces mund të kundërshtohet vetëm pranë gjykatave kompetente.




Fig. 3.11 Ankesat e zgjidhura, 2025

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve, të regjistruara dhe zgjidhura nga Rregullatori sipas viteve.




Fig. 3.12 Ankesat e konsumatorëve të regjistruara dhe zgjidhura 2011-2025

3.9.1 Vendimet e Bordit të Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) si vendim i shkallës së parë, në Bordin e Rregullatorit të ZRrE-së si shkallë e dytë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

Gjatë vitit 2025 Bordi i Rregullatorit ka nxjerrë shtatëdhjetë (70) vendime që ndërlidhen me ankesat e konsumatorëve dhe Kundërshtimet e të licencuarve, të parashtuara ndaj vendimeve të DMK-së, si dhe disa raste të tjera që ndërlidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore, për ankesat e konsumatorëve.

Konsumatorët kanë parashtuar 41 Ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK. Nga 41 ankesat e parashtuara, Bordi i Rregullatorit ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa, si dhe të gjitha provat e tjera relevante, dhe pas shqyrtimit, të gjitha ankesat janë refuzuar si të pabazuara dhe në fuqi kanë mbetur vendimet e DMK-së, përveç një rasti që është kthyer në rishqyrtim dhe vendimmarrje tek Furnizuesi i energjisë termike.

Më tej, janë shqyrtuar edhe 15 Kundërshtime (ankesa) të Furnizuesve, të parashtuara ndaj vendimeve të DMK-së. Bordi i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes këto kundërshtime dhe dokumentacionin tjetër relevant dhe të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara dhe në fuqi kanë mbetur Vendimet e DMK-së.

Në bazë të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, për kategoritë e konsumatorëve të Grupit Tarifor 1, 2 dhe 3, DMK ka nxjerrë katërmëdhjetë (14) Rekomandime për Bordin e ZRrE-së, lidhur me ankesat e parashtuara nga konsumatorët jo familjar (komercial) dhe industrialë, ashtu që, pas shqyrtimit dhe analizimit të rekomandimeve dhe dokumentacionit tjetër relevant, Bordi i ZRrE-së i ka aprovuar të gjitha rekomandimet e nxjerra nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

3.9.2 Aktivitetet tjera në mbrojtjen e konsumatorëve

ZRrE gjatë këtij viti raportues, përveç ankesave të regjistruara, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, i ka zhvilluar edhe mbi 800 takime me konsumatorë, dhe biseda telefonike me palët, përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme kontraktuale mes konsumatorëve dhe të licencuarve. Është e rëndësishme të theksohet se, përgjatë takimeve të drejtpërdrejta me konsumatorë, komunikimeve elektronike dhe bisedave telefonike, të gjitha çështjet e ngritura nga konsumatorët, adresohen tek të licencuarit, nëse paraprakisht kërkohet shqyrtim dhe vlerësim nga të licencuarit dhe konsumatorët njoftohen për veprimet e ndërmarra si dhe, konsumatorët njoftohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre në raport me Furnizuesit ose Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

Gjatë vitit 2025 Rregullatori ka pranuar edhe disa ankesa dhe kërkesa të konsumatorëve përmes postës, të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'iu drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'iu drejtohen Rregullatorit për zgjidhjen e ankesave të tyre. Vlen të theksohet se natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, kompensim dëmi apo edhe kërkesa të cilat nuk janë në domenin e shqyrtimit të

rregullatorit. Rregullatori në të gjitha këto raste i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve, duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre.

Ashtu edhe si viteve të mëhershme, por edhe gjatë vitit 2025 Rregullatori ka pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ku gjatë këtij viti raportues ka pranuar edhe disa ankesa të konsumatorëve nga ky institucion. Këto ankesa janë pranuar dhe shqyrtuar nga ana e Rregullatorit në përputhje me dispozitat ligjore..

3.9.3 Aktivitetet e DMK-së lidhur me vendimet e kontestuara pranë gjykatave kompetente

Duke iu referuar nenit 25 – Seancat e Bordit, Kapitulli VI – Procedurat Administrative, të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, si vijon: “Vendimet e Bordit do të jenë të zbatueshme menjëherë dhe nuk mund t'i nënshtrohen kurrfarë rishqyrtimit, përveç shqyrtimit gjyqësor”, konsumatorët dhe të licencuarit, duke e shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore për apelim të këtyre vendimeve, kanë iniciuar procedura të konfliktit administrativ dhe procedura të tjera gjyqësore, ndaj vendimeve përfundimtare të ZRrE-së në procedurë administrative.

Kësisoj, gjatë vitit 2025, një numër i caktuar i vendimeve të Bordit të ZRrE-së, janë kontestuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, si dhe në Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, si dhe pranë gjykatave të tjera themelore në nivel vendi, me kërkesat për të vlerësuar ligjshmërinë e këtyre vendimeve, si dhe kërkesa të tjera specifike, që ndërlidhen me rastet e caktuara. Kështu, përgjatë këtij viti, ZRrE ka pranuar pesëmbëdhjetë (15) Aktvendime për Përgjigje në Padi, nga gjykatat kompetente dhe brenda afateve ligjore, ZRrE ka vepruar konform obligimeve të saj ligjore, ashtu që, janë parashtruar Përgjigjet në Padi, si dhe është bashkëngjitur dokumentacioni relevant lidhur me rastet përkatëse. Përgjatë këtij viti raportues, ZRrE ka marrë pjesë në gjashtëmbëdhjetë (16) seanca gjyqësore, në konfliktet administrative të iniciuara nga konsumatorët dhe të licencuarit, pranë gjykatave kompetente në nivel vendi.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, ZRrE i ka pranuar edhe katër (4) Aktgjykime nga Gjykata Supreme e Kosovës, përmes të cilave, janë refuzuar si të pabazuara kërkesat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve gjyqësore, sipas konflikteve administrative të iniciuara nga palët paditëse, kundër Vendimeve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur me shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, dhe vendimet e Bordit janë konfirmuar si vendime të drejta dhe ligjshme.

Vlen të theksohet se, pjesa më e madhe e vendimeve përfundimtare administrative të ZRrE-së gjatë vitit 2025, janë vërtetuar si vendime të ligjshme dhe të drejta nga gjykatat kompetente, në konfliktet administrative të iniciuara nga paditë e paditësve, si konsumatorët ose të licencuarit. Ndërkaq, për pjesën tjetër të vendimeve që janë kthyer në rishqyrtim, ZRrE do të vazhdojë të shfrytëzojë të gjitha mjetet ligjore, duke i apeluar të njëjtat, ashtu që të vërtetohet ligjshmëria e tyre.

Po ashtu, duhet theksuar se, pranë gjykatave kompetente, nga konsumatorët janë parashtruar një numër i konsiderueshëm i padive, me objekt të kontestit për kompensim dëmi ose pasurim të pabazë. Ndërlidhur me këto padi, përgjatë vitit 2025, ZRrE i ka pranuar 135 Aktvendime nga gjykatat, përmes të cilave proceset gjyqësore lidhur me këto raste janë ndërprerë, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes paraprake.

Sa i përket liberalizimit të tregut të energjisë, krahas parashtrimit të ankesave, një numër tjetër i subjekteve juridike, kanë parashtruar Padi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative dhe në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë përmes të cilave e kanë kundërshtuar procesin e liberalizimit të tregut. Përgjatë këtij viti raportues, ZRrE i ka pranuar nga gjykatat kompetente 178 Aktvendime për Përgjigje në padi, dhe brenda afateve ligjore, ZRrE i ka parashtruar Përgjigjet në Padi dhe e ka bashkëngjitur dokumentacionin relevant lidhur me këto raste. Është e rëndësishme të theksohet se, të gjitha paditë e parashtruara, kanë kërkuar edhe masë të sigurisë ose masë të përkohshme, për pezullim të zbatimit të vendimit të ZRrE-së ose pezullim të kalimit të subjekteve juridike në tregun e hapur të energjisë për subjekte të caktuara. Për një numër të madh rastesh, ZRrE tashmë i ka pranuar edhe vendimet e Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, përmes të cilave janë refuzuar si të pabazuara kërkesat për masa të sigurisë, ashtu që, subjektet juridike, përkundër kundërshtimeve të paraqitura, kanë kaluar në tregun e energjisë elektrike, sipas kërkesave ligjore që burojnë nga legjislacioni primar.

Si përfundim, edhe për këtë vit raportues, inicimi i konflikteve administrative nga palët e autorizuara, ka kërkuar angazhim dhe përkushtim të madh. Gjithsesi, ZRrE do të vazhdoj të bëj përpjekje maksimale që vendimet përfundimtare në procedurë administrative të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, dhe të licencuarve po ashtu, duke shqyrtuar drejtë dhe me saktësi të gjitha ankesat e konsumatorëve dhe të licencuarve.

4 BASHKËPUNIMI ME PALËT TJERA DHE TRANSPARENCA

ZRRE ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me parimet e transparencës institucionale, duke siguruar transparencë të plotë në raport me publikun përmes mbajtjes së seancave të hapura të Bordit dhe publikimit të të gjitha vendimeve të miratuara. Në funksion të informimit të drejtë dhe me kohë, institucioni ka përdorur komunikata për media, njoftime zyrtare dhe publikime të vazhdueshme në faqen elektronike si dhe në rrjetet sociale, përmes të cilave publiku është njoftuar për aktivitetet dhe zhvillimet kryesore të ZRRE-së.

Në vazhdimësi të angazhimeve për forcimin e transparencës dhe informimit publik, gjatë vitit 2025 janë shpërndarë gjithsej 114 komunikata dhe njoftime për media dhe publikun, të cilat janë publikuar në faqen elektronike zyrtare si dhe në profilin zyrtar në Facebook. Këto publikime kanë pasqyruar zhvillime të ndryshme që ndërlidhen me veprimtarinë e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë mbajtjen e seancave të Bordit, njoftimet për publikimin e dokumenteve për konsultim publik, proceset e licencimit, përfaqësimin institucional të ZRRE-së para akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe zhvillime të tjera me rëndësi për funksionimin dhe rregullimin e sektorit të energjisë.

4.1 Përfshirja e Publikut në proceset rregullative përmes Konsultimeve Publike

Për shqyrtimin e dokumenteve të ndryshme rregullative dhe me qëllim të funksionimit të duhur të sektorit të energjisë, ZRRE gjatë vitit 2025 ka zhvilluar konsultimet publike dhe ka publikuar dokumentet si në vijim:

- Më 07 shkurt 2025, ZRRE ka publikuar draft raportet konsultative që kanë të bëjnë me përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST – KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH – KEDS) dhe Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU – KESCO).
- Më 12 mars 2025, ZRRE publikoi njoftimin për vazhdimin e procesit të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, duke përcaktuar KESCO-n si furnizues me të drejtën e shërbimit universal dhe duke mundësuar kalimin e konsumatorëve që plotësojnë kriteret ligjore në treg të lirë.
- Më 11.04.2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka shqyrtuar dhe miratuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e licencuar. Në kuadër të këtij vendimi, të hyrat për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) janë aprovuar në vlerë prej 88.198 mil€, për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) në vlerë prej 180.653 mil€, ndërsa për Furnizuesin me Shërbim Universal (KESCO) në vlerë prej 435.626 mil€, ku përfshihen edhe kostot që ndërlidhen me operatorët e licencuar OSSH dhe OST/OT.
- Më 11 prill 2025, ZRRE publikoi Raportin Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2025, së bashku me Përgjigjet Zyrtare ndaj Komenteve të Pranuarat gjatë periudhës së konsultimit publik.
- Më 16.04.2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka miratuar tarifën për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit dhe tregut (OST/OT), rrjetit të shpërndarjes (OSSH), si dhe tarifën për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Tarifën e aprovuar për konsumatorët e rregulluar

- tarifor reflektojnë një rritje lineare prej 16.1% për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në kuadër të shërbimit universal dhe kanë hyrë në fuqi më 1 maj 2025.
- Më 18 prill 2025, ZRRE shpalli tenderin për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, duke siguruar furnizim të garantuar me energji elektrike për konsumatorët që nuk kanë kontratë aktive ose në rast të falimentimit të furnizuesit përkatës.
 - Më 01.06.2025, ZRRE ka njoftuar opinionin publik se ka filluar me sukses vazhdimi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, duke ofruar mundësi për konsumatorët të zgjedhin furnizuesin e tyre, si dhe ka publikuar listën e furnizuesve të licencuar dhe udhëzime për përzgjedhjen e tyre.
 - Më 09.07.2025, ZRRE ka njoftuar se Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar kërkesat për vendosjen e masës së sigurisë ndaj Njoftimit Publik për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike. Gjykata konstatoi se ZRRE ka vepruar në përputhje me ligjin dhe se procesi i liberalizimit promovon konkurrencë, çmime më të ulëta dhe shërbim më cilësor për konsumatorët. Poashtu, më 13 gusht 2025, ZRRE ka njoftuar se Gjykata Komeriale - Dhoma Shkalla e Dytë ka aprovuar ankesën e ZRRE-së dhe ka refuzuar padinë për shtyrjen e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke konfirmuar ligjshmërinë e procesit.
 - Më 18 gusht 2025, ZRRE ka publikuar për konsultim publik Koncept Dokumentin mbi Rregullën mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, duke ftuar palët e interesuara të paraqesin komentet e tyre me shkrim.
 - Më 18 gusht 2025, ZRRE ka vendosur në konsultim publik dokumentin “Rregulla për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme”, duke ftuar të gjitha palët e interesuara të paraqesin komentet e tyre me shkrim. Poashtu, më 15 shtator 2025, ZRRE në bashkëpunim me BERZH, ZRRE mbajti dëgjimin publik për këtë dokument, duke prezantuar gjetjet dhe komentet e grumbulluara gjatë konsultimit publik.
 - Më 7 nëntor 2025, ZRRE kishte ri-shpallur tenderin për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, por asnjë furnizues i licencuar nuk iu përgjigj ftesës për shprehje të interesit. Për shkak të mosplotësimit të kriterit të minimumit të dy ofertuesve, ZRRE më 18 dhjetor 2025, ka publikuar njoftimin për anulimin e tenderit.
 - Më 18 nëntor 2025, ZRRE ka vendosur në konsultim publik dokumentin “Propozim për Metodologjinë e Kufizimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë”, duke ftuar palët e interesuara të paraqesin komentet e tyre me shkrim.
 - Më 18 nëntor 2025, ZRRE ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili ka hedhur poshtë kërkesat për shfuqizimin e Njoftimit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe për anulimin e kontratave të konsumatorëve jofamiljarë, duke konfirmuar vazhdimin e procesit të liberalizimit. Gjykata ka vërtetuar se furnizimi me tarifa të rregulluara u takon vetëm konsumatorëve që kualifikohen për Shërbim Universal, ndërsa të tjerët duhet të furnizohen në tregun e hapur. Po ashtu, janë shfuqizuar dy dispozita të udhëzuesve të mëhershëm për liberalizim, për të cilat ZRRE do të ndjekë procedurat ligjore përkatëse.
 - Më 18 nëntor 2025, ZRRE ka hapur procedurën e ri-tenderimit për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF), i cili siguron furnizim të përkohshëm me energji elektrike për konsumatorët në rastet e parashikuara me ligj.
 - Më 18 dhjetor 2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka shqyrtuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme P.A.nr.18/2025, duke konstatuar se neni 8 i Udhëzuesit për Liberalizimin e

Tregut të Energjisë Elektrike (2017), si dhe neni 2 i ndryshimeve dhe plotësimeve të viteve 2018–2019, janë shfuqizuar dhe nuk përbëjnë më pjesë të rendit juridik.

- Më 15 dhjetor 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka publikuar Raportin mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Ndërmarrjen NQ Gjakova për sezonin 2025/2026.
- Më 15 dhjetor 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka publikuar Raportin mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Ndërmarrjen NQ Termokos për sezonin 2025/2026.
- Më 30 dhjetor 2025, Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar dhe miratuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për ndërmarrjet NQ Termokos sh.a dhe NQ Gjakova sh.a për sezonin e ngrohjes 2025/2026, si dhe tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të këtyre ndërmarrjeve.



Fig. 4.1 Dëgjimi publik për dokumentin “Rregulla për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme”, organizuar nga ZRRE në bashkëpunim me BERZH, më 15 shtator 2025

4.2 Raportimi dhe bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës

Për shkak të moskonstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2025, ZRRE nuk ka pasur mundësi të raportojë për Raportin Vjetor 2024 dhe Raportin Financiar 2024 para komisioneve përkatëse parlamentare.

4.3 Takimet me palët e tjera të interesit

- Më 09 janar 2025, Bordi i ZRRE-së priti ekipin e BERZH-it për të diskutuar financimin e projekteve në rrjetin e transmissioinit, kornizën ligjore për përshtatjet vjetore dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjetik.
- Më 15 janar 2025, Bordi i ZRRE-së priti ekipin e MCA Kosova për të diskutuar zhvillimet e Projektit të Sistemit të Ruajtjes së Baterisë, përfshirë implementimin, kornizën ligjore dhe sfidat në angazhimin e kapaciteteve njerëzore.
- Më 20 shkurt 2025, Bordi i ZRRE-së priti ekipin e KfW-së për të diskutuar bashkëpunimin mbi Huanë e Bazuar në Politika (Policy Based Loan) për sektorët e energjisë dhe klimës, duke përfshirë reformat në KEK dhe zhvillimet në tregjet e energjisë në Kosovë.

- Në kuadër të procesit të liberalizimit të tregut të energjisë, ZRRE ka organizuar takime informuese me palët e interesit për të siguruar informim të duhur dhe për të diskutuar sfidat dhe kërkesat e sektorit. Takimet u zhvilluan me: Oden Ekonomike të Kosovës, më 18 mars 2025; Oden Amerikane të Kosovës, më 19 mars 2025; Aleancën Kosovare të Bizneseve, më 26 mars 2025; Oden Ekonomike Gjermano-Kosovare, më 27 mars 2025 dhe Pro-Credit Bank, më 01 Prill 2025. Po ashtu, në vazhdimësi, ZRRE i është përgjigjur kërkesave dhe pyetjeve të publikut dhe mediave për informim lidhur me këtë proces.
- Më 20 mars 2025, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, z. Ymer Fejzullahu, zhvilloi takim me Drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, z. Ilir Murtezaj, për të koordinuar veprimet institucionale lidhur me proceset ligjore të bizneseve për pjesëmarrjen në tregun e hapur të energjisë.
- Më 4 prill 2025, ZRRE nisi takimet konsultuese me palët e interesit për shqyrtimin e përshtatjeve vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e licencuar OSSH-KEDS, OST/OT-KOSTT dhe FSHU-KESCO. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Green Energy Kosova, INDEP dhe Sindikata e Punëtorëve të KEDS-it, duke siguruar një dialog gjithëpërfshirës mbi propozimet dhe komentet e pranuar gjatë konsultimit publik.
- Më 7 prill 2025, ZRRE zhvilloi një takim me mediat në kuadër të takimeve konsultuese me palët e interesit dhe informimin e duhur të mediave dhe publikut për shqyrtimin e përshtatjeve vjetore të të Hyrave Lejuara Maksimale për operatorët e licencuar OSSH-KEDS, OST/OT-KOSTT dhe FSHU-KESCO.
- Më 25 prill 2025, ZRRE zhvilloi një takim informues me furnizuesit e energjisë elektrike në Shqipëri për të prezantuar ecurinë dhe mundësitë e liberalizimit të tregut të energjisë në Kosovë.
- Më 6 maj 2025, ZRRE mbajti takim me përfaqësues të KEK-ut dhe ALPEX-it për të forcuar bashkëpunimin institucional dhe shkëmbimin e informacionit mbi tregtimin e energjisë elektrike.
- Më 12.05.2025, ZRRE mbajti takim informues me furnizuesit e energjisë elektrike në Maqedoninë e Veriut për të prezantuar ecurinë dhe mundësitë e liberalizimit të tregut të energjisë në Kosovë.
- Më 16 maj 2025, ZRRE mbajti takim me përfaqësuesit e Odave Ekonomike të Kosovës për të diskutuar shqetësimet e bizneseve lidhur me procesin e liberalizimit të tregut të energjisë.
- Më 16 maj 2025, ZRRE mbajti takim me KEK, KOSTT, KEDS dhe KESCO për të diskutuar përgatitjet e tyre lidhur me procesin e liberalizimit të tregut të energjisë.
- Më 22 maj 2025, ZRRE zhvilloi takim gjithëpërfshirës me furnizuesit e licencuar të energjisë elektrike, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe informimit të saktë të konsumatorëve për kalimin në tregun e liberalizuar.
- Më 23 maj 2025, ZRRE mbajti takim koordinues me Kryeshefat Ekzekutiv të KEK, KOSTT, KEDS dhe KESCO për të shqyrtuar hapat përfundimtarë drejt liberalizimit të tregut të energjisë.
- Më 30 shtator 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji ka pritur në takim ekipin e Bankës Botërore në kuadër të projektit Kosovo Renewable Energy Preparation Support Project (Projekti Mbështetës për Përgatitjen e Energjisë së Ripërtëritshme në Kosovë).
- Më 3 tetor 2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji zhvilloi një takim njoftues me Zv. Ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, z. Christian Böttcher, me qëllim thellimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet ZRRE-së dhe ambasadës gjermane në Prishtinë.

- Më 09 tetor 2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) zhvilloi një takim me përfaqësuesit e një misioni të përbashkët të Bankës Botërore dhe Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), në kuadër të përgatitjes së Diagnostifikimit të Sektorit Privat në Kosovë (CPSD).

4.4 Takimet e Grupit të Implementimit në kuadër të iniciativës për bashkimin e tregjeve SEE - MC

Me 22 tetor 2025 u mbajt takimi i radhës i Grupit Implementues për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, nën udhëheqjen e Kryesuesit të Bordit të ZRRE-së, z. Ymer Fejzullahu. Në takim u diskutuan zhvillimet kryesore të bashkëpunimit rajonal, përfshirë metodologjitë e kalkulimit të kapaciteteve dhe proceset e integritimit të tregut. Palët riafirmuan mbështetjen për avancimin e projekteve të përbashkëta dhe harmonizimin me legjislacionin evropian, me synim ndërtimin e një tregu rajonal më efikas dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji.



Fig. 4.2 Takimi i Grupit Implementues për Bashkimin e Tregjeve të Energjisë Elektrike gjatë punimeve të datës 22 tetor 2025

4.5 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Gjatë muajit nëntor 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar një vizitë studimore në Suedi, me mbështetjen e projektit të LuxDev, me qëllim harmonizimin e sistemit të Kosovës për Garancitë e Originës me Sistemin Evropian të Certifikimit të Energjisë (EECS). Vizita ka shërbyer për shkëmbim përvojash institucionale dhe ngritje të kapaciteteve, duke mbështetur avancimin e kornizës ligjore dhe teknike për certifikimin e energjisë së ripërtëritshme në përputhje me standardet evropiane.

ZRRE dhe CDF nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi

Më 03 tetor 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Community Development Fund (CDF) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për të mbështetur zhvillimin e Bashkësive të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme në Kosovë. Ky bashkëpunim synon të krijojë një kornizë të qëndrueshme rregullative, duke siguruar transparencë, përfshirje të komuniteteve dhe përputhshmëri me praktikën më të mirë të Bashkimit Evropian, përfshirë edhe ofrimin e ekspertizës teknike, edukimin dhe pilot-projektet për të rritur ndërgjegjësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm energjetik.

Kosova anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Entiteteve Lëshuese të Certifikatave të Originës – AIB

Kosova është pranuar anëtare me të drejta të plota në AIB, me vendim të miratuar më 26 nëntor 2025 në Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në Lisbonë. Ky anëtarësim e bën Kosovën pjesë të platformës evropiane të Garancive të Originës dhe mundëson adoptimin e sistemit EECS. Ky hap rrit besueshmërinë e certifikimit të energjisë së ripërtëritshme, mundëson tregti ndërkufitare më efikase dhe forcon integrimin e vendit në tregun evropian të energjisë, duke mbështetur njëkohësisht tranzicionin energjetik dhe harmonizimin me kornizën rregullative të BE-së.



Fig. 4.3 Vizita studimore e Zyrës së Rregullatorit për Energji në Suedi, e realizuar me mbështetjen e projektit LuxDev, nëntor 2025

4.6 Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet ndërkombëtare

Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ZRRE-ja si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Në vijim janë paraqitur aktivitetet kryesore dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, në konferencat ndërkombëtare, tryezat punuese apo takimet multilaterale dhe bilaterale.

- Më 27 mars 2025, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, z. Ymer Fejzullahu, mori pjesë si panelist në Konferencën e Tretë Vjetore të CorrWatch në Prishtinë, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse dhe angazhimin e ZRRE-së për transparencë dhe llogaridhënie.
- Më 24 shtator 2025, Kryesuesi i ZRRE-së, z. Ymer Fejzullahu, mori pjesë në panelin në Forumin e Energjisë në Kosovë & Green Business Expo 2025, me temën “Empowering Competitiveness: Investing in Renewables and Energy Efficiency in a Liberalised Market”, duke theksuar rëndësinë e liberalizimit të tregut të energjisë për rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.
- Më 25 shtator 2025, përfaqësuesit e ZRRE-së, z. Skender Muqolli dhe z. Muharrem Gashi, morën pjesë në takimin e 20-të të Grupit Punues të ECRB për REMIT, ku prezantuan zhvillimet më të fundit të udhërrëfyesit REMIT dhe procesin e tij rajonal.
- Më 15 tetor 2025, në Bruksel, përfaqësuesja e ZRRE-së, znj. Ilirjana Tolaj, mori pjesë si paneliste në ngjarjen “Women in Energy Awayday” të CEER-it, duke diskutuar nismat dhe politikat për përfshirjen dhe fuqizimin e grave në sektorin e energjisë.
- Më 3 tetor 2025, stafi i ZRRE-së mori pjesë në takimin e ECRB Electricity Working Group mbi integrimin rajonal të tregut të energjisë elektrike, duke diskutuar harmonizimin e tregjeve, rolin e NEMO-ve dhe kapacitetet për tregtim ndërkufitar.

4.6.1 Pjesëmarrja e Rregullatorit në aktivitetet e ERRA²

Duke qenë anëtare e asociuar e ERRA-s, ZRRE ka anëtarët e saj të rregullt të emëruar në grupet punuese dhe grupin e kryesuesve, të cilët kanë mbajtur takimet e tyre edhe gjatë kësaj periudhe.

- Më 23 tetor 2025, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, z. Ymer Fejzullahu, mori pjesë në takimin e ERRA-s, ku u diskutuan zhvillimet rregullative, reformat e tregut të energjisë dhe çmimet për konsumatorët familjarë, duke theksuar rëndësinë e pavarësisë së rregullatorëve.

4.6.2 Pjesëmarrja në Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB)

Komuniteti i Energjisë (KE) është organizatë ndërkombëtare e themeluar përmes Traktatit ndërkombëtarë (i ashtuquajtur Traktati i Komunitetit të Energjisë) në tetor 2005 në Athinë, ku marrin pjesë vendet e Bashkimit Evropian dhe regjionit të Evropës juglindore dhe të Detit të Zi. Aktivitetet e

² ZRRE që nga viti 2005 është anëtare e Asociacionit Rajonal të Rregullatorëve të Energjisë, ERRA (Energy Regional Regulatory Asociacion). ERRA është një organizatë vullnetare e përbërë nga organe të pavarura të rregullimit të energjisë kryesisht nga Evropa, Azia, Afrika, Lindja e Mesme, Amerika e Jugut dhe Amerika e Veriut. <https://erranet.org/>

KE gjatë vitit 2025 janë fokusuar drejt përmbushjes së synimeve të përbashkëta: implementimin e “acquis communautaire”, zhvillimin e kornizës rregullative të harmonizuar në nivel regional, si dhe liberalizimin dhe integrimin e tregjeve të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Palët Kontraktuese të KE janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Moldavia, Ukraina dhe Gjeorgjia. Në cilësinë e pjesëmarrësve janë shtetë anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa Norvegjia, Turqia, Armenia dhe kanë statusin e Vëzhguesit.



Fig. 4.4 Takimi i 63-të i Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB), mbajtur më 2 dhjetor 2025 në Athinë

- Më 2 prill 2025, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë ka shprehur mbështetjen për veprimet e Bordit të ZRRE-së në procesin tarifor, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe pavarësisë në vendimmarrje si elemente kyçe për një treg energjetik të drejtë dhe të qëndrueshëm.
- Më 04 qershor 2025, Z Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, njëkohësisht edhe Presidenti i Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB), z. Ymer Fejzullahu, kryesoi mbledhjen e 61-të të Bordit të Komunitetit të Energjisë në Athinë, ku u diskutuan të arriturat e gjysmës së parë të vitit 2025, rëndësia e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare, si dhe bashkimi i tregjeve dhe harmonizimi i legjislacionit për një treg energjie të qëndrueshëm, të integruar dhe të sigurt.
- Më 10 qershor 2025, ZRRE mori pjesë në Forumin e Energjisë të Komunitetit të Energjisë, duke diskutuar integrimin rajonal të tregut dhe tranzicionin e drejtë energjetik. Kryesuesi i Bordit, z. Ymer Fejzullahu, prezantoi kompetencat e reja të rregullatorëve dhe përvojën e bashkimit të tregjeve të energjisë mes Kosovës dhe Shqipërisë, duke theksuar nevojën për pavarësi institucionale dhe financiare. Anëtari i Bordit, z. Gani Buçaj, mori pjesë në dy panele, ku prezantoi rëndësinë e energjisë së përballeshme dhe pjesëmarrjes aktive të konsumatorëve, si dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme dhe përvojën e ZRRE-së në promovimin e energjisë solare.

- Më 30 shtator 2025, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, njëkohësisht edhe Presidenti i Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB), z. Ymer Fejzullahu, kryesoi takimin e 62-të të ECRB-së në Athinë, ku mori pjesë edhe anëtari i Bordit të ZRRE-së, z. Gani Buçaj. Diskutimet u fokusuan në zhvillimet rregullative, reformat e tregut dhe integrimin rajonal, duke përfshirë menaxhimin e kapaciteteve të transmetimit dhe aktivitetet e grupeve punuese.
- Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, kryesoi takimin e 63-të të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, të mbajtur më 2 dhjetor 2025 në Athinë. Në takim u trajtuan zhvillimet kryesore rregullatore, bashkëpunimi rajonal dhe u miratua Programi i Punës së ECRB-së për vitin 2026.




Fig. 4.5 Shtetet anëtare të Komunitetit për Energji të Evropës Juglindore

Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) është një komponentë kyçe strategjike e Unionit Evropian (UE) për Evropën Jug-Lindore dhe një mjet efektiv i para-aderimit, që synon të zgjerojë përfitimet nga Tregu rajonal për Energji, para se vendet e rajonit të bëhen anëtarë të UE.

Institucionet kryesore të KE-së janë: Këshilli i Ministrave (KM), Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (GPNL), Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), Sekretariati i KE i vendosur në Vjenë, dhe katër forumet këshilluese: për energji elektrike, gaz natyror, çështjet sociale dhe naftën.

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB – “Energy Community Regulatory Board”) është institucion i themeluar sipas nenit 58 të TKE, që përbëhet nga Autoritet Rregullative të palëve kontraktuese, pjesëmarrësve dhe vëzhguesve. ECRB ka rolin e një trupi koordinues të autoriteteve rregullative për harmonizimin e kornizës rregullative, shkëmbimin e njohurive, dhe zhvillimin e praktikave për zbatimin e Traktatit.

Bazuar në dispozitat e Traktatit të KE, ECRB ka këto përgjegjësi:

- Këshillon Këshillin Ministror si dhe PHLG-së, për çështje statusore, teknike dhe rregullative;
- lëshon rekomandime për palët, në pajtim me dispozitat e Traktatit, për mosmarrëveshje ndër-kufitare, etj;

- merr masa ndaj palëve, nëse autorizohet nga KM;
- ndihmon bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve rregullative;
- jep rekomandime dhe përgatitë raporte, në lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë; dhe
- kërkon përmbushjen e detyrimeve nga palët sipas TKE.

Për përmbushjen e përgjegjësive, ECRB është e organizuar në grupe punuese të cilat zhvillojnë aktivitetet në fushat përkatëse. ECRB udhëhiqet nga kryetari i zgjedhur për çdo vit nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacional, dhe nënkryetari i cili është i deleguar nga Komisioni Evropian.




Fig. 4.6 Struktura e Bordit Rregullativ të Komunitetit të energjisë

4.6.3 Aktivitetet e Rregullatorit në kuadër të ECRB-së

Sipas obligimeve ndaj KE-së, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet në ECRB dhe në çdo grup punues, si dhe merr pjesë aktivisht në punën e Bordit dhe grupeve punuese përkatëse.

4.6.3.1 Grupi Punues për Energji Elektrike

Ky grup punues, gjatë vitit 2025, ka zhvilluar aktivitetet dhe takimet e rregullta në kuadër të fushëveprimtarisë së vet; për punë më efektive ky grup ka ndërmarrë aktivitetet përmes nëngrupeve ('Task Force'-TF) si në vijim:

- **TF1 – Hapja dhe integrimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike** - Me qëllim që të mbështes hapjen efektive të tregut rajonal të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë, ky nëngrup është fokusuar në aktivitetet për mbështetjen rregullative, integrimin e tregjeve 'një-ditë-para' dhe 'brenda-ditës' në Evropën Jug-lindore;
- **TF2 – Mjedis i favorshëm rregullativ për investime** – aktivitetet e këtij nën-grupi janë përqendruar në krijimin e një kornize rregullative stabile, të qëndrueshme dhe të harmonizuara në nivel rajonal, si një parakusht themelor për të tërhequr investimet në infrastrukturë energjetike.
- **TF3 – Monitorimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike:**

Monitorimi i Tregut si një komponentë kyçe e përgjegjësiwe rregullative, përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore duke mundësuar promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, efiçencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.

- **TF4 – Integrimi i energjisë së ripërtëritshme dhe balancimi**– Në kuadër të kësaj task force janë vlerësuar sfidat rregullative të integritit të energjisë së ripërtëritshme në sistemet e energjisë dhe përgjegjësinë e prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme për balancim të sistemit.
- **TF5 – Opinionet për Kodet e rrjetit të energjisë elektrike dhe udhëzimeve rregullative** – detyrë kryesore e këtij nëngrupi ka qenë shqyrtimi i koordinuar dhe dhënia e mendimit për kodet e rrjeteve të energjisë elektrike dhe udhëzimeve përkatëse rregullative.
- **TF6 – Zbatimi i kodeve të rrjetit dhe rregulloreve udhëzuese**– Sipas kësaj detyre, EWG do të shqyrtojë procesin e monitorimit të ACER dhe ENTSO-E dhe do të raportojë mbi aktivitetin e monitorimit, dhe kryesisht fokusohet në monitorimin e zbatimit të Kodeve të Rrjetit- Kodit të Kyçjes.

4.6.3.2 Grupi Punues për Gaz (GPG)

Ky grup punues aktivitetet e veta i përqendron në çështjet e rregullimit të sektorit të gazit natyror, harmonizimin e kornizës rregullative në nivel rajonal dhe çështjet tjera të ndërlidhura me zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror në rajonin e EJT. Me qëllim të efiçasitetit dhe trajtimit të çështjeve specifike aktivitetet janë ndërmarrë përmes këtyre nëngrupeve të veçanta (“Task Force” – TF):

- **TF1 – Monitorimi i tregut me shumicë të gazit natyror** - Monitorimi i tregut si një komponentë kyçe e përgjegjësiwe rregullative përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore duke mundësuar promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, efiçencën e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit me gaz natyror.
- **TF2 – Implementimi i Kodit të rrjetit për Menaxhimin e kongjescionit** - Aktivitetet në kuadër të kësaj taske force janë përqendruar në monitorimin e kongjescionit në pikat interkonektive duke konsideruar tregtimin e kapaciteteve në tregjet dytësore dhe përdorimin e kapacitetit ‘me ndërprerje’, si dhe analizën e kontratave ekzistuese afatgjata.
- **TF3 – Implementimi i Kodit të rrjetit për Mekanizmin e alokimit të kapaciteteve** – aktivitetet janë përqendruar në përfshirjen e Autoriteteve rregullative nacionale dhe Operatorëve të sistemit të transmisionit të gazit në përzgjedhjen e platformës së përbashkët të rezervimit të kapaciteteve, me qëllim të implementimit të nenit 37 të Kodit të rrjetit për alokim të kapaciteteve.
- **TF4 – Mjedis i favorshëm rregullativ për investime** – aktivitetet e këtij nën-grupi janë përqendruar në krijimin e një kornize rregullative stabile, të qëndrueshme dhe të harmonizuara në nivel rajonal, si një parakusht themelor për të tërhequr investimet në infrastrukturën e gazit natyror.
- **TF5 – Opinionet për Kodet e rrjetit të gazit natyror dhe udhëzimeve rregullative** – detyrë kryesore e këtij nëngrupi ka qenë shqyrtimi i koordinuar dhe dhënia e mendimit për kodet e rrjeteve të energjisë elektrike dhe udhëzimeve përkatëse rregullative.

4.6.3.3 Grupi punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë

Në kuadër të ECRB ekziston grupi punues për konsumatorë me nëngrupet e veta, i cili merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve, tarifat dhe çmimet me pakicë, marrëdhëniet kontraktuale mes furnizuesit dhe konsumatorëve, si dhe kualitetin e furnizimit me energji dhe rregullimin e cilësisë së tensionit.

- **TF1 – Monitorimi i tregut me pakicë** - Monitorimi i tregut si një komponentë themelore e përgjegjësiwe rregullative përfshinë njoftimin e plotë me performancën e tregut dhe perspektivat zhvillimore për të mundësuar krijimin e një kornizë efektive që balancon nevojat e pjesëmarrësve të tregut dhe promovimin e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, eficientë e energjisë, investimet dhe sigurinë e furnizimit.
- **TF2 – Mbrojtja e konsumatorëve** – duke qenë se mbrojtja e konsumatorëve konsiderohet si ndër detyrat kryesore të Autoriteteve rregullative, rrjedhimisht kjo përgjegjësi përcillet edhe në organizatat regjionale / ndërkombëtare si ECRB, CEER dhe MEDREG. Aktivitetet janë fokusuar në bashkëpunimin e këtyre 3 trupave regjional për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe efikase në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.
- **TF3 – Fuqizimi dhe mbrojtja e konsumatorit** - Detyrë kryesore e këtij nën grupi punues ka qenë që të bëjë vlerësimin e përfshirjes/transpozimit të Direktivës 2019/944 në legjislacionin primar dhe sekondar të shteteve anëtare sa i përket të drejtave të konsumatorëve pasi që vendos një bazë solide për pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregjet e energjisë elektrike duke futur kontrata dinamike të çmimeve, mundësinë e bashkimit me konsumatorët e tjerë, përgjigjen ndaj kërkesës (nëpërmjet grumbullimit) dhe përfshirjen e qytetarëve si komunitet i energjisë.

4.6.3.4 Grupi punues për REMIT dhe siguri kibernetike

Në kuadër të këtij grupi kanë funksionuar 4 task forca:

- **TF1 – Udhëzuesi për REMIT**- do të vlerësojë nëse udhëzimet përkatëse të zhvilluara nga ACER mund të përdoren në mënyrë të njëjtë ose nevojiten përshtatje me specifikat e Palëve Kontraktuese ose versionin "REMIT light" të zbatueshëm në Komunitetin e Energjisë. Në rastin e fundit, grupi i punës do të zhvillojë udhëzime të veçanta të ECRB-së.
- **TF2 – Mirëmbajtja e regjistrit qendror**: do të vlerësojë mundësinë për ta bërë regjistrimin dhe krijimin e regjistrit qendror, duke përfshirë kërkesat e mundshme të TI-së për mbledhjen e automatizuar të të dhënave të regjistrimit.
- **TF3 – Platforma për informata të brendshme**: Kjo task forcë do të diskutojë dhe vlerësojë nevojën për platformën e centralizuar për publikimin e informacionit të brendshëm.
- **TF4 – Implementimi i REMIT**: Rregullatori do të raportoj për rastet, hetimet e ndërmarra etj. në lidhje me REMIT, duke përfshirë edhe rastet e diskutuara dhe të koordinuara nga ECRB.

4.7 Aktivitetet e prokurimit

Rregullatori vazhdon të ndjek procedurat e prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), të cilat ndonjëherë, si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, janë të stërzgjatura dhe sjellin vështirësi në sigurimin e shërbimeve dhe furnizimeve të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të zyrës.

5 RAPORTIMI FINANCIAR PËR RREGULLATORIN

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mbledhen nga operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

5.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2025, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar të hyra në shumë prej 1,900,601.80€. Duke pasur parasysh që shuma totale e buxhetit të shpenzuar nga ZRRE në vitin 2025 është 827,785.64€, të hyrat e pashpenzuara në shume prej 1,072,815.93€, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Tab. 5.1 Të hyrat

| Përshkrimi | Shuma |
|---|------------------|
| Të hyrat vetanake 2025 | (1,900,601.80) € |
| Shpenzimet 2025 | 827,785.87 € |
| Të hyrat e derdhura në Buxhetin e Republikës së Kosovës | (1,072,815.93) € |

5.2 Buxheti

Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin nr.08/L-332, Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 1,148,610€, i cili në tërësi është alokuar si grant qeveritar, përkundër faktit që me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE financohet nga të hyrat vetanake dhe vetëm në rastet kur këto të hyra janë të pamjaftueshme, atëherë ZRRE mund të shfrytëzoj ndarje buxhetore në formë të grantit qeveritar. Sipas kategorive ekonomike buxheti i ZRRE-së ishte si në vijim:

Tab. 5.2 Buxheti në fillim të vitit

| Përshkrimi | Buxheti |
|---------------------|----------------|
| Paga dhe mëditje | 567,478.00 € |
| Mallra dhe shërbime | 478,332.00 € |
| Shpenzime komunale | 22,000.00 € |
| Shpenzime kapitale | 80,800.00 € |
| Gjithsej | 1,148,610.00 € |

Me vendim të Qeverise të datës 26.12.2025 nr. 04/282, buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji në kategorinë “mallra dhe shërbime” është shkurtuar për 35,973.48€, ndërsa në kategorinë ekonomike “Paga dhe Shtesa”, me vendim të Qeverise nr. 03/261 të datës 05.06.2025, është shtuar buxhet në shume prej 8,567.21€, për gjashtëmuorin e dyte të vitit për shkak të rritjes së koeficientit të pagave. Në fund të vitit buxheti i pashpenzuar për shkak të pozitave të paplotësuara me vendim të Qeverise nr.01/281, është shkurtuar për 188,447.92€.

Shprehur në përqindje buxheti i ZRrE-së është shkurtuar për 18 %.

Tab. 5.3 Buxheti final

| Përshkrimi | Buxheti |
|---------------------|--------------|
| Paga dhe mëditje | 387,597.29 € |
| Mallra dhe shërbime | 442,358.52 € |
| Shpenzime komunale | 22,000.00 € |
| Shpenzime kapitale | 80,800.00 € |
| Gjithsej | 932,755.81 € |

5.3 Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2025, ZRRE ka shpenzuar 827,785.87€.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë:

Tab. 5.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

| Përshkrimi | Shuma |
|---------------------|--------------|
| Paga dhe mëditje | 387,597.29 € |
| Mallra dhe shërbime | 340,263.14 € |
| Shpenzime komunale | 19,497.58 € |
| Shpenzime kapitale | 80,427.86 € |
| Gjithsej | 827,785.87 € |

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e mbetur pas shkurtimeve është 88.75 %.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën më poshtë.

Tab. 5.5 Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje

| Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet | Ndryshimi | Realizimi në % |
|---------------------|--------------|--------------|--------------|----------------|
| Paga dhe mëditje | 387,597.29 € | 387,597.29 € | - € | 100.00% |
| Mallra dhe shërbime | 442,358.52 € | 340,263.14 € | 102,095.38 € | 76.92% |
| Shpenzime komunale | 22,000.00 € | 19,497.58 € | 2,502.42 € | 88.63% |
| Shpenzime kapitale | 80,800.00 € | 80,427.86 € | 372.14 € | 99.54% |
| Gjithsej | 932,755.81 € | 827,785.87 € | 104,969.94 € | 88.75% |




Fig. 5.1 Buxheti dhe shpenzimet për vitin 2025

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Tab. 5.6 Pagat dhe mëditjet

| Pagat dhe mëditjet | Shuma |
|------------------------------------|--------------|
| Pagat neto | 227,347.28 € |
| Tatimi në të ardhura personale | 27,267.62 € |
| Kontributi pensional - punëtori | 18,457.33 € |
| Përvoja e punës | 14,607.09 € |
| Kontributi pensional - punëdhënësi | 18,457.33 € |
| Puna jashtë orarit | 1,868.42 € |
| Shtesat tranzitore | 79,592.22 € |
| Gjithsej | 387,597.29 € |

Tab. 5.7 Mallrat dhe shërbimet

| Mallrat dhe shërbimet | Shuma |
|--|--------------|
| Akomodimi për udhëtim zyrtar brenda vendit | 3,120.00 € |
| Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit | 6,362.61 € |
| Para xhepi - Mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit | 8,199.26 € |
| Akomodimi për udhëtime zyrtare jashtë vendit | 3,849.80 € |
| Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jashtë vendit | 1,582.30 € |
| Shpenzime për Internet | 3,510.12 € |
| Shpenzimet e telefonisë mobile | 5,116.17 € |
| Shpenzimet postare | 239.80 € |
| Shërbimet arsimit dhe trajnimit | 500.00 € |
| Shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale | 5,017.26 € |
| Shërbimet e shtypjes / printimit | 119.50 € |
| Sigurimi fizik i objekteve publike | 44,461.20 € |
| Shpenzimet e anëtarësisë | 38,901.88 € |
| Mobilje | 156.00 € |
| Kompjuter | 15,658.94 € |
| Pajisje tjera të TI-se | 9,928.00 € |
| Pajisje tjera | 2,100.00 € |
| Furnizime për zyrë | 260.20 € |
| Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 1,584.77 € |
| Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri | 2,810.04 € |
| Regjistrimi i automjeteve | 510.00 € |
| Sigurimi i automjeteve | 2,516.58 € |
| Taksa komunale për automjeteve | 60.00 € |
| Kontrollimi teknik i automjeteve | 90.00 € |
| Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve | 797.00 € |
| Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste | 6,632.88 € |
| Mirëmbajtja e teknologjisë informative | 4,000.20 € |
| Qiraja për ndërtesa | 164,294.40 € |
| Qiraja për pajisje | 2,039.25 € |
| Kompenzim i përfaqësisë brenda vendit | 5,844.98 € |
| Gjithsej | 340,263.14 € |

Siç shihet nga tabela 1.7, shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë kategori të shpenzimeve është 340,263.14€.

Tab. 5.8 Shpenzimet komunale

| Shpenzimet komunale | Shuma |
|---|-----------|
| Energjia elektrike | 6,145.37 |
| Shpenzimet e ujësjellësit dhe kanalizimit | 369.30 |
| Ngrohja qendrore | 12,677.64 |
| Telefonia fikse | 305.27 |
| Gjithsej | 19,497.58 |

Tab. 5.9 Shpenzimet kapitale

| Shpenzimet kapitale | Shuma |
|---------------------|-----------|
| Veturat zyrtare | 38,950.00 |
| Pajisje të TI-së | 41,477.86 |
| Gjithsej | 80,427.86 |

6 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

6.1 Karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike

Sistemi energjetik në Republikën e Kosovës, i përbërë nga gjenerimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike dhe furnizuesit si dhe tregtarët me shumicë, është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike bazë, e cila bazohet në linjit si lëndë e parë, por jo edhe për mbulimin e ngarkesave maksimale dhe balancimin e sistemit i cili mbetet sfidë e madhe për të gjithë pjesëmarrësit në sektor.

Edhe përkundër interesimit të investitorëve për investim në kapaciteteve të reja nga BRE-të, gjatë vitit 2025 ka pasur një numër të vogël të kapacitetet të reja prodhuese të energjisë elektrike nga sistemet fotovoltaike dhe atë gjithsej 6 impiante në total kapacitet 21.48 MW. Kapacitetet e instaluar prodhuese në Kosovë janë gjithsej 1,593.07 MW, përfshirë edhe kapacitetet prodhuese nga BRE. Kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,261.12 MW, prej të cilave termocentralet (TC) me linjit përbëjnë rreth 76.12 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga HC Ujmani, BRE në transmetim dhe BRE tjera (hidrocentralet, panelet solare dhe centralet me erë) me 23.88 %.

Pjesa më e madhe e konsumit është mbuluar nga prodhimi vendor, por për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe jofleksibilitetit të mjaftueshëm për t'iu përshtatur kërkesës në periudha të ndryshme e sidomos në kohën e pikut, atëherë është ngritur nevoja për importe por ndonjëherë edhe eksporte për balancimin e sistemit.

Figura më poshtë paraqet prodhimin, importin, eksportin dhe kërkesën e energjisë elektrike gjatë dhjetë viteve të fundit.




Fig. 6.1 Prodhimi, importi dhe kërkesa e energjisë 2015 - 2025

6.1.1 Tregu i energjisë elektrike

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë edhe në vitin 2025 ka vazhduar të zhvillohet dhe konsolidohet me hapa të rëndësishëm duke reflektuar efektet pozitive të reformave të ndërmarra gjatë vitit paraprak sipas kërkesave ligjore.

ALPEX ka shënuar performancë të qëndrueshme gjatë vitit 2025, duke rritur gradualisht vëllimin e energjisë së tregtuar si në tregun day-ahead ashtu edhe në atë intraday. Rritja e pjesëmarrjes së operatorëve dhe integrimi më i mirë i burimeve të energjisë kanë ndikuar në rritjen e likuiditetit dhe në formimin më të qëndrueshëm të çmimeve. Gjithashtu, përdorimi i mekanizmave të tregut përmes ALPEX ka mundësuar optimizim më të mirë të portofolëve të furnizuesve dhe prodhuesve.

Megjithatë, pavarësisht zhvillimit të tregjeve të organizuara, tregtimi me shumicë në Kosovë edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar të dominohet nga kontratat bilaterale. Kufizimet që rrjedhin nga obligimet kontraktuale ekzistuese, veçanërisht në lidhje me furnizimin e garantuar për konsumatorët me shërbim universal dhe mbulimin e humbjeve të sistemit, kanë ndikuar në nivelin e likuiditetit në tregun e organizuar. Sipas Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë (MFSH), energjia elektrike e prodhuar nga KEK ofrohet për Furnizuesin që furnizon konsumatorët me të drejtë të Shërbimit Universal si dhe për mbulimin e humbjeve të sistemit, derisa tepricat tregtohen në tregun me shumicë sipas parimeve të tregut (një pjesë në ALPEX dhe pjesa tjetër përmes kontratave bilaterale).

HC Ujmani, në vitin 2025 ka vazhduar të tregtojë tërë energjinë në treg të lirë, duke marrë pjesë në ankandet një ditë para të ALPEX.

Gjithashtu, energjia e prodhuar nga gjeneratorët BRE me skema mbështetëse është tregtuar përmes ALPEX me kontrata për Diferencë (CfD).

Pavarësisht progresit të arritur, sistemi energjetik i Kosovës vijon të përballet me sfida strukturore, të lidhura kryesisht me vjetërsinë e termocentraleve ekzistuese dhe mungesën e kapaciteteve fleksibile rregulluese. Këta faktorë kufizojnë aftësinë e sistemit për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase ngarkesave të larta gjatë periudhave të pikut, duke bërë që vendi të mbetet i varur nga importet, ndërsa vetëm në raste të caktuara të realizojë edhe eksporte të energjisë elektrike.

Kapacitetet ndërkufitare të interkoneksionit vazhdojnë të kenë rol thelbësor në funksionimin e tregut të energjisë. Megjithatë, kufizimet e shkaktuara nga bllokimi i njëanshëm i linjave interkonektive nga Serbia kanë ndikuar ndjeshëm në funksionimin e tregjeve rajonale, me ndikim më të theksuar në Kosovë. Si pasojë, është vërejtur një rritje e konsiderueshme e çmimeve të kapaciteteve ndërkufitare, duke e vështirësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe duke ndikuar në rritjen e kostos së importit të energjisë elektrike.

Në këtë kontekst, Departamenti i Tregut të Energjisë (DTE) ka përgatitur një draft raport monitorimi të importit të energjisë elektrike nga bursat përfshirë edhe kapacitetet ndërkufitare, lidhur me rritjen e çmimeve të kapaciteteve ndërkufitare, me fokus të veçantë në kufirin Kosovë–Mal i Zi, i cili ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kostove për konsumatorët fundorë. Hetimi është zhvilluar në disa segmente kyçe, duke përfshirë procesin e përzgjedhjes së agjentit nga ana e KESCO për realizimin e blerjeve në bursa ndërkombëtare, përmbushjen e obligimeve të KESCO për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme ndërkufitare në funksion të sigurisë së furnizimit, analizën e marrëveshjes ndërmjet KESCO dhe agjentit të përzgjedhur në aspektin e përputhshmërisë kontraktuale, si dhe vlerësimin e sjelljes së palëve, përfshirë praktikën e blerjes së energjisë.

Gjetjet e këtij raporti theksojnë se faktorët e sipërpërmendur, në kombinim me kufizimet strukturore të kapaciteteve ndërkufitare me bllokimin e linjave ndërkufitare me Serbinë, kanë kontribuar në rritjen e kostove të furnizimit me energji elektrike, duke u reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në barrën financiare të konsumatorëve.

Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në nivel të vendit ka shënuar ngritje të lehtë prej rreth 5%, ku gjithsej kërkesa për energji elektrike në nivel të vendit ishte 6,944 GWh (përfshirë edhe humbjet në transmetim dhe shpërndarje). Pjesa më e madhe e kësaj kërkesë mbulohet nga prodhimi vendor, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga importet e energjisë elektrike.

Tabela më poshtë paraqet balancimin e sistemit, prej nga shihet se vendi ynë në vitin 2025 vazhdon të jetë neto importues.

Tab. 6.1 Balancimi i sistemit elektroenergjetik 2025

| | Balancimi i sistemit elektroenergjetik 2025 | GWh | % |
|----|---|--------|--------|
| 1 | Prodhimi nga gjeneratorët në transmetim | 5,140 | 74% |
| 2 | Prodhimi nga gjeneratorët në shpërndarje | 158 | 2% |
| 3 | Importi | 1,965 | 28.29% |
| 4 | Gjithsej energjia në disponim | 7,263 | 105% |
| 5 | Eksporti | 377 | 5% |
| 6 | Net import/eksport | -1,588 | |
| 7 | Devijimet e sistemit (marrje nga sistemi) | 2 | 0% |
| 8 | Transiti | 2,370 | 34% |
| 9 | Kërkesa nacionale | 6,944 | |
| 10 | Humbjet në transmetim | 135 | 2% |
| 11 | Konsumi i konsumatorëve në rrjetin e transmetimit | 92 | 1% |
| 12 | Konsumi LLOMAG | 105 | 2% |
| 13 | Ngarkimi në rrjetin e shpërndarjes | 6,612 | |
| 14 | Humbjet në shpërndarje | 995 | 15.1% |
| 15 | Neto konsumi në shpërndarje | 5,617 | 84.9% |

Prodhimi nga gjeneratorët që dërgojnë energjinë elektrike në transmetim ka pasur ulje për 13.2% krahasuar me vitin 2024. Importi me kontrata në vitin 2025 ka pasur rritje për afro 40.43% krahasuar me vitin paraprak kurse eksporti ka pasur rënie për afro 48%. Kërkesa nacionale në vitin 2025 ka qenë 6,944 GWh që paraqet një rritje për afro 5.04% ndaj vitit 2024 (6,611 GWh), kurse kërkesa në rrjetin e shpërndarjes ka qenë 6,612GWh që paraqet një rritje për afro 5.66% ndaj vitit 2024 (6,258 GWh).

KOSTT vazhdon të operoj si zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri, ku balancimi i sistemit është përgjegjësi e plotë e KOSTT, që nënkupton edhe mbulimin e të gjitha devijimeve të sistemit përgjegjës në lidhje me operimin e sigurt të sistemit interkonektiv, si dhe alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongestionëve që nënkupton mbledhjen e të hyrave nga tregtimet ndërkufitare, përveç alokimit të kapaciteteve ndërkufitare me Serbinë.

Në figurën më poshtë është paraqitur rrjedha e energjisë elektrike nga gjenerimi, transmetimi deri te shpërndarja te konsumatorët, si dhe rrjedhat e energjisë elektrike drejt rrjeteve rajonale dhe nga rrjetet rajonale përfshirë transitin.




Fig. 6.2 Rrjedhat e energjisë elektrike në sistem në vitin 2025

6.1.2 Adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit

Gjenerimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën maksimale në sistemin elektroenergetik të Kosovës. Kjo mungesë e energjisë për të plotësuar kërkesën nacionale mbulohet me importe të energjisë elektrike.

Kapaciteti i përgjithshëm operativ i gjeneratorëve në Kosovë është 1,248.63 MW, derisa ngarkesa maksimale gjatë këtij viti ka qenë 1,624 MW, andaj raporti i adekuacisë së gjenerimit ndaj ngarkesës maksimale është 76.88 %.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur në baza mujor ngarkesat maksimale dhe minimale gjatë vitit 2025.

Tab. 6.2 Ngarkesat maksimale dhe minimale në vitin 2025

| Ngarkesa 2025 | Jan | Shk | Mar | Pri | Maj | Qer | Korr | Gush | Shta | Tet | Nën | Dhje |
|---------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h | MWh/h |
| Maksimale | 1,435 | 1,474 | 1,192 | 1,121 | 855 | 779 | 948 | 939 | 822 | 1,054 | 1,171 | 1,624 |
| Minimale | 630 | 635 | 381 | 341 | 322 | 317 | 361 | 361 | 340 | 394 | 460 | 593 |

Derisa sistemi i gjenerimit ka mungesa lidhur me adekuacinë, sistemi i transmetimit përmban rezerva të mjaftueshme për të mundësuar rrjedha të energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës vendore, përfshirë edhe mbulimin e ngarkesës maksimale (pikut), si dhe për të mundësuar transit nëpër linjat interkonektive.

Tabela më poshtë tregon ngarkesat maksimale dhe minimale (P_{max} dhe P_{min}) të sistemit elektroenergetik të Kosovës ndër vite, kohën e ndodhjes së tyre, prodhimin, si dhe importin dhe eksportin përkatës të energjisë elektrike.

Tab. 6.3 Ngarkesat maksimale dhe minimale të sistemit elektroenergetik

| Viti | Ngarkesa maksimale | | | | | | | Ngarkesa minimale | | | | | | |
|------|--------------------|-------|-------|----------|---------|----------|-----------|-------------------|-------|-------|----------|---------|----------|-----------|
| | Pmax | | | Prodhimi | Importi | Eksporti | Devijimi* | Pmin | | | Prodhimi | Importi | Eksporti | Devijimi* |
| | [MW] | Data | Ora | [MW] | [MW] | [MW] | [MW] | [MW] | Data | Ora | [MW] | [MW] | [MW] | [MW] |
| 2015 | 1,129 | 31.12 | 20:00 | 825 | 308 | 0 | -4 | 272 | 30.08 | 04:00 | 250 | 0 | 50 | -72 |
| 2016 | 1,160 | 31.12 | 18:00 | 797 | 321 | 0 | 42 | 246 | 12.06 | 06:00 | 711 | 0 | 310 | 155 |
| 2017 | 1,161 | 11.01 | 20:00 | 660 | 415 | 0 | 86 | 286 | 3.06 | 06:00 | 733 | 50 | 440 | 57 |
| 2018 | 1,203 | 31.12 | 18:00 | 787 | 271 | 0 | 145 | 265 | 27.06 | 06:00 | 577 | 5 | 430 | -113 |
| 2019 | 1,253 | 31.12 | 18:00 | 861 | 348 | 16 | 60 | 289 | 7.06 | 06:00 | 435 | 15 | 140 | 21 |
| 2020 | 1,251 | 21.12 | 11:00 | 819 | 350 | 32 | 114 | 288 | 9.08 | 04:00 | 548 | 12 | 280 | -8 |
| 2021 | 1,398 | 21.12 | 23:00 | 819 | 360 | 147 | 366 | 310 | 5.08 | 20:00 | 416 | 600 | 374 | 332 |
| 2022 | 1,429 | 24.01 | 23:00 | 946 | 629 | 267 | 121 | 294 | 29.05 | 06:00 | 561 | 401 | 654 | 14 |
| 2023 | 1,413 | 8.02 | 23:00 | 863 | 641 | 163 | 47 | 311 | 11.06 | 06:00 | 514 | 308 | 521 | 4 |
| 2024 | 1,472 | 26.12 | 23:00 | 707 | 706 | 191 | -120 | 317 | 26.05 | 06:00 | 795 | 176 | 633 | -1 |
| 2025 | 1,624 | 31.12 | 18:00 | 908 | 685 | 136 | -78 | 317 | 7.06 | 06:00 | 482 | 307 | 409 | 39 |

* Devijimi i sistemit ndaj sistemit interkonektiv

Siç është cekur më herët, energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes fillimisht sigurohen në mënyrë proporcionale nga energjia e mbetur nga KEK pas alokimit të energjisë për shërbimin universal, kurse pjesa tjetër e energjisë për mbulimin e humbjeve sigurohet nga importi, në një treg.

6.2 Burimet primare të energjisë

Viteve të fundit ka një ngritje të kapaciteteve prodhuese nga BRE si: energjia e ujit, energjia e erës, energjia diellore, por në Kosovë ende vazhdon të dominoj energjia e prodhuar nga linjiti si burim primar i energjisë, që në një rën anë mundëson një siguri të prodhimit të energjisë elektrike afatgjate, mirëpo mbetet si problem ndikimi në mjedis për shkak të emetimit të gazrave serrë dhe ndotësve tjerë.

6.2.1 Prodhimi dhe konsumi i linjtit

Prodhimi i linjtit në vitin 2025 ka qenë 6.91 mil. ton, ndërsa konsumi 7.34 mil. ton, sasi këto që janë më të ulëta në krahasim me vitin 2024.

Prodhimi dhe konsumi i linjtit sipas muajve, për vitin 2025 është paraqitur në tabelën 6.4.

Tab. 6.4 Prodhimi dhe konsumi i linjtit në vitin 2025

| Prodhimi/konsumi i linjtit | Totali | Jan | Shku | Mars | Priill | Maj | Qer | Korr | Gush | Shta | Tet | Nën | Dhje |
|------------------------------------|--------|-----|------|------|--------|-----|-----|------|------|------|-----|-----|------|
| Prodhimi i linjtit (t*1000) | 6,908 | 778 | 658 | 685 | 541 | 480 | 415 | 380 | 496 | 516 | 616 | 663 | 679 |
| Konsumi i linjtit (t*1000) | 7,341 | 820 | 720 | 724 | 437 | 447 | 414 | 532 | 491 | 532 | 689 | 716 | 818 |
| Konsumi i linjtit në treg (t*1000) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Në figurën e mëposhtme mund të shihet prodhimi dhe konsumi i linjit gjatë viteve 2015 – 2025.




Fig. 6.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitet 2015 – 2025

6.3 Prodhimi i energjisë elektrike

6.3.1 Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike

Kapaciteti total operativ i gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë është 1,248.6 MW, prej të cilit 960 MW apo 76.88% janë nga termocentralet dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale dhe burimet të ripërtitshme të energjisë (hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike).

Kapaciteti i njësive gjeneruese është paraqitur në tabelën e mëposhtme sipas llojit të burimit primar, kapacitetit instalues dhe operativ, kufijtë minimal dhe maksimal të prodhimit si dhe vitit të futjes në operim.

Tab. 6.5 Kapacitetet gjeneruese në sistemin elektroenergetik të Kosovës

| Njësitë prodhuese | Kapaciteti i njësjëve (MW) | | Min/max | Futja në operim |
|--|----------------------------|------------|---------|-----------------|
| | Instaluar | Neto | | |
| TC Kosova A1 | 65 | Nuk operon | | 1962 |
| TC Kosova A2 | 125 | Nuk operon | | 1964 |
| TC Kosova A3 | 200 | 144 | 100-130 | 1970 |
| TC Kosova A4 | 200 | 144 | 100-130 | 1974 |
| TC Kosova A5 | 210 | 144 | 100-135 | 1975 |
| TC Kosova A | 610 | 432 | | |
| TC Kosova B1 | 339 | 264 | 180-260 | 1983 |
| TC Kosova B2 | 339 | 264 | 180-260 | 1984 |
| TC Kosova B | 678 | 528 | | |
| HC Ujmani | 35.00 | 32.00 | | 1981 |
| HC Lumbardhi I | 8.08 | 8.00 | | (1957) 2006 |
| HC Dikanci | 4.02 | 3.34 | | (1957) 2013 |
| HC Radavci | 1.00 | 0.90 | | (1934) 2010 |
| HC Burimi | 0.95 | 0.85 | | (1948) 2011 |
| Lumbardhi II | 6.20 | 6.20 | | 2020 |
| Gjithsej HC (jasht skemës mbështetëse) | 55.25 | 51.29 | | |
| EGU Belaja | 8.06 | 8.06 | | 2016 |
| EGU Deçani | 9.81 | 9.81 | | 2016 |
| HC Hidroline-Albaniku III | 4.27 | 4.27 | | 2016 |
| HC Brod II | 4.80 | 4.80 | | 2015 |
| HC Restelica 1&2 | 2.28 | 2.28 | | 2016 |
| HC Brodi III | 4.70 | 4.70 | | 2016 |
| HC Brezovica | 2.10 | 2.10 | | 2017 |
| HC Orqusha | 4.00 | 4.00 | | 2021 |
| HC Lepenci 3 | 10.00 | 10.00 | | 2019 |
| HC Dilli com | 0.31 | 0.31 | | 2020 |
| HC Hidroline-Albaniku II | 3.55 | 3.55 | | 2020 |
| HC ECO Energji | 1.00 | 1.00 | | 2020 |
| HC Hidroline-Albaniku IV | 1.12 | 1.12 | | 2021 |
| HC Restelica 3 | 2.35 | 2.35 | | 2021 |
| HC Brod I | 2.48 | 2.48 | | 2021 |
| HC Sharri | 6.45 | 6.45 | | 2021 |
| HC Vica | 4.60 | 4.60 | | 2021 |
| HC Shterpca | 5.30 | 5.30 | | 2021 |
| Wind Power | 1.35 | 1.35 | | 2010 |
| Air Energy-Kitka | 32.40 | 32.40 | | 2018 |
| SOWI Kosova | 103.41 | 103.41 | | 2021 |
| PV LedLight Technology | 0.10 | 0.10 | | 2015 |
| PV ONIX SPA | 0.50 | 0.50 | | 2016 |
| PV Birra Peja | 3.00 | 3.00 | | 2018 |
| PV Frigo Food Kosova | 3.00 | 3.00 | | 2018 |
| PV Eling | 0.40 | 0.40 | | 2019 |
| PV SGE | 3.00 | 3.00 | | 2019 |
| PV Proenergy | 3.00 | 3.00 | | 2023 |
| PV Eling | 1.00 | 1.00 | | 2024 |
| PV Energy Development-Kosova L.L.C | 6.00 | 6.00 | | 2025 |
| PV Elektroheta SH.P.K. | 3.00 | 3.00 | | 2025 |
| Eko Park Group SH.P.K. | 6.00 | 6.00 | | 2025 |
| Vita Energy SH.P.K. | 3.00 | 3.00 | | 2025 |
| VBS SH.P.K. | 3.00 | 3.00 | | 2025 |
| LURN SH.P.K. | 0.48 | 0.48 | | 2025 |
| Gjithsej BRE (në skemën mbështetëse) | 249.82 | 249.82 | | |
| Gjithsej | 1,593.07 | 1,261.12 | | |

6.3.2 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2025 ka qenë 5,298 GWh, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 6,059 GWh, që do të thotë se ka një ulje prej 12.6 %. Ndërsa, krahasuar me bilancin e energjisë elektrike për vitin 2025 prodhimi është realizuar rreth 95.5 %.

Tabela më poshtë paraqet prodhimin nacional si dhe shpenzimet vetanake sipas njësive dhe muajve gjatë vitit 2025.

Tab. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2025

| Prodhuesit GWh | Gjithsej | Jan | Shku | Mar | Pri | Maj | Qer | Korr | Gush | Shta | Tet | Nën | Dhje |
|------------------|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| TC A3 bruto | 617.2 | 93.5 | 12.6 | 78.3 | 0.0 | 56.8 | 59.4 | 60.0 | 52.7 | 50.0 | 91.6 | 0.0 | 62.3 |
| TC A4 bruto | 661.3 | 32.4 | 76.6 | 94.4 | 75.0 | 26.9 | 0.0 | 27.7 | 59.5 | 53.6 | 52.8 | 68.0 | 94.4 |
| TC A5 bruto | 760.5 | 65.4 | 91.3 | 16.6 | 65.3 | 39.9 | 77.6 | 96.5 | 56.1 | 70.4 | 27.7 | 91.2 | 62.4 |
| TC A Shpenzvet | 265.1 | 25.1 | 22.3 | 23.0 | 18.3 | 16.9 | 18.8 | 24.2 | 22.5 | 22.7 | 22.3 | 21.2 | 27.8 |
| TC A prag | 1,773.8 | 166.1 | 158.2 | 166.3 | 122.0 | 106.7 | 118.1 | 160.0 | 145.9 | 151.3 | 149.8 | 138.1 | 191.3 |
| TC B1 bruto | 1,978.4 | 200.1 | 157.6 | 142.2 | 36.8 | 203.3 | 175.6 | 197.7 | 184.4 | 195.4 | 140.2 | 176.4 | 168.9 |
| TC B2 bruto | 1,266.4 | 183.8 | 165.1 | 180.6 | 144.7 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 6.6 | 191.6 | 189.7 | 204.3 |
| TC B Shpenzvet | 332.0 | 38.9 | 33.4 | 33.1 | 20.8 | 19.8 | 18.2 | 19.5 | 18.6 | 22.7 | 34.2 | 36.0 | 36.9 |
| TC B prag | 2,912.7 | 345.1 | 289.2 | 289.7 | 160.7 | 183.5 | 157.4 | 178.1 | 165.7 | 179.4 | 297.7 | 330.0 | 336.2 |
| Ujmani | 69.9 | 4.2 | 3.8 | 3.7 | 14.7 | 6.4 | 5.0 | 4.5 | 3.6 | 2.6 | 2.6 | 3.0 | 15.9 |
| Lumbardhi | 38.7 | 2.5 | 1.3 | 5.9 | 9.4 | 7.6 | 2.1 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.4 | 5.3 | 4.1 |
| Kitka | 92.7 | 9.5 | 5.2 | 10.2 | 7.9 | 9.1 | 5.9 | 7.2 | 6.7 | 5.1 | 9.7 | 8.6 | 7.4 |
| Sowi | 251.8 | 31.7 | 10.1 | 25.8 | 23.9 | 25.4 | 10.6 | 16.5 | 17.7 | 12.6 | 29.0 | 26.0 | 22.5 |
| BRE Distr. | 158.4 | 14.5 | 8.9 | 19.9 | 29.0 | 20.7 | 10.4 | 5.0 | 4.0 | 3.0 | 7.8 | 18.9 | 16.3 |
| Gjithsej | 5,298.0 | 573.7 | 476.6 | 521.5 | 367.7 | 359.4 | 309.5 | 371.4 | 343.6 | 353.9 | 497.0 | 530.0 | 593.9 |
| Bilanci 2025 | 5,545.8 | 586.4 | 485.7 | 530.1 | 376.3 | 367.9 | 322.8 | 407.2 | 386.8 | 420.8 | 480.8 | 575.8 | 605.2 |
| Raporti tot./bil | 95.5% | 97.8% | 98.1% | 98.4% | 97.7% | 97.7% | 95.9% | 91.2% | 88.8% | 84.1% | 103.4% | 92.0% | 98.1% |

Prodhimi bruto i termocentraleve në vitin 2025 ka qenë 5,283.7 MWh dhe krahasuar me vitin 2024 6,178 MWh ka qenë më i ulët për rreth 14.5%, prej të cilit 597 MWh apo 11.3% është konsumuar nga vet termocentralet si shpenzim vetanak. Një pjesë e këtyre shpenzimeve vetanake (për të dy gjeneratorët TC Kosova A dhe TC Kosova B) realizohet drejtpërsëdrejti nga impiantet e brendshme, ndërsa pjesa tjetër futet në sistemin e transmetimit dhe pastaj konsumohet nga termocentralet.

Figura e mëposhtme paraqet pjesëmarrjen e gjeneratorëve në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në vitin 2025.




Fig. 6.4 Prodhimi i njësive gjeneruese në vitin 2025

Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2025 ka qenë 453.1 GWh dhe është më i lartë për 3.6 % krahasuar me vitin 2024 (437.5 GWh). Kurse, prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes ka qenë 158.4 GWh, dhe është për 12.34 % më i lartë krahasuar me vitin 2024 (141 GWh).

Tabelat e mëposhtme paraqesin prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të të kyçura në rrjetin e transmetimit, përkatësisht në rrjetin e shpërndarjes.

Tab. 6.7 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2025

| BRE në transmetim | Kapaciteti instalues MW | Prodhimi MWh | Pjesëmarrja në prodhim* % |
|---------------------|----------------------------|-----------------|------------------------------|
| HC Ujmani | 35.00 | 69,906 | 15.43 |
| HC Kaskada Lumbardh | 32.15 | 38,734 | 8.55 |
| Air Energy/Kitka | 32.40 | 92,652 | 20.45 |
| PEE Selaci | 103.41 | 251,807 | 55.57 |
| Gjithsej BRE | 202.96 | 453,099 | 100% |

* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në transmetim

Tab. 6.8 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2025

| BRE Distribucion | Kapaciteti instalues MWh | Prodhimi MWh | Pjesëmarrja në prodhim* % |
|-----------------------|-----------------------------|-----------------|------------------------------|
| Hydrocentrale | 65.28 | 136,792 | 86.4 |
| Biomasë | 1.14 | 1,672 | 1.1 |
| Centrale fotovoltaike | 23.00 | 19,892 | 12.6 |
| Gjithsej | 89.42 | 158,356 | 100 |

* Pjesëmarrja e njësive gjeneruese ndaj prodhimit të BRE në shpërndarje

Operimi i njësive gjeneruese

Krahasuar me vitin e kaluar numri i rënieve nga operimi i njësive gjeneruese me linjit ka qenë pak më i lartë, që dëshmon se besueshmëria dhe qëndrueshmëria e termocentraleve po bie nga viti në vit. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha llojet dhe shpeshtësia e ndaljeve dhe disponueshmëria në orë pune e termocentraleve për vitin 2025, ku vërehet se disponueshmëria e njësive gjeneruese të TC Kosova B2 ka qenë e mirë.

Tab. 6.9 Ndalesat e njësive gjeneruese 2025

| 2025 | TC Kosova A | | | TC Kosova B | |
|---------------------------|-------------|-------|-------|-------------|-------|
| | A3 | A4 | A5 | B1 | B2 |
| Ndalesat e planifikuara | 4 | 5 | 2 | 2 | 1 |
| Ndalesat e paplanifikuara | 4 | 2 | 4 | 10 | 8 |
| Rëniet | 4 | 0 | 1 | 5 | 5 |
| Gjithsej ndalesa | 12 | 7 | 7 | 17 | 14 |
| Orë pune | 5,617 | 5,209 | 5,411 | 7,413 | 4,868 |

Orët e operimit të njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B në formë grafike janë paraqitur në figurën e mëposhtme, me variacione sipas njësive, ku vërehet se njësia B1 ka operuar me mbi 80 % të orëve të vitit respektivisht 84.6% përderisa njësitë A3, A4 dhe A5 dhe B2 kanë operuar respektivisht 64.1%, 59.5%, 61.8% dhe 55.6% në vit.




Fig. 6.5 Operimi i njësive gjeneruese në vitin 2025

Figura e mëposhtme paraqet prodhimin e njësive gjeneruese për periudhën 2015 – 2025.




Fig. 6.6 Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2015 – 2025

6.4 Sistemi i transmetimit

Transmetimi si aktivitet i rregulluar i energjisë është përgjegjës për funksionimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe linjave të transmetimit dhe balancimin e sistemit, si dhe për të siguruar aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përmbushur kërkesat që nevojiten për transmetimin e energjisë elektrike.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës është mjaft i zhvilluar dhe ofron siguri të mjaftueshme të sistemit dhe është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe Evropian përmes linjave interkonektive me:

- Shqipërinë, Maqedoninë Veriore, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1 për të gjithë nivelit e tensionit të lartë.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit:

Tab. 6.10 Nënstacionet në rrjetin e transmetimit

| Transformimi (kV/kV) | Pronari | Nr. i NS | Nr. i TR | Fuqia (MVA) |
|-------------------------|-----------|----------|----------|-------------|
| 400/220 | KOSTT | 1 | 3 | 1200 |
| 400/110 | KOSTT | 2 | 4 | 1200 |
| 220/110 | KOSTT | 3 | 9 | 1350 |
| 220/35 | Feronikel | 1 | 2 | 320 |
| 220/35/10(20) (Besiana) | KOSTT | 1 | 1 | 40 |
| 220/10(20) (Besiana) | KOSTT | - | 1 | 40 |
| 220/10(20) | KOSTT | 1 | 2 | 80 |
| 110/35/10(20) | KOSTT | 7 | 8 | 357.5 |
| 110/35/6.3 | Trepça | 1 | 2 | 63 |
| 110/6.3 | Trepça | - | 1 | 40 |
| 110/35 | Ujmani | 1 | 1 | 20 |
| 110/6.3 | Sharri | 1 | 2 | 40 |
| 110/10(20) | KOSTT | 14 | 26 | 949.5 |
| 110/35 | KOSTT | 11 | 19 | 641 |
| 110/10 | KOSTT | 6 | 8 | 252 |
| 35/110 (Deçan) | Kelkos | - | 1 | 40 |
| Gjithsej | | 50 | 90 | 6,633 |

Tab. 6.11 Linjat në rrjetin e transmetimit

| Tensioni (kV) | Pronari | Gjatësia (km) |
|---------------|---------|---------------|
| 400 | KOSTT | 279.5 |
| 220 | KOSTT | 238.5 |
| 110 | KOSTT | 918.5 |
| Gjithsej | | 1,436.5 |

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë instaluese transformuese, gjatësinë e linjave, si dhe centralet e kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.7 Të dhënat bazë të rrjetit të transmetimit

6.4.1 Rrjedhat e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Sistemi i transmetimit në Kosovë është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe Evropian përmes linjave interkonektive me vendet fqinje dhe ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar rrjedhat e energjisë në sistem, për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve nga prodhimi vendor dhe importi por edhe për eksportet eventuale të tepricave të energjisë elektrike, e po ashtu edhe për energjinë e cila kalon si transit nga vendet tjera.

Duhet theksuar se transiti i energjisë elektrike ngarkon rrjetin duke shtuar humbjet, amortizimin e rrjetit, si dhe nevojën për mirëmbajtje të rrjetit të transmetimit, për të cilat operatori kompensohet përmes Mekanizmit ITC. Transiti i energjisë elektrike rrjetin e Kosovës në vitin 2025 ka qenë 2,370 GWh apo rreth 28.01 % krahasuar me kërkesën apo 25.33% ndaj gjithsej hyrjes në rrjetin e transmetimit.

Figura e mëposhtme paraqet rrjedhat e energjisë nëpër të gjitha linjat ndërlidhëse (interkonektive) në të dyja drejtimet (hyrje, dalje).




Fig. 6.8 Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse (interkonektive)

6.4.2 Investimet në sistemin e transmetimit

Gjatë vitit 2025 në rrjetin e transmetimit janë bërë investime, ku projektet investive janë paraqitur në kategoritë si më poshtë:

Projektet që kanë përfunduar në vitin 2023 dhe janë nën afat garantues njëvjeçar

Gjatë vitit 2023, projekti ka përfunduar teknikisht dhe financiarisht dhe në vitin 2025 ka përfunduar edhe afati garantues njëvjeçar dhe asetet kanë kaluar në Sistemin e Transmetimit:

Projekti në Kastriot që përfshinë:

- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 (Kastrioti) me transformator 40MVA, edhe gjatë vitit 2025 ka mbetur me status të njëjtë, dhe ka mbetur për t'u realizuar testimi i telembrojtjes, e cila është e ndërlidhur me instalimin e OPGW nga LOT-i ndërlidhës.

Projektet e financuara nga KOSTT, ku kontrata është nënshkruar gjatë vitit 2021/2022 dhe janë në fazën e implementimit

- Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti – Gjatë vitit 2025, pas zgjidhjes së të gjitha kontesteve gjyqësore dhe çështjeve pronëso- juridike, projekti “Ndërtimi i linjës/kabllos 110 kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 (Kastrioti)” është përfunduar me sukses.
- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova, Projekti është realizuar sipas kontratës me kohë dhe buxhet. Projekti tashmë ndodhet në fazën e garancionit dhe ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të rrjetit, përmirësimin e sigurisë operative dhe rritjen e besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike për zonën e Fushë Kosovës dhe zonat përreth.

Projektet e financuara nga KOSTT dhe të tenderuar gjatë vitit 2024

- Furnizimi dhe instalimi i Transformatorit të fuqisë 40MVA për NS Fushë Kosova – Projekti është përfunduar me sukses dhe aktualisht ndodhet në periudhën garantuese. Transformatori i fuqisë 40 MVA është instaluar, testuar dhe komisionuar sipas kërkesave teknike.
- Përgatitja e dokumentacionit ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20) kV Malisheva – Gjatë vitit 2025 janë përfunduar dhe dorëzuar të gjitha dizajnet dhe dokumentacioni teknik i projektit, janë realizuar të gjitha pagesat kontraktuale, duke e përmbyllur administrativisht projektin dhe projekti është tenderuar me sukses për fazën e implementimit.

Disa prej projekteve të parapara për të filluar implementimin

- Ndërtimi i Nënstationit të ri 220/35/20kV Malishevë me Transformatorë 40MVA dhe Linjë transmissioni 220kV - Është nënshkruar kontrata me Grupin e Operatorëve Ekonomik për implementimin e projektit, janë kryer pagesat e avansit në përputhje me kontratën, ndërsa nga ana e GOE janë dorëzuar sigurimet e nevojshme dhe të kërkuara sipas kontratës.

Projektet e fazës së VI dhe VII – Financim nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW të realizimit të projekteve.

Sipas planit investiv, ky grup i projekteve është planifikuar të financohet përmes huamarrjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, KfW (Kreditanstalt für Wiederaufbau) dhe KOSTT, në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Në kuadër të realizimit të projekteve të Fazës VII është përzgjedhur kompania për shërbime konsulente, e cila është angazhuar për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të tenderit për projektet e parapara sipas Planit Tarifor Investiv 2023–2027, të aprovuar nga ZRrE.

Projektet e planifikuara janë si më poshtë:

Tender 1: Furnizimi dhe instalimi me transformatorë të fuqisë 40MVA;

a. LOT 1: Furnizimi dhe ndërtimi

- “Ndërtimi i NS 110/10(20) kV-Dragashi” me transformatorë 1x40MVA;
- Shunt Reaktor 100 MVar në NS Ferizaj 2;
- Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për adaptimin e SCADA (RTU & SCS);
- Ndërrimi i sistemit ekzistues SCADA/EMS për Qendrën Nacionale Dispeqerike dhe Qendrën Emergjente Dispeqerike; dhe
- Migrimi dhe avansimi i sistemit të telekomit;

b. Furnizimi dhe instalimi me transformatorë të fuqisë 40MVA;

- Furnizimi me transformator të fuqisë 110/10(20) kV në NS. Fushë Kosova;
- Furnizimi me transformator të fuqisë në NS 110/10(20) kV në NS. Ferizaj 3- Kastrioti;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS. Gjakova 1, 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS. Prishtina 5, 110/10(20) kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Prizren 1, 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Peja 1, 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Ferizaj 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Deçan, 110/10(20) kV;

c. Linjat transmetuese:

- Linja e dyfishtë ajrore 110kV NS. Dragash - Zhur (fundi i linjës së dyfishtë), vetëm me një përçues;
- Linja e re e njëfishtë ajrore Zhur – NS Prizren 2;
- Linja e re ajrore 110kV NS Dragash – NS Kukës (kufi me Shqipërinë);
- Linja e re e njëfishtë kabllore 110 kV NS Prishtina 4 - NS Prishtina 2, me gjatësi totale përafërsisht 5 km, 1000mm²;

Projekti i Baterive përkrahur nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit - Millenium Challenge Corporation (MCC)

Viti 2025 karakterizohet edhe me vazhdimësinë e punës në grupin punues qeveritar në procesin e zhvillimit të programit të marrëveshjes së financimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes fondacionit të MCC, për projektin e instalimit të baterive. Projekti ka qenë përkohësisht i pezulluar nga Administrata e Presidentit Trump, por pas rishqyrtimit në fund të muajit korrik 2025 është vendosur që të vazhdohet me projektin e instalimit të baterive me kapacitet prej 170 MW në Kosovë, e poashtu edhe për pjesën prej 45 MW i cili do të shfrytëzohet për rregullim sekondar nga KOSTT.

6.4.3 Ngarkesat maksimale dhe kërkesa për energji në sistemin elektroenergetik

Për të analizuar funksionimin e sistemit elektroenergetik, ndër të tjera rëndësi ka edhe vlera e ngarkesave maksimale (pikut) e për këtë merren zakonisht pesë (5) ngarkesat maksimale të realizuara në orë dhe ditë të ndryshme të vitit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) për vitin 2025.

Tab. 6.12 Vlerat e ngarkesave maksimale (pikut) në vitin 20254

| Ngarkesa maksimale Pmax (MW) | Data | Ora |
|------------------------------|------------|-----|
| 1,624 | 31.12.2025 | 18 |
| 1,582 | 30.12.2025 | 24 |
| 1,547 | 29.12.2024 | 23 |
| 1,458 | 19.02.2025 | 23 |
| 1,435 | 19.01.2025 | 23 |

Ngarkesa maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës është regjistruar me 31 dhjetor 2025 në orën 18:00 në vlerë 1,624 MW, që është më e lartë se ngarkesa maksimale në vitin 2024 ku ka qenë 1,472 MW. Ngarkesa minimale është regjistruar më 07 qershor 2025 në ora 06:00 në vlerë 317 MW.

Siç është cekur edhe më lartë, për shkak të jofleksibilitetit të sistemi energjetik, e sidomos jofleksibilitetit në termocentralet ekzistuese, ndodhë që në të njëjtën ditë, madje edhe në të njëjtën orë të kemi importe dhe eksporte të energjisë elektrike. Andaj, në përgjithësi brenda të njëjtës ditë, në orët e ditës (tarifa e lartë) prodhimi nuk e mbulon kërkesën dhe nevojitet të importohet energji elektrike, ndërsa gjatë natës (tarifa e ulët) ka teprica të energjisë elektrike të cilat duhet të eksportohen.

Dallimi në mes të mesatares mujore të maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë muajve të vitit 2025 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.




Fig. 6.9 Mesatarja mujore e kërkesës dhe ngarkesat maksimale/minimale ditore 2025

Reduktimet si pasojë e mungesës së energjisë elektrike

Bazuar në raportet e operatorëve, gjatë vitit 2025 reduktimet e energjisë elektrike si pasojë e mungesës së energjisë kanë qenë në total kanë qenë në sasi prej 6,759 MWh, kryesisht të shprehura në janar dhe dhjetor.

Siç mund të vërehet nga diagrami më poshtë, me gjithë përpjekjet për eliminimin e reduktimit të furnizimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike, gjatë viteve janë realizuar reduktime, të cilat janë zvogëluar dukshëm dhe në disa vite janë eliminuar plotësisht.

Figura më poshtë paraqet reduktimet për mungesë të energjisë elektrike ndër vite.




Fig. 6.10 Reduktimet e konsumit gjatë viteve 2015 - 2025

6.4.4 Kërkesa për energji elektrike dhe humbjet në rrjetin e transmetimit

Kërkesa e përgjithshme nacionale e energjisë elektrike në vitin 2025 ka qenë 6,944 GWh dhe paraqet një ngritje prej 5.03 % krahasuar me vitin 2024, kur ka qenë 6,610 GWh, kurse krahasuar me parashikimin në bilancin elektroenergjetik 2025 kërkesa është për 1.38 % më i ulët.

Në tabelën 6.13 është paraqitur kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në transmetim të realizuara në vitin 2025 dhe të krahasuara me bilancin elektroenergjetik 2025.

Tab. 6.13 Kërkesa e përgjithshme dhe humbjet në rrjetin e transmetimit në vitin 2025

| 2025 | Kërkesa bruto realizim | Kërkesa bruto bilanci | Raporti Realiz./Bilanc | Humbjet në transmetim realizimi | | Humbjet në transmetim bilanci | |
|-----------------|------------------------|-----------------------|------------------------|---------------------------------|-------------|-------------------------------|-------------|
| | MWh | MWh | % | MWh | % | MWh | % |
| Janar | 828,550 | 841,153 | 98.50 | 16,854 | 2.03 | 16,854 | 2.00 |
| Shkurt | 723,653 | 732,821 | 98.75 | 14,421 | 1.99 | 14,419 | 1.97 |
| Mars | 619,617 | 628,324 | 98.61 | 11,342 | 1.83 | 11,343 | 1.81 |
| Prill | 532,916 | 541,517 | 98.41 | 9,116 | 1.71 | 9,115 | 1.68 |
| Maj | 452,060 | 460,575 | 98.15 | 7,729 | 1.71 | 7,727 | 1.68 |
| Qershor | 407,835 | 418,860 | 97.37 | 7,322 | 1.80 | 7,322 | 1.75 |
| Korrik | 466,613 | 480,544 | 97.10 | 9,460 | 2.03 | 8,814 | 1.83 |
| Gusht | 462,569 | 472,074 | 97.99 | 9,322 | 2.02 | 8,681 | 1.84 |
| Shtator | 404,213 | 437,191 | 92.46 | 8,199 | 2.03 | 8,491 | 1.94 |
| Tetor | 564,022 | 512,678 | 110.01 | 11,447 | 2.03 | 9,749 | 1.90 |
| Nëntor | 610,547 | 688,177 | 88.72 | 12,077 | 1.98 | 12,308 | 1.79 |
| Dhjetor | 871,187 | 827,398 | 105.29 | 18,094 | 2.08 | 14,171 | 1.71 |
| Gjithsej | 6,943,782 | 7,041,311 | 98.61 | 135,382 | 1.95 | 128,995 | 1.83 |

Siç shihet nga figura e mëposhtme, në vazhdimësi ka stabilizim të kërkesës për energji elektrike, me luhatje të vogla nga viti në vit, dhe në vitin e fundit vërehet një ngritje e vogël që mund të shihet në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.11 Kërkesa e përgjithshme në sistemin elektroenergjetik 2015-2025

Kërkesa e përgjithshme e energjisë elektrike ndahet në konsumin e konsumatorëve të kyçur në rrjetin e transmetimit, konsumin në sistemin e shpërndarjes (përfshirë humbjet), konsumin vetanak për nevojat e stabilimenteve prodhuese, si dhe humbjet e transmetimit, dhe kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme e ndarë sipas kategorive për vitin 2025.

Tab. 6.14 Kërkesa sipas kategorive dhe humbjet e energjisë

| Kërkesa për energji 2024 | Total |
|--|------------------|
| | MWh |
| Konsumi bruto në shpërndarje* | 6,612,183 |
| Konsumatorët në transmetim | 91,635 |
| Konsumi intern i KEK-ut | 104,582 |
| Humbjet në transmetim | 135,382 |
| Kërkesa e përgjithshme | 6,943,782 |
| Shpenzimet vetanake të KEK nga transmetimi | 159,391 |

(*) Energjia elektrike e pranuar në shpërndarje nga transmetimi + prodhimi në shpërndarje

Energjia elektrike që merret nga rrjeti i transmetimit për konsumin vetanak për nevojat e stabilimenteve prodhuese në vitin 2025 ka qenë 159.4 GWh.

Kërkesa për energji elektrike ndryshon sipas periudhës së shpenzimit por edhe sipas kategorive të konsumatorëve, dhe kjo është paraqitur në formë tabelare në vijim ku janë përfshirë edhe humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (humbjet teknike dhe komerciale)

Tab. 6.15 Pjesëmarrja e kategorive të ndryshme në kërkesën e përgjithshme 2025

| Kategoritë (GWh) | Gjithsej | Jan | Shku | Mar | Pri | Maj | Qer | Korr | Gush | Shta | Tet | Nën | Dhje |
|-----------------------------|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| 220 kV (Ferronikeli) | 9.1 | 1.9 | 1.8 | 1.3 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.4 | 0.4 | 0.4 | 0.5 | 0.4 | 0.4 |
| 110 kV (Trepça) | 22.0 | 1.9 | 1.8 | 1.8 | 1.7 | 1.8 | 1.6 | 1.8 | 1.7 | 1.8 | 2.0 | 1.9 | 2.1 |
| 110 kV (Sharrcem) | 60.5 | 4.7 | 3.2 | 3.0 | 2.7 | 6.3 | 5.6 | 5.8 | 5.1 | 6.2 | 6.3 | 5.7 | 5.8 |
| 35 kV | 32.0 | 4.6 | 4.6 | 4.8 | 4.7 | 4.3 | 1.0 | 1.2 | 1.6 | 1.2 | 1.2 | 1.3 | 1.6 |
| 10 kV | 321.8 | 46.6 | 43.8 | 41.3 | 39.3 | 38.1 | 14.4 | 15.3 | 14.7 | 14.0 | 16.3 | 17.4 | 20.6 |
| Amvisnia | 3,393.1 | 448.4 | 339.6 | 322.3 | 271.2 | 206.9 | 192.6 | 212.9 | 227.8 | 180.5 | 267.6 | 290.8 | 432.5 |
| 0.4 kV I | 382.1 | 51.4 | 47.6 | 43.6 | 40.9 | 38.3 | 19.9 | 23.6 | 21.8 | 19.4 | 22.7 | 23.3 | 29.6 |
| 0.4 kV II | 802.2 | 91.8 | 81.2 | 73.5 | 65.1 | 59.1 | 52.6 | 64.0 | 63.6 | 49.9 | 57.8 | 62.3 | 81.3 |
| Ndriqimi publik | 47.2 | 4.4 | 4.1 | 3.9 | 3.4 | 3.2 | 2.9 | 3.3 | 3.4 | 4.0 | 4.7 | 5.0 | 5.0 |
| Korrigjime nga tregu I lire | 9.0 | | | | | | | | 8.3 | 0.5 | 0.1 | 0.1 | 0.0 |
| Konsumi veri | 169.0 | 24.0 | 22.2 | 19.9 | 16.1 | 11.8 | 11.1 | 8.4 | 6.5 | 4.6 | 13.4 | 14.6 | 16.4 |
| Konsumatorët e parregull | 448.0 | | | | | | 56.1 | 68.6 | 57.1 | 58.8 | 64.0 | 65.6 | 77.8 |
| Gjithsej faturuar | 5,696.1 | 679.8 | 549.8 | 515.5 | 445.6 | 370.3 | 358.2 | 405.3 | 412.0 | 341.5 | 456.7 | 488.3 | 673.1 |
| Konsumi KEK | 104.6 | 10.4 | 9.6 | 10.0 | 8.3 | 8.7 | 7.2 | 6.3 | 7.5 | 7.9 | 8.6 | 9.6 | 10.5 |
| Humbjet OSSH | 995.2 | 121.9 | 149.5 | 81.9 | 69.2 | 64.3 | 35.4 | 44.5 | 31.8 | 42.9 | 86.7 | 99.8 | 167.2 |
| Humbjet KOSTT | 135.4 | 16.9 | 14.4 | 11.3 | 9.1 | 7.7 | 7.3 | 9.5 | 9.3 | 8.2 | 11.4 | 12.1 | 18.1 |
| Gjithsej | 6,931.3 | 828.9 | 723.4 | 618.7 | 532.3 | 451.0 | 408.1 | 465.5 | 460.6 | 400.6 | 563.4 | 609.8 | 868.8 |

Kërkesa për energji elektrike, e paraqitur në tabelën 6.15, ndryshon sipas muajve, dhe te disa kategori ky ndryshim është mjaft i theksuar, si p.sh. konsumi familjar dhe humbjet komerciale që janë më të larta në sezonin dimëror, gjë që është kryesisht për shkak të shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Humbjet në sistemin e transmetimit, janë në nivel të pranueshëm falë investimeve të bëra nga KOSTT dhe janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në rrjetet transmetuese në rajon dhe Evropë.

Në figurën më poshtë janë paraqitur humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit ndaj kërkesës përgjithshme të sistemit elektroenergetik të Kosovës.




Fig. 6.12 Humbjet në përqindje në rrjetin e transmetimit 2015-2025

Humbjet e paraqitura në figurën më lartë janë humbjet në përqindje të kalkuluara ndaj kërkesës vendore dhe kanë qenë 1.95%, ndërsa për nivelin e humbjeve në transmetim ndikon e tërë energjia e futur në sistemin e transmetimit. Pra për kalkulimin e përqindjes së humbjeve ndaj ngarkimit të rrjetit të transmetimit duhet që të përfshihen përveç kërkesës vendore edhe rrjedhat tjera siç është transiti si dhe energjia për shpenzimet vetanake të gjeneratorëve, etj. Përqindja e humbjeve në transmetim e llogaritur në këtë formë është 1.41 %.

6.5 Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes, si aktivitet i rregulluar i energjisë, është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe menaxhimin e gjeneratorëve të kyçur në sistemin e shpërndarjes.

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstacionet përkatëse të nivelit 35/x kV, 10(20)/0.4 kV dhe 6/0.4 kV.

Të dhënat bazike të nënstacioneve dhe linjave përfshirë kapacitetin, transformimin dhe gjatësinë e linjave të sistemit të shpërndarjes janë paraqitur në tabelat në vijim.

Tab. 6.16 Nënstacionet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH

| Transformimi (kV/kV) | Pronari | Nr. i NS | Nr. i TR | Fuqia e instaluar (MVA) |
|----------------------|---------|----------|----------|-------------------------|
| 35/10(20) | KEDS | 38 | 87 | 633.00 |
| 35/10(20) | Privat | 11 | 15 | 68.40 |
| 35/20 | KEDS | 3 | 7 | 56.00 |
| 35/6 kV | Privat | 5 | 12 | 43.00 |
| 35/0.4kV | Privat | 19 | 29 | 49.94 |
| 10(20)/0.4 | KEDS | 2,646 | 2,741 | 1,397.82 |
| 10(20)/0.4 | Privat | 3,881 | 3,898 | 2,061.23 |
| 10/20 | KEDS | 2 | 6 | 38.00 |
| 10/0.4 | KEDS | 2,896 | 2,896 | 918.73 |
| 10/0.4 | Privat | 1,247 | 1,253 | 606.00 |
| 6(3)/0.4 | KEDS | 66 | 66 | 12.77 |
| 6/0.4 | Privat | 2 | 2 | 1.25 |
| Gjithsej | | 10,816 | 11,012 | 5,886.14 |

Tab. 6.17 Linjat në OSSH

| Tensioni (kV) | Pronari | Rrjeti ajror (km) | Rrjeti kabllor (km) | Gjithsej (km) |
|---------------|---------|-------------------|---------------------|---------------|
| 35 kV | KEDS | 484 | 140 | 625 |
| 10(20) kV | KEDS | 1,779 | 631 | 2,410 |
| 10 kV | KEDS | 4,165 | 904 | 5,069 |
| 6 kV | KEDS | 42 | 8 | 50 |
| 3 kV | KEDS | 4 | 1 | 5 |
| 0.4 kV | KEDS | 18,351 | 2,809 | 21,160 |
| Gjithsej | | 24,825 | 4,494 | 29,319 |

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë transformuese (MVA), gjatësinë e linjave, si dhe centralet kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 6.13 Të dhënat bazë të sistemit të shpërndarjes

6.5.1 Investimet në sistemin e shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes investon vazhdimisht në rrjetin e shpërndarjes bazuar në buxhetin e ndarë të investimeve të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe në këtë mënyrë rritë funksionimin e sistemit të shpërndarjes për të ofruar furnizim të besueshëm me energji elektrike, si dhe rritje të kapacitetit të rrjetit ekzistues. Investimet përfshijnë projekte në rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët si dhe në projekte në digjitalizimin dhe modernizimin e rrjetit siç janë SCADA, njehsorët e mençur PLC etj.

Projektet janë përzgjedhur duke analizuar nevojën për investime në fushat më kritike duke i vlerësuar ato përmes kriterëve të përparësisë për të arritur objektivat kryesore të investimeve, siç janë:

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe jo teknike,
- Furnizimi i besueshëm dhe më cilësor me energji elektrike,
- Rritja e kapaciteteve ekzistuese të rrjetit dhe modernizimi i rrjetit.

Investimet e bëra përgjatë vitit 2025 nga Departamenti i Investimeve

Konvertimi i daljeve në nivelin e tensionit 20 kV

KEDS ka vazhduar me procesin e implementimit të investimeve në kalimin e daljeve 10 [kV] në operim në nivelin e tensionit 20 [kV]. Me konvertimin e daljeve 10 [kV] në 20 [kV] është përmirësuar kualiteti i tensionit tek të gjithë konsumatorët e këtyre daljeve, është dyfishuar kapaciteti bartës, është realizuar sistemi unazor nga dy burime të ndryshme duke minimizuar kohëzgjatjen e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve teknike.

Tab. 6.18 Konvertimi i daljeve në nivelin e tensionit 20 kV në vitin 2025

| Distrikti | Nënstacioni | Nr. Daljeve |
|--------------|-----------------------------|-------------|
| DFE | Ferizaj II 35/10(20) [kV] | 9 |
| | Ferizaj III 35/10(20) [kV] | 5 |
| DGJ | Gjakova 2 110/10(20) [kV] | 2 |
| | Gjakova I 35/10(20) [kV] | 5 |
| | Malisheva 35/20 [kV] | 9 |
| DPR | Prishtina 2 110/10(20) [kV] | 2 |
| | Prishtina 7 110/10(20) [kV] | 12 |
| DPZ | Theranda 110/10(20) [kV] | 1 |
| Total | | 45 |

Daljet që janë në proces të implemtimit dhe që në vitin 2026 do të konvertohen në 20 [kV] janë

Distrikti Prishtinë – Daljet e reja 1 dhe 3 ndërmjet Prishtina 2 dhe Prishtina 3; daljet e reja 1 dhe 2 ndërmjet Prishtina 3 dhe Prishtina 5; daljet e reja 1 (Përparimi), 2 (Qyteza Pejton) dhe 5 (Fakulteti Filozofik) ndërmjet Prishtina 3 dhe Prishtina 6; daljet e reja 1 dhe 2 (Arbëria) nga Prishtina 3; si dhe daljet e reja 1, 3 dhe 4 nga Prishtina 5.

Daljet për të cilat investimet kanë përfunduar dhe që do të konvertohen në 20 kV gjatë vitit 2026 janë: daljet e reja 3 (Kroi i Bardhë), 4 (Dardania) dhe 6 (Ulpiana) nga Prishtina 6; daljet e reja 1, 2 dhe 3 ndërmjet Prishtina 2 dhe Prishtina 5; daljet e reja 2 dhe 5 nga Prishtina 5 dhe Prishtina 5 – Dega e Butovcit; si dhe dalja e re 2 ndërmjet Prishtina 2 dhe Prishtina 3.

Distrikti Mitrovicë - Daljet e furnizuara nga NS 110/10 [kV] Skenderaj (Qirezi, Likovci, Turiqevci dhe Llausha).

Distrikti Gjakovë - Daljet e furnizuara nga NS 35/10 [kV] Gjakova I (Cermjani, Beci, Ereniku).

Distrikti Ferizaj - Dalja Kosovapetroli.

Distrikti Pejë - Dalja Barani.

Investimet në nivelin 10 [kV]

Distrikti Prishtinë:

Projekti “Bardh i Madh”: Në këtë projekt është implementuar linja e re nëntokësore nga NS Fushë Kosova 35 [kV], në mënyrë që të demolohehet kabli i vjetër me vaj dhe të eliminohen segmentet që paraqesin rrezik për banorët në atë pjesë. Nga ky projekt kanë përfituar 1,798 konsumatorë. Ky projekt ka përfunduar.

Projekti “Lluzhani dhe Fshatrat 2”: Fshatrat 2 është një ndër daljet më problematike, ku përveq ngarkesës së madhe ka dhe degë të gjata dhe të shpërndara. Është planifikuar që një ndër degët më të gjata të daljes Fshatrat 2 ti transferohet daljes Lluzhani me furnizim nga NS Besia. Nga ky projekt do të përfitojnë 3,225 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Projekti “Letanci dhe Fshatrat 1”: Në këtë projekt do të krijohet një dalje e re nga NS Podujeva për të shkarkuar daljet Letanci dhe Fshatrat 1. Nga ky projekt do të përfitojnë 5,296 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Distrikti Pejë

Projekti “Maja e Zezë, Spitali i Pejës”: Në këtë projekt është duke u investuar në ndërtimin e rrjetit me kablo nëntokësore. Nga ky projekt do të përfitojnë 258 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Projekti “Ledinat”: Në daljen Ledinat që furnizohet nga NS Deçani 110/10 [kV] është eliminuar segmenti i vjetëruar me përçues Al/Çe 35 mm². Nga ky projekt kanë përfituar 1,288 konsumatorë dhe projekti ka përfunduar.

Distrikti Ferizaj

Projekti “Bobi”: Nga ky projekt kanë përfituar 850 konsumatorë dhe projekti ka përfunduar. Ky investim përmirëson sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike.

Projekti “Gaçka”: Në këtë projekt është implementuar linja e re nëntokësore nga NS 35/10 [kV] Ferizaji III deri te Stabilimenti Shpërndarës në fshatin Gaçkë. Nga ky projekt kanë përfituar 2,611 konsumatorë dhe projekti ka përfunduar.

Projekti “Varoshi”: Me realizimin e këtij projekti, dalja Varoshi furnizohet nga NS 110/35/10 Bibaj përmes linjës së re nëntokësore, e cila është implementuar në vitin 2025. Nga ky projekt kanë përfituar 1,546 konsumatorë dhe projekti ka përfunduar.

Distrikti Mitrovicë:

Projekti “Maxhunaj, Nadakovci”: Kombinimi i daljeve Nadakovci dhe Maxhunaj do të ndihmojë për të arritur shpërndarje më të ekuilibruar të ngarkesës. Dalja Nadakovci ka përfunduar ndërsa dalja Maxhunaj është ende në proces të implementimit. Nga ky projekt do të përfitojnë 2,806 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Projekti “Qytet e Fshatra”: Nga ky projekt kanë përfituar 3,133 konsumatorë dhe projekti ka përfunduar. Linjat janë zhvendosur pranë rrugëve dhe janë zëvendësuar me linja të reja nëntokësore dhe ajrore, me shtylla betoni dhe me seksion të përshtatshëm të përçuesve, duke përmirësuar kualitetin të furnizimit me energji elektrike.

Distrikti Prizren:

Projekti “Brodi”: Me projektin Brodi është planifikuar të bëhet rikonstruktimi i linjës së daljes Brodi nga NS Dikanca 35/10 [kV], në gjatësi prej 3 [km], deri te fshati Brod. Nga ky projekt do të përfitojnë 665 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Projekti “Restelica”: Në këtë projekt është duke u investuar në linjën kryesore të kësaj dalje. Nga ky projekt do të përfitojnë 3,761 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdojë edhe pas këtij viti.

Distrikti Gjiilan:

Projekti “Begunca”: Në daljen Begunca që furnizohet nga NS 110/35/10 [kV] Vitia është planifikuar të eliminohen segmentet e vjetëruara me shtylla druri dhe me përçues Al/Çe 25 mm². Nga ky projekt do të përfitojnë 1,020 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Projekti “Ropotova”: Është propozuar që të krijohen dy dalje në mënyrë që të rritet siguria e furnizimit dhe të përmirësohen rëniet e tensionit. Nga ky projekt do të përfitojnë 1,851 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Distrikti Gjakovë:

Projekti “Opterusha, Fortesa dhe Bodrumi”: Në gjendjen e propozuar daljet organizohen drejt një topologjie të re në mënyrë që të arrihet një rrjet i zgjerushëm, standard, i thjeshtë dhe i besueshëm. Nga ky projekt do të përfitojnë 2,469 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Projekti “Pataqani”: Është planifikuar të investohet në tërë daljen, për të përmirësuar performancën teknike të kësaj dalje. Nga ky projekt do të përfitojnë 1,341 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Projekti “Brgjani”: Dalja 10 [kV] Brgjani furnizohet nga NS 35/10 [kV] Zveçani i Vogël. Për të shkarkuar dhe të arrihet një balancim i ngarkesës së daljes, është propozuar që dalja 10 [kV] Brgjani të ndahet në dy dalje. Është investuar vetëm në daljen e re që është emërtuar Brgjani 1. Nga ky projekt do të përfitojnë 1,020 konsumatorë dhe implementimi i tij do të vazhdoj edhe pas këtij viti.

Rritja e kapaciteteve ekzistuese - Kjo kategori përfshinë projektet për daljet 10 [kV] të cilat kanë qenë të ngarkuara mbi 100% dhe konsumatorët kanë paguar taksën e kapacitetit për kycje në këto dalje. Daljet 10 [kV] në të cilat është duke u investuar janë: Dalja e re QMI, Shtime, Loxha, Kqiqi, Rashinca dhe Vitia.

Investimet në rrjetin e tensionit të ulët

Në gjithë rrjetin e OSSh-së, ka pjesë të cilat kërkojnë investime për shkak të gjendjes së vjetruar. Në mënyrë që të investohet në zonat më kritike, analiza është bërë duke marrë parasysh kriteret e prioriteteve për zgjedhjen e projekteve.

Distrikti Prishtinë - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Drenasit, Fushë Kosovës, Obiliqit, Podujevës dhe Prishtinës. Nga këto projekte përfitojnë rreth 8,489 konsumatorë.

Distrikti Prizren - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Suharekës, Dragash dhe Prizrenit. Nga këto projekte përfitojnë rreth 5,053 konsumatorë.

Distrikti Pejë - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Deçanit, Pejës dhe Klinës. Nga këto projekte përfitojnë rreth 3,792 konsumatorë.

Distrikti Gjakovë - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës. Nga këto projekte përfitojnë rreth 4,695 konsumatorë.

Distrikti Mitrovicë - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Vushtrrisë dhe Skenderajit. Nga këto projekte përfitojnë rreth 1,874 konsumatorë.

Mitrovica e Veriut - Duke marrë parasysh gjendjen e keqe të rrjetit të tensionit të ulët (TU), është investuar në TS-et: Kulla Vinarc (Lahovit), Vinarce Zymeri dhe Vinarc i Eperm-3. Poashtu është investuar edhe në fshatrat Cerajë, Bistricë dhe Koshtovë për shkak të rrjetit në gjendje të keqe. Nga këto projekte përfitojnë rreth 320 konsumatorë.

Distrikti Ferizaj - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Ferizajit, Lipjanit dhe Shtimës. Nga këto projekte përfitojnë rreth 4,376 konsumatorë.

Distrikti Gjilan - Në vitin 2025 në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar projekte në rajonin e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës. Nga këto projekte përfitojnë rreth 1,876 konsumatorë.

Lidhjet e reja - Në kuadër të projekteve të tensionit të ulët janë implementuar edhe projektet e llojit Lidhje të reja. Nga këto projekte është investuar në tërë Kosovën.

Si përfundim, për të gjitha investimet e vitit 2025 për rrjetin TM dhe TU, janë shpenzuar materiale si më poshtë:

Tab. 6.19 Sasitë e materialit të përdorur në vitin 2025

| Lloji i materialit | Sasia | Njësia |
|--------------------|--------|--------------|
| Transformatorë | 222 | copë |
| Shtylla | 6,806 | copë |
| Kuti për njehsorë | 3,572 | copë |
| Panel i TU | 163 | copë |
| Kioska | 21 | copë |
| Kthina | 222 | copë |
| Kabllo TM | 136.21 | km |
| Kabllo TU | 382.55 | km |
| Përçues | 103.58 | km |
| Kapak për puseta | 658 | copë |
| Gypa | 23,736 | copë |
| Tjetër | 40,953 | metër / copë |

Investimet e bëra përgjatë vitit 2025 nga Departamenti i Operimit të Sistemit

Projektet e tensionit të mesëm u realizuan për të adresuar çështjet që lidhen me rritjen e shpejtë të konsumit, mbingarkesat e rrjetit dhe përmirësimet në parametra të tjerë teknikë. Në të njëjtën kohë, këto projekte u integruan me iniciativat e planifikimit urban të komunave në Republikën e Kosovës.

Projektet e rindërtimit të rrjetit të tensionit të ulët janë përqendruar kryesisht në Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, etj. Këto projekte synojnë të përmirësojnë nivelet e tensionit dhe të sigurojnë një cilësi më të lartë të furnizimit me energji elektrike.

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Sistemit të Operimit në kuadër të realizimit të projekteve ka investuar në projektet të cilat kanë të bëjnë me fushat si më poshtë:

- **Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit** : Si pjesë e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të rrjetit gjatë gjithë vitit, janë kryer keto aktivitete: Zëvendësimi i shtyllave të tensionit të mesëm (TM) dhe tensionit të ulët (TU); pastrimi i gjurmës së rrjeteve të tensionit të ulët dhe të mesëm si masë

parandaluese për të krijuar kushte për funksionimin e linjave të paprekura nga faktorë të jashtëm (si degët e pemëve, etj.); zëvendësimi dhe shtrëngimi i përçuesve, zëvendësimi i izolatorëve, shkarkuesve të mbitensionit, krahëve të kryqëzuar dhe çdo elementi tjetër që gjatë inspektimit paraprak është konsideruar i mundshëm të dështojë shpejt dhe të bëhet burim ndërprerjesh; zhvendosja e linjave 10 [kV] dhe 0.4 [kV] për mirëmbajtje dhe riparim më të lehtë në rast të avarive; përforsimi i bazave të transformatorëve në shtylla dhe shtylla të konstruksioneve metalike; rregullimi i kioskave metalike të transformatorëve, konstruksione metalike; zëvendësimi i transformatorëve të dëmtuar ose të mbingarkuar.

- **Pastrimi i linjave shpërndarëse 10, 20 dhe 35 [kV]:** Gjatë gjithë vitit, 112,900 [m] linjë u pastruan nga bimësia në një total prej 92 dalje.
- **Ndërrimi i Transformatorëve të mbingarkuar:** Në total janë ndërruar 17 transformatorë.
- **Investimet në projektet 10 [kV]:** DS 10 [kV] Gjakova II, LP Stacioni Hekurudhor – Rr. Drenicë, LP Dalja kah Spitali, Fsh. Kabash - LP Gërmova, LP Gjinovci, LP Opterusha, TS Malishevë – Agroni, Furnizimi i TS shtëpiak të KOSTT – Obiliq, Krijimi i furnizimit unazor – Rezonanca & Segmenti TS Çagllavica 3 – TS Bajram Gashani 1, LP Slivova dhe LP Kolonia e Vjetër, LP Leshani, LP Loxha, LP Sharbani, LP në daljen Radavci, LP Shtëpia e Kulturës, LP Kraishta.
- **Rikonstruktimi i rrjetit të TU dhe TM:** janë projektet e përfunduara gjatë këtij viti, të cilat përfshijnë investime në linja të reja, shkarkimin e daljeve të mbingarkuara 10(20) [kV], zhvendosjen e rrjetit, instalimin e transformatorëve dhe implementimin e njehsorëve PLC. Projekte e tensionit të mesëm dhe të ulët: TS Sllovi II (Qerkezët), LP Drenices me Komoranin (LP Drenica, segmenti TS-021 -TS-017), TS Komogllavë (Mirovit-Malokët), TS Bibaj (Milazim Alija), TS Provoli – Nikaj, TS Rrezina, TS Busavata-Jasenovik, TS Viti te Pasqyrja, TS Kufce e Ulet, TS Kosaqë, TS B6 4210 Palestra Sportive Minatori - Mitrovice, TS. Maxhunaj ish Mulliri, TS Zhabart, TS Halla e Sportit, TS Jashanic -Hote, TS Mahall, TS Shushic Sadikajt, LP Dumnica e epërme, TS Sopija II.
- **Investimet në projektet 0.4 [kV]:** Në të gjithë rrjetin e KEDS-it, ka pjesë të rrjetit 0.4 [kV] që kërkojnë investime për shkak të gjendjes së tyre të keqe. Për të investuar në zonat më kritike, janë marrë në konsideratë kriteret prioritarë për përzgjedhjen e projekteve. Në Distriktin e Prishtinës janë implementuar 21 projekte; në Distriktin e Prizrenit 16 projekte; në Distriktin e Pejës 14 projekte; në Distriktin e Gjakovës 16 projekte; në Distriktin e Mitrovicës 16 projekte; në Distriktin e Ferizajt 11 projekte; si dhe në Distriktin e Gjilanit 22 projekte.
- **Shkarkimi i TS të mbingarkuar:** Gjatë vitit 2025, Njësia e Mirëmbajtjes së Rrjetit ka investuar në shkarkimin e daljeve të tensionit të ulët të mbingarkuara, për të cilët janë hapur edhe projektet: LP. Hashkalit + Ashkalit II, TS Fakulteti i Shkencave Aplikative, TS Bllact dhe Reja, TS Beguncë – Qeshmja, TS Fermat (Rosaleta), Tuneli TS, TS Zatra I, Qendra Sociale TS.

Realizimi i Projekteve PLC

Realizimi i këtyre projekteve ka ndikuar në rënien e humbjeve teknike dhe jo teknike në masë të madhe aty ku janë implementuar, duke mundësuar krijimin e kushteve për furnizim më cilësor me energji elektrike dhe tension kualitativ tek konsumatorët e afektuar, ku nga këto investime në PLC janë afektuar 1,805 konsumatorë.

Investimet në pikën matëse - Gjatë vitit 2025 janë investuar njehsorët si në vijim:

- 7,668 njehsorë me matje direkte me komunikim GSM GPRS;
- 22,577 njehsorë me matje direkte me PLC;

- 846 njehsorë me matje gjysmë indirekte dhe indirekte, prej të cilëve 157 janë njehsorë të rinjë dhe 689 janë njehsorë të ndërruar (duke përfshirë edhe njehsorët kontrollues);
- 31,843 njehsorë mekanik që janë ndërruar me digjital;
- 30,132 njehsorë të dedikuar për lidhje të reja.

Ndërrimi i mbrojtjeve rele në nënstacione: Nënstationet në të cilat janë ndërruar reletë përfshijnë 29 nënstacione, ndërsa numri total i releve të ndërruara është 283 copë.

Investimet në sistemin SCADA: Gjatë vitit 2024 sistemi SCADA është realizuar në 91 stabilimente, ndërsa gjatë vitit 2025 ky sistem është zgjeruar edhe në 10 stabilimente të tjera.

Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë në nënstacione:

- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë 4 [MVA] në NS 35/10 [kV] Kfori
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë 8 [MVA] në NS 35/10 [kV] Shtime
- Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë 2 x 8 [MVA] në NS 110/35/10(20) [kV] Fushë Kosova
- Ndërrimi i transformatorëve të fuqisë 3 x 8 [MVA] në NS 35/10(20) [kV] Ferizaji III
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë 8 [MVA] në NS 35/10(20) [kV] Ferizaji II
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë 8 [MVA] në NS 110/35/10(20) [kV] Ferizaji I
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë 8 [MVA] në NS 35/10 [kV] Gjakova I

Instalimi i transformatorëve për qëllime të konvertimit të daljeve nga niveli 10 në 20 [kV]:

- Instalimi i transformatorit të fuqisë 8 [MVA] në NS 110/10(20) [kV] Theranda
- Instalimi i transformatorëve të fuqisë 2x8 [MVA] në NS 110/35/10(20) [kV] Ferizaji 1
- Instalimi i transformatorëve të fuqisë 2x8 [MVA] në NS 110/10(20) [kV] Gjakova 2

Mirëmbajtja e nënstacioneve të tensionit të mesëm: Sa i përket mirëmbajtjes së transformatorëve të fuqisë, gjatë vitit 2025 janë mirëmbajtur 9 transformatorë të fuqisë.

Rivitalizimi i nënstacioneve: Gjatë vitit 2025 OSSH ka ndërruar kthinat në këto nënstacione:

- NS 110/10 [kV] Prishtina 6 (1 kthinë e re)
- NS 110/10 [kV] Gjakova 2 (5 kthina të reja)
- NS 110/10(20) [kV] Theranda (3 kthina të reja)
- NS Malisheva 35/20 [kV] (14 kthina të reja)
- NS Gjakova I 35/10 [kV] (9 kthina të reja)
- NS Gjilani 1 110/35/10 [kV] (2 kthina të reja)
- NS Ferizaji 1 110/35/10(20) [kV] (9 kthina të reja)
- NS Ferizaji II 35/10(20) [kV] (4 kthina të reja)
- NS Prishtina 7 110/20 [kV] (2 kthina të reja)
- NS Prishtina I 35/20 [kV] (1 kthinë e re)

Gjeneratorët Mobil: Gjatë vitit 2025 është realizuar projekti për furnizimin me 8 gjeneratorë mobilë me kapacitet 100 kVA.

Instalimi i Rikyçësve Automatik: Në vitin 2025 janë instaluar gjithsej 3 rikyçës automatik në daljet: Radavci, Gacka dhe Llapushniku.

Procesi i punëve të realizuara në GIS gjatë vitit 2025:

- Përgatitja e tenderit – Vlerësimi i KEDS-it, analiza e proceseve të departamenteve, llogaritja e BoQ.

- Përgatitja e infrastrukturës – Përgatitja e specifikimit teknik për GIS dhe tabela, përgatitja e të dhënave model për GIS, analiza e procesit KSSH dhe zhvillimi i aplikacionit.
- Mbarimi i tenderit – Përfundimi i evaluimit teknik, testimi i procesit KSSH, analiza e detajeve të proceseve të punës GIS.
- Fillimi i proceseve – Konvertimi i të dhënave nga Google Earth në GIS, lidhja (konektimi) i rrjetit të tensionit të mesëm, kontrollimi i të gjitha vlerave të TM.
- Fillimi i KSSH – Përfundimi i KSSH në Vushtrri për 21,000 konsumatorë, vendosja e 11,600 barkodeve.

6.5.2 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje përfshijnë konsumin, humbjet teknike dhe ato komerciale, të cilat janë të llogaritura sipas distrikteve dhe sipas muajve të vitit.

OSSH është e organizuar në shtatë distrikte: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjilani. Bazuar në raportimet nga OSSH, konsumi më i lartë është realizuar në distriktin e Prishtinës me 30.76 % ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, ndërsa konsumi më i ulët është në distriktin e Gjakovës me 8.67 % të konsumit të përgjithshëm.

Rrjedhat e energjisë në shpërndarje sipas distrikteve përfshirë edhe humbjet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën 6.19. Të dhënat për distriktin e Mitrovicës përfshijnë edhe konsumin në komunitat veriore, i cili është llogaritur në kategorinë e humbjeve komerciale.

Tab. 6.20 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2025

| Distriktet | Ngarkesa në distrikte | Energjia e faturuar | Humbjet teknike | | Humbjet komerciale | | Humbjet gjithsej | |
|------------|-----------------------|---------------------|-----------------|-------|--------------------|-------|------------------|-------|
| | MWh | MWh | MWh | % | MWh | % | MWh | % |
| Prishtina | 2,033,692 | 1,775,663 | 188,680 | 9.28 | 69,348 | 3.41 | 258,028 | 12.69 |
| Mitrovica | 834,971 | 647,331 | 60,707 | 7.27 | 126,933 | 15.20 | 187,640 | 22.47 |
| Peja | 740,458 | 586,249 | 96,625 | 13.05 | 57,585 | 7.78 | 154,209 | 20.83 |
| Gjakova | 573,168 | 488,800 | 74,081 | 12.92 | 10,286 | 1.79 | 84,367 | 14.72 |
| Prizreni | 845,690 | 733,451 | 94,443 | 11.17 | 17,796 | 2.10 | 112,239 | 13.27 |
| Ferizaji | 1,002,045 | 869,069 | 103,928 | 10.37 | 29,049 | 2.90 | 132,977 | 13.27 |
| Gjilani | 582,159 | 516,410 | 53,652 | 9.22 | 12,098 | 2.08 | 65,749 | 11.29 |
| Gjithsej | 6,612,183 | 5,616,973 | 672,115 | 10.16 | 323,095 | 4.89 | 995,210 | 15.05 |

Në tabelën më poshtë janë paraqitur kërkesa (ngarkesa), energjia e faturuar si dhe humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje sipas muajve.

Tab. 6.21 Konsumi dhe humbjet në shpërndarje në vitin 2025

| Muajt | Ngarkesa | Energjia e faturuar | Humbjet teknike | | Humbjet komerciale | | Humbjet gjithsej | |
|------------------------------|------------------|---------------------|-----------------|--------------|--------------------|-------------|------------------|--------------|
| | MWh | MWh | MWh | % | MWh | % | MWh | % |
| Janar | 792,704 | 670,794 | 88,928 | 11.22 | 32,983 | 4.16 | 121,911 | 15.38 |
| Shkurt | 692,885 | 543,365 | 81,182 | 11.72 | 68,338 | 9.86 | 149,520 | 21.58 |
| Mars | 592,118 | 510,169 | 58,273 | 9.84 | 23,676 | 4.00 | 81,949 | 13.84 |
| Prill | 510,577 | 441,364 | 48,217 | 9.44 | 20,995 | 4.11 | 69,213 | 13.56 |
| Maj | 427,040 | 362,753 | 38,056 | 8.91 | 26,232 | 6.14 | 64,287 | 15.05 |
| Qershor | 385,728 | 350,293 | 30,736 | 7.97 | 4,700 | 1.22 | 35,435 | 9.19 |
| Korrik | 442,932 | 398,414 | 36,418 | 8.22 | 8,101 | 1.83 | 44,518 | 10.05 |
| Gusht | 438,460 | 406,661 | 26,950 | 6.15 | 4,849 | 1.11 | 31,799 | 7.25 |
| Shtator | 379,579 | 336,662 | 31,966 | 8.42 | 10,951 | 2.88 | 42,917 | 11.31 |
| Tetor | 535,084 | 448,404 | 53,653 | 10.03 | 33,027 | 6.17 | 86,680 | 16.20 |
| Nëntor | 580,860 | 481,062 | 62,324 | 10.73 | 37,474 | 6.45 | 99,799 | 17.18 |
| Dhjetor | 834,216 | 667,033 | 115,413 | 13.83 | 51,770 | 6.21 | 167,183 | 20.04 |
| Totali i realizuar | 6,612,183 | 5,616,973 | 672,115 | 10.16 | 323,095 | 4.89 | 995,210 | 15.05 |
| Totali sipas bilancit | 6,573,724 | 5,546,395 | 760,179 | 11.56 | 267,150 | 4.06 | 1,027,329 | 15.63 |

Humbjet totale në sistemin e shpërndarjes janë të matura dhe paraqesin diferencën mes energjisë në hyrje të shpërndarjes dhe energjisë së faturuar. Meqenëse nuk mund të maten veçmas humbjet teknike dhe ato komerciale, atëherë ndarja e këtyre humbjeve bëhet përmes kalkulimit të humbjeve teknike përmes softuerëve përkatës, ndërsa humbjet komerciale më tej kalkuloohen si diferencë mes humbjeve totale dhe atyre teknike.

Humbjet teknike sipas të dhënave të dërguara nga OSSH arrijnë vlerën 10.16 % apo 672.1 GWh, ku ndikim në nivelin e lartë të këtyre humbjeve kanë vjetërsia e rrjetit, gjatësia e linjave, kualiteti dhe lloji i përçuesve dhe transformatorëve, ngarkimi i pajisjeve, si dhe mirëmbajtja e tyre. Kurse humbjet jo-teknike (komerciale), kanë qenë 229.3 GWh (pa pjesën e 4 komunave veriore) dhe përbëjnë 3.49% të gjithsej kërkesës në shpërndarje.

Duhet theksuar se me licencimin e furnizuesit Elektroserver, që nga 1 janar 2024 energjia faturohet edhe në katër komunat veriore të Kosovës dhe nga gjithsej kërkesa prej 275.35 GWh në këto katër komuna janë faturuar rreth 169 GWh (pas korrigjimit) apo rreth 61.4% e kërkesës për energji.

Prandaj humbjet e gjithmbarshme jo-teknike ndaj kërkesës së përgjithshme në shpërndarje, përfshirë humbjet në katër komunat veriore të Kosovës, në vitin 2025 kanë qenë 323.1 GWh, apo 4.89 % ndaj kërkesës së përgjithshme në shpërndarje.

Kërkesa e energjisë elektrike në nivel të Operatorit të Sistemit të Shpërndarje në vitin 2025 është realizuar në vlerën 6,612 GWh, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 6,258 GWh, që paraqet një rritje përafërsisht 5.66 %.

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e kërkesës në sistemin e shpërndarjes nga viti 2015 deri 2025.




Fig. 6.14 Kërkesa për energji elektrike në sistemin e shpërndarjes 2015-2025

Edhe përkundër investimeve të realizuara deri më tani në rrjetin e shpërndarjes, humbjet e energjisë elektrike ende mbeten të larta dhe paraqesin problem shqetësues për sektorin e energjisë elektrike. Humbjet po ashtu kanë ndikim negativ edhe në furnizimin e konsumatorëve dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve të furnizimit dhe shpërndarjes, si dhe tërë sektorin e energjisë.

Kostoja e humbjeve të energjisë elektrike deri në nivelin e përcaktuar nga Rregullatori mbulohet nga tarifa e konsumatorëve. Operatori i sistemit të shpërndarjes bënë përpjekje të vazhdueshme për zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje, mirëpo pavarësisht zvogëlimit të humbjeve ndër vite, OSSH nuk ka arritur të përmbush caqet e përcaktuara nga Rregullatori, që do të thotë se kostoja e pjesës së tejkaluar e këtyre caqeve bartet nga vet OSSH.

Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat për humbjet teknike, komerciale dhe humbjeve gjithsej në shpërndarje nga viti 2015 deri 2025, ku shihet trendi i zvogëlimit të humbjeve por edhe luhatjet në nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale.




Fig. 6.15 Humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje për periudhën 2015-2025

Në përgjithësi humbjet e energjisë elektrike në OSSH, përfshirë edhe humbjet (konsumin) në katër komunitat veriore të Kosovës, janë zvogëluar dukshëm nga 20.67 % sa ishin në vitin 2023, në 15.6 % në vitin 2024 dhe tani në 15.05 % në 2025 ndaj kërkesës në shpërndarje. Kjo ulje e dukshme duke filluar në vitin 2024 dhe tani vazhdon me një ulje të vogël dhe është për faktin se nga data 01 janar të vitit 2024, energjia e konsumuar në katër komunitat veriore të vendit ka filluar të faturohet, dhe nuk konsiderohet e tëra si humbje, siç ishte deri në dhjetor të vitit 2023.

6.6 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët fundor edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar të realizohet nga KESCO i cili është furnizues me obligim të shërbimit universal, i cili ka furnizuar konsumatorët me çmime të rregulluara, kurse konsumatorët me çmime të parregulluara janë furnizuar nga KEK furnizues, Voltkos, Enerco, Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K, KESCO Premium dhe EDS International L.L.C.

Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të faturuar edhe më tutje mbetet dominues me rreth 59.66 %, e pasuar nga konsumi komercial (i rregulluar) me 20.82 %, e pastaj nga konsumi në tregun e lirë me 7.88%, konsumi industrial me 7.83 %, konsumi në katër komunitat veriore 2.97% dhe në fund nga konsumi në ndriçimin publik me 0.83 %. Krahasuar me vitin e kaluar, kërkesa bruto është ngritur për 5.66%, e poashtu edhe faturimi është rritur për 6.3%. Konsumi i konsumatorëve familjar është rritur për 7.5 %, konsumi i konsumatorëve komercial është rritur rreth 22.9 %, derisa konsumi industrial është ulur rreth 33.6 %.

Në figurën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive të konsumit krahasuar me konsumin e përgjithshëm (e paraqitur me humbje dhe pa humbje).




Fig. 6.16 Pjesëmarrja e kategorive të konsumit - me dhe pa humbje 2025

6.6.1 Faturimi dhe arkëtimi

Energjia e faturuar në sistemin e shpërndarjes në vitin 2025 ka qenë 5,617 GWh dhe paraqet rreth 84.9 % ndaj ngarkesës së sistemit të shpërndarjes, e që krahasuar me vitet paraprake paraqet një ngritje të lehtë.

Tabela më poshtë paraqet faturimin, arkëtimin për energji dhe arkëtimin bruto të konsumatorëve të rregulluar në rrjetin e shpërndarjes si dhe raportin mes faturimit dhe arkëtimit për energji sipas muajve për vitin 2025, ku shihet se në disa muaj ky raport është më i lartë se vlera 100 %, që nënkupton se në këta muaj është arkëtuar energjia elektrike e faturuar për muajt paraprak.

Tab. 6.22 Faturimi dhe arkëtimi sipas muajve në shpërndarje për vitin 2025

| Konsumatorët e rregulluar 2025 | Gjithsej realizimi | Faturimi | Arkëtimi | Ark/Fat |
|--------------------------------|--------------------|-------------|-------------|---------|
| | MWh | € | € | % |
| Janar | 647,125 | 57,615,679 | 48,203,550 | 83.7% |
| Shkurt | 520,953 | 46,422,951 | 46,533,649 | 100.2% |
| Mars | 489,400 | 42,131,062 | 43,666,740 | 103.6% |
| Prill | 424,593 | 36,978,939 | 40,114,859 | 108.5% |
| Maj | 349,919 | 35,237,109 | 34,271,994 | 97.3% |
| Qershor | 283,360 | 28,846,542 | 30,531,247 | 105.8% |
| Korrik | 320,346 | 32,718,226 | 30,299,361 | 92.6% |
| Gusht | 341,063 | 34,494,324 | 30,364,482 | 88.0% |
| Shtator | 269,615 | 27,636,471 | 29,809,446 | 107.9% |
| Tetor | 370,452 | 37,049,242 | 29,066,871 | 78.5% |
| Nëntor | 400,175 | 40,288,918 | 32,647,427 | 81.0% |
| Dhjetor | 570,463 | 59,007,004 | 44,370,504 | 75.2% |
| Gjithsej | 4,987,464 | 478,426,467 | 439,880,128 | 91.94% |

Në krahasim me vitin e kaluar shihet se arkëtimi ndaj faturimit të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar mbetet afërsisht në nivelin e njëjtë me afro 92%.

Duhet theksuar se realizimi në tabelën sipër nuk përfshinë rrjedhën e energjisë dhe faturimin në katër komunitat veriore të Kosovës.

Energjia e faturuar në rrjetin e shpërndarjes për konsumatorët m[ë të drejtën e shërbimit universal, ka qenë 4,987.5 GWh apo në vlerë 443.5 mil € (478.4 mil € me TVSH), derisa inkasimi ka qenë 439.9 mil € me TVSH, apo rreth 92%.

Energjia elektrike e faturuar dhe arkëtuar (bruto) në shpërndarje si dhe raporti mes faturimit dhe arkëtimit bruto nga viti 2015 deri në 2025 për konsumatorët e rregulluar është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.17. Faturimi dhe arkëtimi në shpërndarje gjatë viteve 2015-2025

Konsumi i kategorizuar sipas nivelit të tensionit dhe grupeve të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike për vitin 2025 është dhënë në figurën më poshtë.

Tab. 6.23 Energjia elektrike e faturuar sipas kategorive tarifore 2025

| Kategoritë (GWh) | Gjithsej | Jan | Shku | Mar | Pri | Maj | Qer | Korr | Gush | Shta | Tet | Nën | Dhje |
|-----------------------------|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| 220 kV (Ferronikeli) | 9.1 | 1.9 | 1.8 | 1.3 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.4 | 0.4 | 0.4 | 0.5 | 0.4 | 0.4 |
| 110 kV (Trepça) | 22.0 | 1.9 | 1.8 | 1.8 | 1.7 | 1.8 | 1.6 | 1.8 | 1.7 | 1.8 | 2.0 | 1.9 | 2.1 |
| 110 kV (Sharrcem) | 60.5 | 4.7 | 3.2 | 3.0 | 2.7 | 6.3 | 5.6 | 5.8 | 5.1 | 6.2 | 6.3 | 5.7 | 5.8 |
| 35 kV | 32.0 | 4.6 | 4.6 | 4.8 | 4.7 | 4.3 | 1.0 | 1.2 | 1.6 | 1.2 | 1.2 | 1.3 | 1.6 |
| 10 kV | 321.8 | 46.6 | 43.8 | 41.3 | 39.3 | 38.1 | 14.4 | 15.3 | 14.7 | 14.0 | 16.3 | 17.4 | 20.6 |
| Amvisnia | 3,393.1 | 448.4 | 339.6 | 322.3 | 271.2 | 206.9 | 192.6 | 212.9 | 227.8 | 180.5 | 267.6 | 290.8 | 432.5 |
| 0.4 kV I | 382.1 | 51.4 | 47.6 | 43.6 | 40.9 | 38.3 | 19.9 | 23.6 | 21.8 | 19.4 | 22.7 | 23.3 | 29.6 |
| 0.4 kV II | 802.2 | 91.8 | 81.2 | 73.5 | 65.1 | 59.1 | 52.6 | 64.0 | 63.6 | 49.9 | 57.8 | 62.3 | 81.3 |
| Ndriqimi publik | 47.2 | 4.4 | 4.1 | 3.9 | 3.4 | 3.2 | 2.9 | 3.3 | 3.4 | 4.0 | 4.7 | 5.0 | 5.0 |
| Korrigjime nga tregu I lire | 9.0 | | | | | | | | 8.3 | 0.5 | 0.1 | 0.1 | 0.0 |
| Konsumi v eri | 169.0 | 24.0 | 22.2 | 19.9 | 16.1 | 11.8 | 11.1 | 8.4 | 6.5 | 4.6 | 13.4 | 14.6 | 16.4 |
| Konsumatoret e parregull | 448.0 | | | | | | 56.1 | 68.6 | 57.1 | 58.8 | 64.0 | 65.6 | 77.8 |
| Gjithsej faturuar | 5,696.1 | 679.8 | 549.8 | 515.5 | 445.6 | 370.3 | 358.2 | 405.3 | 412.0 | 341.5 | 456.7 | 488.3 | 673.1 |
| Konsumi KEK | 104.6 | 10.4 | 9.6 | 10.0 | 8.3 | 8.7 | 7.2 | 6.3 | 7.5 | 7.9 | 8.6 | 9.6 | 10.5 |
| Humbjet OSSH | 995.2 | 121.9 | 149.5 | 81.9 | 69.2 | 64.3 | 35.4 | 44.5 | 31.8 | 42.9 | 86.7 | 99.8 | 167.2 |
| Humbjet KOSTT | 135.4 | 16.9 | 14.4 | 11.3 | 9.1 | 7.7 | 7.3 | 9.5 | 9.3 | 8.2 | 11.4 | 12.1 | 18.1 |
| Gjithsej | 6,931.3 | 828.9 | 723.4 | 618.7 | 532.3 | 451.0 | 408.1 | 465.5 | 460.6 | 400.6 | 563.4 | 609.8 | 868.8 |

Kërkesa nacionale për energji në vitin 2025 ka qenë 6,944 GWh, derisa energjia elektrike e faturuar në sistemin e transmetimit ka qenë 91.6 GWh dhe në sistemin e shpërndarjes qenë 4,987.5 GWh.


Tabela e mëposhtme paraqet faturimin e konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal dhe konsumatorëve në tregun e lirë.

Tab. 6.24 Faturimi dhe arkëtimi në vitin 2025

| 2025 | Faturimi |
|-----------------------------|-----------|
| | MWh |
| Konsumatorët e rregulluar | 4,987,402 |
| Konsumatorët e parregulluar | 708,617 |
| Gjithsej | 5,696,019 |

Çmimi mesatar i energjisë elektrike

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike është i bazuar në tarifat për aktivitetet e rregulluara të energjisë elektrike dhe ndryshon varësisht nga kategoria e konsumatorëve, niveli i tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe shfrytëzimi i energjisë elektrike në tarifa të ndryshme sipas sezonës dhe kohës në të cilën është shfrytëzuar energjia. Ky çmim mesatar i shitjes (pa TVSH) është paraqitur në figurën e mëposhtme. Çmimi mesatar i shitjes poashtu ndryshon edhe sipas distrikteve varësisht nga koncentrimi i aktiviteteve komerciale/industriale që shfrytëzojnë energji elektrike në periudha të caktuara.


Fig. 6.18 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike 2025 (pa TVSH)

Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë pa TVSH është 8.17 €cent/kWh që është më i lartë për 10.5% se në vitin 2024 kur ka qenë 7.39 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë pa TVSH është 10.46 €cent/kWh që është më i lartë se çmimi mesatar në vitin 2024 kur ka qenë 9.30 €cent/kWh.

Në figurën më poshtë janë paraqitur çmimet mesatare të energjisë elektrike për konsumatorët familjar dhe jo-familjar për dhjet vitet e fundit, çmime të cilat nuk përfshijnë TVSH.





Fig. 6.19 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike (pa TVSH) ndër vite

Krahasuar me vendet e rajonit dhe bazuar në të dhënat e nxjerra nga Eurostat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, Kosova ka çmimin mesatare pa TVSH më të ulët se pothuajse të gjitha shtetet për konsumatorët familjar. Të dhënat e Eurostat-it të kategorizuara sipas konsumit familjar 2500-5000 kWh/vit, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 për disa shtete, meqë mungojnë ende të dhënat për gjashtëmujorin e dytë janë paraqitur në figurën e mëposhtme.



*Burimi i të dhënave nga EUROSTAT

Fig. 6.20 Çmimet mesatare për konsumatorët familjar për 6 mujorin e parë 2025 (pa TVSH)

Poashtu krahasuar me vendet BE dhe rajonit bazuar në të dhënat e nxjerra nga Eurostat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, Kosova ka çmimet mesatare më të ulëta për konsumatorët jo-familjar.

Të dhënat e Eurostat-it të kategorizuara sipas shteteve të BE dhe vendeve në regjion për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 janë paraqitur në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.21 Çmimet mesatare për konsumatorët jofamiljar për 6 mujorin e parë 2025 (pa TVSH)

Të dhënat e paraqitura në figurat më lartë për vitin 2025 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë një pozicion relativisht të favorshëm për sa i përket çmimeve të energjisë për konsumatorët familjar dhe jo-familjar.

6.7 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Në përgjithësi, pjesa më e madhe e kërkesës së gjithmbarshme për energji elektrike në sistemin elektroenergjetik të Kosovës mbulohet nga gjenerimi vendor i dominuar nga termocentralet, derisa pjesa tjetër sigurohet nga importi i cili realizohet përmes linjave ndërkuftare.

Pjesëmarrja e importit ndaj kërkesës së gjithmbarshme për energji ka qenë 28.29 %, duke shënuar rritje për rreth 7.39 pikë përqindje në raport me vitin e kaluar e që ishte rreth 20.9 %.

Përmes linjave interkonektive nga sistemi rajonal në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, kanë hyrë 4,177GWh, ndërsa kanë dalë 2,656 GWh, ku -1,612 GWh paraqet ndryshimin në mes hyrje-dalje i cili ndahet në neto importin dhe devijimet ndaj sistemit rajonal.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive me vendet fqinje.

Tab. 6.25 Rrjedhat e energjisë elektrike në linjat interkonektive për vitin 2025

| Rrjedha në linjat interkonektive MWh | 400 kV | | 220 kV | | 110 kV | | Gjithsej | |
|--------------------------------------|-------------------|------------------|-----------------|----------------|---------------|----------------|-------------------|------------------|
| | Marrje | Dërgim | Marrje | Dërgim | Marrje | Dërgim | Marrje | Dërgim |
| Shqipëria | 389,397 | 527,424 | 760,247 | 42,039 | | | 1,149,644 | 569,463 |
| Maqedonia | 1,070,985 | 634,394 | | | | | 1,070,985 | 634,394 |
| Mali I Zi | 844,185 | 660,277 | | | 25,188 | 104,179 | 869,373 | 764,456 |
| Sërbia | 954,437 | 377,884 | 116,721 | 218,189 | 16,325 | 846 | 1,087,483 | 596,919 |
| Gjithsej | 3,259,004 | 2,199,979 | 876,968 | 260,228 | 41,513 | 105,025 | 4,177,485 | 2,565,232 |
| Bilanci | -1,059,025 | | -616,740 | | 63,512 | | -1,612,253 | |

Importi i realizuar për vitin 2025 ka qenë 1,964,475 MWh, me të cilin janë plotësuar mungesat e energjisë sidomos në kohën e pikut në sezonin e dimrit kur kërkesa ishte e papërbalueshme për prodhimin vendor.

Kjo sasi përfshinë energjinë elektrike të importuar për konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar, për humbjet në rrjetin e transmetimit dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes, e cila është siguruar përmes kontratave komerciale, përmes ALPEX si dhe përmes shkëmbimit energji për energji në mes të KEK dhe KESH.

Importi i energjisë elektrike për vitin 2025, përfshirë edhe shkëmbimin me KESH ka qenë 1,964,475 MWh dhe është për 580,164 MWh më i lartë se sa në vitin 2024 për 42% që ishte 1,384,511 MWh. Derisa importi me kontrata ka qenë 1,959,892 MWh apo 586,728 MWh më i lartë se në vitin 2024 kur ishte 1,373,264 MWh.

Çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike me kontrata komerciale gjatë vitit 2025 ka qenë 121.56 €/MWh, dhe krahasuar me vitin e kaluar që ishte 122.76 €/MWh, këtë vit çmimi mesatar i importit është më i ulët për 1.20 €/MWh.

Të dhënat për importet dhe eksportet e energjisë elektrike janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab. 6.26 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për vitin 2025

| Importi/Eksport MWh | Importi me kontrata | Importi si shkëmbim | Gjithsej Importi | Eksporti me kontrata | Eksporti si shkëmbim | Gjithsej Eksporti | Net Imp/Eksp |
|---------------------|---------------------|---------------------|------------------|----------------------|----------------------|-------------------|-------------------|
| Janar | 271,472 | 0 | 271,472 | 8,074 | 0 | 8,074 | -263,398 |
| Shkurt | 235,975 | 0 | 235,975 | 3,894 | 0 | 3,894 | -232,082 |
| Mars | 136,747 | 0 | 136,747 | 23,333 | 0 | 23,333 | -113,414 |
| Prill | 174,452 | 1,050 | 175,502 | 16,313 | 0 | 16,313 | -159,189 |
| Maj | 112,720 | 0 | 112,720 | 23,204 | 1,155 | 24,359 | -88,360 |
| Qershor | 113,935 | 0 | 113,935 | 21,897 | 2,395 | 24,292 | -89,644 |
| Korrik | 128,689 | 0 | 128,689 | 38,221 | 0 | 38,221 | -90,468 |
| Gusht | 149,388 | 0 | 149,388 | 40,934 | 2,182 | 43,116 | -106,272 |
| Shtator | 97,537 | 600 | 98,137 | 39,792 | 2,364 | 42,156 | -55,981 |
| Tetor | 124,533 | 2,573 | 127,106 | 67,203 | 660 | 67,863 | -59,243 |
| Nëntor | 147,768 | 0 | 147,768 | 65,066 | 417 | 65,483 | -82,285 |
| Dhjetor | 266,674 | 560 | 267,234 | 19,438 | 334 | 19,772 | -247,462 |
| Gjithsej | 1,959,892 | 4,783 | 1,964,675 | 367,369 | 9,507 | 376,876 | -1,587,799 |

Çmimi mesatar i eksportit të energjisë elektrike me kontrata komerciale gjatë vitit 2025 ka qenë 105.31 €/MWh. Përveç eksportit me kontrata, gjithashtu është eksportuar edhe një sasi e energjisë elektrike si shkëmbim (energji për energji) në mes të KEK dhe KESH, gjithsej eksporti i energjisë elektrike për vitin 2025 ka qenë 376,876 MWh, prej të cilave 367,369 MWh ka qenë eksport me kontrata.

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lartë, në vitin 2025 Kosova ka qenë neto importuese e energjisë elektrike dhe atë në sasi prej 1,587,799 MWh, të paraqitura sipas muajve në figurën e mëposhtme.




Fig. 6.22 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike në vitin 2025

Tepricat e energjisë elektrike janë kryesisht në orët e natës (në kohën e tarifës së ulët), kur edhe në sistemet rajonale paraqiten teprica, gjë që ndikon që çmimet e eksportit të jenë dukshëm më të ulëta se sa çmimet e importit.

Çmimi i importit dhe eksportit të energjisë elektrike ndër vite ka shënuar ngritje dhe rënie, dhe në figurën më poshtë janë paraqitur çmimet e importit dhe eksportit nga viti 2015 deri 2025.




Fig. 6.23 Çmimi mesatar i importit dhe eksportit gjatë viteve

6.8 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë të rregulluara në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, të cilën rregull Bordi i ZRrE e ka miratuar me datë 05.06.2019. Qëllimi i Rregullës është të përcaktohen treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit.

Shërbimet e furnizimit me energji elektrike të cilat janë të përfshira në rregull janë:

- cilësia e shërbimit;
- furnizimi pandërprerë; dhe
- cilësia e tensionit.

Në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike janë të paraqitura treguesit (indiktorët) individual dhe të përgjithshëm të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike, treguesit e furnizimit të pandërprerë, si dhe treguesit e cilësisë së tensionit.

Duhet theksuar se standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë element i rëndësishëm i rregullimit të sektorit të energjisë. Këto standarde përcaktohen në mënyrë që cilësia e furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, si dhe cilësia e tensionit të konsumatorët të përmirësohet vazhdimisht prej ndërmarrjes së energjisë.

Edhe gjatë këtij viti raportues janë monitoruar standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike sipas fushave në vijim:

- Kontinuiteti i furnizimit;

- Cilësia e tensionit; dhe
- Cilësia komerciale.

6.8.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e sistemit energjetik, përkatësisht paraqet numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve për çdo konsumator brenda një viti.

Ndërprerjet e furnizimit me energji regjistrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Bazuar në Rregullën për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, ndërprerjet e energjisë elektrike klasifikohen si ndërprerje të shkurtra dhe të gjata. Çdo ndërprerje e furnizimit me energji që zgjatë deri në 3 minuta klasifikohet si ndërprerje e shkurtër, dhe çdo ndërprerje më e gjatë se 3 minuta klasifikohet si ndërprerje e gjatë. Vlen të theksohet se sipas Rregullës në fjalë dhe standardeve ndërkombëtare, nga operatorët e sistemit regjistrohen dhe raportohen vetëm ndërprerjet e gjata. Ndërprerjet e gjata klasifikohen si të planifikuara dhe të paplanifikuara.

Kontinuiteti i furnizimit matet me anë të indekseve:

- SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem;
- SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem;
- ENS - Energjia e pafurnizuar; dhe
- AIT - Koha mesatare e ndërprerjes.

Gjatë vitit 2025, kontinuiteti i furnizimit me energji elektrike është monitoruar nga Rregullatori për të dy operatorët e sistemit: Operatorin e sistemit të transmetimit (OST) dhe Operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH).

6.8.1.1 Indekset matëse të raportuara nga OST

Sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike, indikatorët e përgjithshëm të furnizimit të cilat Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të regjistrojë dhe raportojë janë:

- Kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve (AIT - Koha Mesatare e Ndërprerjes);
- Energjia e pa furnizuar (ENS – Energjia që nuk është Furnizuar).

Kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve (AIT - koha mesatare e ndërprerjes) në rrjetin e transmetimit përfaqëson kohëzgjatjen kumulative të ndërprerjeve të furnizimit me energji për konsumator.

Energjia e pa furnizuar (ENS – Energjia që nuk është furnizuar) është energjia që do të ishte furnizuar nga sistemi nëse nuk do të kishte asnjë ndërprerje të furnizimit me energji.

Indekset e përgjithshme matëse të raportuara nga OST për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2025 janë të paraqitur më poshtë.

- AIT - për ndërprerje të planifikuara ka qenë 18 minuta ose 0.30 orë;
- AIT - për ndërprerje të paplanifikuara ka qenë 45 minuta ose 0.75 orë;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.32 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e transmetimit ka qenë 0.81 GWh.




Fig. 6.24 Indikatorët matës AIT dhe ENS për KOSTT për vitin 2025

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga OST për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2021 – 2025 për indeksin AIT, ndërsa për indeksin ENS janë përgjatë viteve 2015 – 2025.




Fig. 6.25 Indeksi matës AIT për OST për periudhën 2021 – 2025




Fig. 6.26 Indeksi matës ENS për OST për periudhën 2015 - 2025

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se nga indekset matëse të raportuara AIT dhe ENS në vitin 2025 në përgjithësi ka përmirësim në furnizim në krahasim me vitin 2024.

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës AIT gjatë vitit 2025, vërehet se në total ka zbritje apo përmirësim të këtij indeksi për 12.5% në krahasim me vitin 2024, respektivisht ka rënie të ndërprerjet e paplanifikuara 16.67 % kurse ndërprerjet e planifikuara mbeten të pa ndryshuara.

Gjatë vitit 2025 energjia e pa furnizuar (ENS) në përgjithësi ka përmirësim krahasuar me vitin 2024, e që sipas të dhënave të raportuara vërehet se gjatë vitit 2025 në total ka rënie të energjisë së pa furnizuar për 23.08% në krahasim me vitin 2024, respektivisht ka rënie të ndërprerjet e planifikuara prej 39.51% dhe të ndërprerjeve paplanifikuara për 13.83%.

6.8.1.2 Indekset matëse të raportuara nga OSSH

Indekset matëse të raportuara nga OSSH mbi standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për vitin 2025 janë të paraqitur më poshtë.

- SAIDI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka 24.28 orë;
- SAIDI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 36.53 orë;
- SAIFI - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 6.08;
- SAIFI - për ndërprerje të paplanifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 39.45;
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 18.78 GWh; dhe
- ENS - për ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes ka qenë 31.95 GWh.




Fig. 6.27 Indekset matës SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për vitin 2025

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga OSSH për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2015 – 2025 për indeksin SAIDI dhe SAIFI, ndërsa për indeksin ENS janë përgjatë viteve 2015 - 2025.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur indekset matëse të raportuara nga OSSH për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike përgjatë viteve 2011 – 2025 për indeksin SAIDI dhe SAIFI, ndërsa për indeksin ENS janë përgjatë viteve 2015 – 2025.




Fig. 6.28 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për periudhën 2011-2025, dhe 2015 - 2025

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se në disa nga indekset matëse SAIDI, SAIFI dhe ENS në vitin 2025 në përgjithësi ka pasur përmirësim në krahasim me vitin 2024.

Sipas të dhënave të raportuara për indeksin matës SAIDI gjatë vitit 2025, vërehet se ka pasur përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2024, që do të thotë se në vitin 2025 në total ka rënie të ndërprerjeve për 16.14% në krahasim me vitin 2024. Gjatë analizave të detajuara të bëra indekstit – SAIDI, vërehet se në vitin 2025 ka rënie të ndërprerjeve të planifikuara prej 26.45% në krahasim me vitin 2024, si dhe rënie të ndërprerjeve të paplanifikuara për 7.52% në krahasim me vitin 2024.

Nga analiza e bërë indekstit matës SAIFI, vërehet se gjatë vitit 2025 ka përmirësim të këtij indeksi krahasuar me vitin 2024, që do të thotë se në vitin 2025 në total ka rënie të ndërprerjeve për 9.38% në krahasim me vitin 2024. Vlen të theksohet se gjatë analizave më detale të bëra indekstit – SAIFI, vërehet se në vitin 2025 ka rënie të shpeshtësisë së ndërprerjeve të planifikuara për konsumator për 29.93% në krahasim me vitin 2024, si dhe rënie të shpeshtësisë së ndërprerjeve të paplanifikuara për konsumator për 7.33% në krahasim me vitin 2024.

Gjatë vitit 2025, energjia e pafurnizuar (ENS) ka shënuar përmirësim të përgjithshëm krahasuar me vitin 2024. Sipas të dhënave të analizuara, vërehet një ulje prej 6.63% e nivelit total të ENS në raport me vitin paraprak, duke reflektuar rritje të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Analiza më e detajuar e indekstit ENS tregon se ky përmirësim është rezultat i reduktimit si të ndërprerjeve të planifikuara ashtu edhe të atyre të paplanifikuara. Konkretisht, energjia e pafurnizuar si pasojë e ndërprerjeve të planifikuara ka rënë për 14.01%, ndërsa ajo nga ndërprerjet e paplanifikuara ka pësuar një ulje prej 1.66% krahasuar me vitin 2024. Këto rezultate dëshmojnë për përmirësim të menaxhimit operacional, planifikim më efikas të punimeve në rrjet dhe reagim më të shpejtë ndaj defekteve, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimit për konsumatorët.

6.8.2 Cilësia e tensionit

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Gjatë vitit 2025, numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët në OSSH lidhur me cilësinë e tensionit ka qenë 544 ankesa, prej të cilave janë zgjidhur 307 ankesa apo 56.43% kurse në proces të shqyrtimit janë 237 ankesa apo 43.57%.




Fig. 6.29 Ankesat e konsumatorëve për cilësi të tensionit në vitin 2025

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e statusit të ankesave të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit në OSSH për vitin 2025.




Fig. 6.30 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2025

Pra, nga figura e mësipërme vërehet se OSSH nga 307 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve për cilësi të tensionit, prej tyre 216 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 70.36%, ndërsa 91 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 29.64 % pasi që nuk kanë rezultuar me probleme.

Më poshtë në figurë janë paraqitur ankesat e konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit ndër vite.




Fig. 6.31 Ankesat për cilësi të tensionit sipas viteve

Nga të dhënat vërehet se në vitin 2017 është shënuar një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave krahasuar me vitet paraprake, duke reflektuar një periudhë me më shumë shqetësime në aspektin e cilësisë së furnizimit.

Ndërkaq, duke filluar nga viti 2019, evidentohet një trend rënës i ankesave, çka tregon përmirësim gradual të parametrave të cilësisë së tensionit dhe rritje të stabilitetit në rrjet. Megjithatë, në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, vërehet sërish një rritje e ankesave për cilësinë e tensionit, duke sinjalizuar nevojën për analiza të mëtejshme dhe masa shtesë për të adresuar faktorët që kanë ndikuar në këtë ndryshim.

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, në Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes së shpërndarjes.

6.8.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Rregullimi i cilësisë komerciale merr parasysh marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit.

Me qëllim të analizimit të cilësisë komerciale, të dhënat e marra nga i licencuari janë paraqitur në dy kategori të cilat prekin drejtpërdrejt çështjet e konsumatorëve. Këto kategori janë:

- Kyçjet/lidhjet e reja;
- Pëlqime energjetike; dhe
- Ankesat e konsumatorëve.

6.8.3.1 Lidhjet e reja

Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, hyjnë edhe lidhjet e reja, përmes së cilave evidentohet se sa shpejtë ndërmarrja e energjisë merr masa për realizimin e kyçjeve/lidhjeve të reja.

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 29,655 kërkesa të rregullta për lidhje të re për grupet tarifore 4, 5, 6, 7 dhe 8, ndërsa janë aprovuar 25,128 apo 84.73% kërkesa për lidhje të reja e ku përfshihen edhe kërkesat e bartura nga viti paraprak, ndërsa pjesa e mbetur është në proces të regjistrimit. Duhet të ceket se kërkesa për lidhje të reja të bartura nga viti paraprak kanë qenë 10,441.

Nga të dhënat e KEDS-it, shihet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja më së shumti kërkesa ka pasur nga konsumatorët shtëpiak (grupi tarifor 5 dhe 6) 26,139 apo 88.14%, pasuar nga kërkesat për lidhje të reja të grupit tarifor komercial 0.4 kV Kategoria II – grupi tarifor 4 që kanë qenë 3,355 apo 11.31%, ndërsa kërkesa për grupit tarifor 8 - Ndriçimi publik kanë qenë 161 apo 0.54%.

Nga numri i përgjithshëm i regjistrimeve të aplikuesve si konsumatorë të Furnizuesit me Shërbim Universal në programin e faturimit “CCP”, konsumatorë shtëpiak janë 25,949 apo 86.44%, pasuar nga grupi tarifor 4 (0.4 kV Kategoria II – komercial) me 3,815 regjistrime apo 12.71%, si dhe grupi tarifor 8 (ndriçimi publik) me 255 regjistrime apo 0.85%.




Fig. 6.32 Lidhjet e reja sipas distrikteve për vitin 2025

Nga diagrami i mësipërm vërehet se për vitin 2025 nga numri i përgjithshëm i kërkesave për lidhje të reja, më së shumti kërkesa ka pasur në distriktin e Prishtinës prej 11,485 apo 38.73%, pasuar nga distrikti i Prizrenit prej 4,621 apo 15.58 %, ndërsa më së paku kërkesa për lidhje të reja janë regjistruar në distriktin e Mitrovicës prej 2,180 apo 7.35%. Gjithashtu, duhet theksuar se sa i përket regjistrimeve të kërkesave në programin e faturimit nga numri i përgjithshëm, më së shumti regjistrime ka qenë në distriktin e Prishtinës prej 11,880 apo 39.57%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 3,898 apo 12.99%, ndërsa më së paku regjistrime janë evidentuar në distriktin e Mitrovicës prej 2,067 apo 6.89 %.




Fig. 6.33 Lidhjet e reja sipas viteve

Nga diagrami i mësipërm vërehet se gjatë vitit 2025 ka pasur 3.14% më pak kërkesa për lidhje të reja se sa në vitin 2024, dhe 11.58% më shumë regjistrime të konsumatorëve se sa në vitin 2024.

6.8.3.2 Pëlqimet Elektroenergjetike

Nga të dhënat e prezantuara shihet se gjatë vitit 2025 në KEDS janë parashtruar 2,537 kërkesa për Pëlqime Elektroenergjetike, ndërsa të bartura nga viti 2024 kanë qenë 32 pëlqime.

Tab. 6.27 Pëlqimet Elektroenergjetike për vitin 2025

| Distriktet | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Gjithsej |
|-----------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|
| Prishtina | 45 | 40 | 48 | 59 | 45 | 61 | 58 | 53 | 67 | 60 | 64 | 63 | 663 |
| Mitrovica | 14 | 20 | 39 | 16 | 17 | 11 | 13 | 18 | 20 | 24 | 15 | 14 | 221 |
| Peja | 12 | 23 | 30 | 29 | 13 | 17 | 41 | 24 | 22 | 38 | 21 | 25 | 295 |
| Gjakova | 19 | 22 | 21 | 30 | 33 | 19 | 28 | 32 | 33 | 45 | 30 | 40 | 352 |
| Prizreni | 18 | 23 | 23 | 12 | 19 | 33 | 20 | 18 | 20 | 22 | 16 | 35 | 259 |
| Ferizaj | 45 | 38 | 37 | 45 | 39 | 44 | 50 | 49 | 53 | 53 | 37 | 38 | 528 |
| Gjilani | 21 | 9 | 18 | 21 | 14 | 16 | 18 | 20 | 18 | 23 | 25 | 16 | 219 |
| Gjithsej | 174 | 175 | 216 | 212 | 180 | 201 | 228 | 214 | 233 | 265 | 208 | 231 | 2,537 |


Nga tabela e mësipërme vërehet se nga numri i përgjithshëm i kërkesave për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2025, më së shumti kërkesa janë regjistruar në distriktin e Prishtinës dhe atë 663 apo shprehur në përqindje 26.13%, pasuar nga distrikti i Ferizajt prej 528 apo 20.81%, ndërsa më së paku kërkesa ka pasur në distriktin e Gjilanit prej 219 apo 8.63 %.

Tab. 6.28 Pëlqimet Elektroenergjetike sipas distrikteve për vitin 2025

| Distriktet | Kërkesa për PEE 2025 | Të shqyrtuara - PEE | Të shqyrtuara - Informatë | Të shqyrtuara - Përgjigje | Dërguar departamentev e tjera | Në proces |
|-----------------|----------------------|---------------------|---------------------------|---------------------------|-------------------------------|------------|
| Prishtina | 663 | 490 | 77 | 33 | 15 | 54 |
| Mitrovica | 221 | 170 | 24 | 10 | 8 | 12 |
| Peja | 295 | 200 | 53 | 20 | 6 | 22 |
| Gjakova | 352 | 246 | 66 | 17 | 6 | 19 |
| Prizreni | 259 | 203 | 38 | 10 | 2 | 12 |
| Ferizaj | 528 | 368 | 108 | 25 | 15 | 13 |
| Gjilani | 219 | 171 | 26 | 12 | 8 | 10 |
| Gjithsej | 2,537 | 1,848 | 392 | 127 | 60 | 142 |

Nga tabela e mësipërme vërehet se nga 2,537 kërkesa të aplikuesve për Pëlqim Elektroenergjetik për vitin 2025 dhe 32 të bartura nga viti 2024, janë shqyrtuar dhe lëshuar Pëlqime Elektroenergjetike për 1,848 kërkesa, 392 kërkesa janë shqyrtuar dhe është dhënë palëve Informatë lidhur me kërkesën e tyre për Pëlqim Elektroenergjetik, 127 kërkesa janë shqyrtuar dhe është dhënë palëve përgjigje ndërsa sipas të dhënave të KEDS-it 60 kërkesa tjera gjithashtu janë shqyrtuar, por që sipas departamentit të Pëlqimeve Elektroenergjetike në kuadër të KEDS-it është konstatuar se këtyre kërkesave nuk duhet t’iu lëshohet Pëlqimi Elektroenergjetik, por që këto kërkesa janë deleguar tek departamentet tjera dhe pjesa e mbetur prej 142 kërkesave janë në proces të shqyrtimit dhe të njëjtat do të shqyrtohen gjatë vitit 2025.

Më poshtë është paraqitur diagrami i kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike për periudhën sipas viteve 2014 – 2025, dhe nga diagrami shihet qartë se për çdo vit ka pasur rritje të kërkesave për Pëlqime Elektroenergjetike nga aplikuesit për kyçje, por që në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 kemi një rënie prej 282 aplikacioneve apo shprehur në përqindje 13.93%.


Fig. 6.34 Kërkesat për pëlqimet eektroenergjetike për periudhën 2014 – 2025

6.8.3.3 Ankesat e konsumatorëve të furnizuesi me Shërbim Universal - KESCO

Sipas të dhënave të raportuara të KESCO-s gjatë vitit 2025 numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruar në Departamentin për Konsumator në KESCO është 14,610 kurse të bartura nga viti i kaluar kanë qenë 5,079 ankesa, ndërsa të zgjidhura/përfunduara janë 12,529.

Më poshtë është paraqitur grafiku i ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura për vitin 2025 sipas distrikteve.




Fig. 6.35 Ankesat dhe numri i konsumatorëve sipas distrikteve, 2025

Nga figura e mësipërme shihet se numri më i madh i ankesave të konsumatorëve të regjistruara në KESCO gjatë vitit 2025 është në distriktin e Prishtinës 5,611 ankesa, pasuar nga distrikti i Pejës me 2,480 ankesa, ndërsa numri më i ulët i ankesave të regjistruara është në distriktin e Gjakovës prej 866 ankesa. Duhet theksuar se numri më i madh i ankesave në distriktin e Prishtinës është kryesisht për shkak se Distrikti i Prishtinës ka edhe numrin më të madh të konsumatorëve në Kosovë. Gjithashtu nga figura e mësipërme shihet se numri më i lartë i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura nga Departamentet e Konsumatorëve në KESCO në krahasim me numrin e ankesave të parashtruara në nivel të distrikteve është në distriktin e Mitrovicës prej 89%, pasuar nga distrikti i Pejës prej 88.31%, ndërsa më e ulëta është në distriktin e Gjakovës prej 78.52%.

Më poshtë është paraqitur raporti i ankesave të konsumatorëve të parashtruara në KESCO me numrin e konsumatorëve aktiv si dhe faturimit të kësaj periudhe sipas muajve.

Tab. 6.29 Raporti i ankesave dhe numrit të konsumatorëve sipas muajve për vitin 2025

| Muaji | Ankesa | Numri i faturave | Raporti ankesa/konsumator |
|-----------------|---------------|------------------|---------------------------|
| Janar | 1,748 | 730,957 | 0.24% |
| Shkurt | 1,284 | 733,109 | 0.18% |
| Mars | 1,066 | 734,898 | 0.15% |
| Prill | 944 | 737,253 | 0.13% |
| Maj | 816 | 739,010 | 0.11% |
| Qershor | 849 | 733,458 | 0.12% |
| Korrik | 1,139 | 732,868 | 0.16% |
| Gusht | 1,010 | 734,711 | 0.14% |
| Shtator | 1,033 | 736,941 | 0.14% |
| Tetor | 1,173 | 738,900 | 0.16% |
| Nëntor | 1,221 | 737,838 | 0.17% |
| Dhjetor | 2,327 | 739,450 | 0.31% |
| Gjithsej | 14,610 | 8,829,393 | 0.17% |

Nga tabela e mësipërme vërehet se numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2025 është 14,610 e që krahasuar me numrin e përgjithshëm të konsumatorëve aktiv paraqet 1.98% të numrit total të konsumatorëve të cilët kanë parashtruar ankesa, gjegjësisht 0.17% ndaj numrit të përgjithshëm të faturave vjetore të lëshuara nga furnizuesi me shërbim universal.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të regjistruara dhe të përfunduara sipas natyrës së ankesave për vitin 2025.




Fig. 6.36 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet e natyrës së ankesave të konsumatorëve të parashtruara te Furnizuesi - KESCO:

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet e natyrës së ankesave të konsumatorëve të parashtruara te Furnizuesi - KESCO:

B1 - Pagesë e pa regjistruar – kjo natyrë e ankesave ka të bëjë nëse konsumatori vë re se pagesa e bërë nga ai/ajo, nuk është regjistruar në llogarinë e tij (shifrën e tij), atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO, dhe të bëjë ankesë për pagesë të paregjistruar, duke bashkangjitur dëftesë-pagesën e tij dhe dëshmi të tjera.

B2 - Bilanci fillestar gabim - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë kur konsumatori ka vërejtur se gjatë bartjes së të dhënave fillestare është bërë gabim, dhe si të tillë kërkon që të përmirësohet bilanci fillestar.

B3 - Mosmarrja e faturave - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se faturat e energjisë elektrike nuk vijnë me rregull apo nuk vijnë fare, dhe mbi këtë bazë konsumatori duhet të parashtrorë ankesë në KESCO në mënyrë që kjo mos të ndodhë në të ardhmen.

B4 – Mbilimiti - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me ankesën e konsumatorit se është faturuar me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit.

B5 - Ndryshim i paushallit - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se në rastet kur një kohë konsumatori ka qenë duke u faturuar paushall/pa matje, dhe se tani i është vendosur njehsori elektrik, dhe konsumatori dëshiron të faturohet sipas matjes që i regjistrohen në njehsor.

B6 - Lexim jo korrekt - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se konsumatorit nuk i përputhet shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) i lexuar me shpenzimin e energjisë elektrike të faturuar, atëherë konsumatori duhet të parashtrorë ankesë ndaj kësaj natyre.

B7 - Lexim jo i rregullt - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se njehsori elektrik që regjistron energjinë e shpenzuar nuk është duke u lexuar me rregull, muaj për muaj, dhe rrjedhimisht kemi grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike vetëm në një faturë.

B8 - Njehsori jo i saktë - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë nëse konsumatori dyshon se njehsori bën matje jo të saktë, atëherë duhet të paraqitet në KESCO dhe të bëjë ankesë për mos matje të saktë të pikës matëse.

B9 - Kërkesa për shlyerje të borxhit - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse një konsumator ka privatizuar një ndërmarrje dhe në transaksionet e ndërmarrjes së privatizuar është një borxh që i takon ndërmarrjes së vjetër, atëherë duhet të kërkohet të shlyhet ky borxh dhe të ndërrohet emri, atëherë në këto raste konsumatori duhet të sjell të gjitha dokumentet e procesit të privatizimit dhe të dhënat e ndërmarrjes, në mënyrë që të procedohet me ankesë.

Sipas një vendimi të gjykatës, KESCO sh.a. është i obliguar që të bëjë shlyerjen e një borxhi në transaksionet e konsumatorit, atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Në rastet kur konsumatori ka pronë, që ka qenë e uzurpuar nga persona të ndryshëm dhe se kemi borxh të grumbulluar nga personat tjerë, atëherë konsumatori duhet të paraqitet në KESCO dhe me vete të sjell dokumentet e lëshuara nga Agjencioni Kosovar i Pronës, i cili dëshmon se prona ka qenë e uzurpuar dhe bazuar në dokumentet e siguruara konsumatori kërkon që të shlyhet borxhi i kontestuar, por që natyrisht borxhi i pakontestuar duhet të paguhet.

B10 - Shkyçja pa njoftim - Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse konsumatori vlerëson se i ka ndodhur një shkyçje nga rrjeti elektrik pa njoftim.

B11 - Të tjera – Kjo natyrë e ankesave ka të bëjë me atë se nëse asnjëra nga pikat e mësipërme nuk i përshatet konsumatorit, atëherë konsumatori duhet të shkruaj me fjalë ankesën e tij.

B12 – Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike (Rikthimi i humbjeve) – Kjo natyrë e ankesave të konsumatorëve ka të bëjë me ankesat të cilat ndërlidhen me shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, si shfrytëzimi i pa kontraktuar i energjisë elektrike, dhe vjedhja e energjisë elektrike.

Nga të dhënat e raportuara nga KESCO për vitin 2025, vërehet se nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve më së shumti ankesa ka pasur lidhur me faturat me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit prej 7,526 apo shprehur në përqindje prej 51.52%, ankesat lidhur me mos leximet e rregullta të shpenzimeve mujore prej 1,694 apo shprehur në përqindje prej 11.60%, pasuar nga ankesat lidhur me lexime jo korrekte prej 1,594 apo shprehur në përqindje prej 10.91%, ndërsa më së paku ankesa ka pasur lidhur me kërkesën për shlyerje të borxhit me vetëm 50 ankesa apo 0.34%.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga KESCO për ankesat e konsumatorëve, vërehet se ka rritje të numrit të ankesave në vitin 2025, e kjo rritje ka të bëjë përgjithësisht me faturat me mbi limit për shkak të gabimeve të leximit apo faturimit si dhe gabimet në lexim në pikën matëse (lexim jo korrekt dhe lexim jo i rregullt) dhe për shkak të mos leximeve të rregullta të shpenzimeve mujore. Në përgjithësi duhet theksuar se numri i ankesave të konsumatorëve lidhur me gabimet në lexim të pikës matëse është në rënie e sipër dhe kjo fal mënyrës së leximit të pikës matëse me anë të pajisjes së dorës (ang. “Hand Held Unit”), e cila ka përmirësuar dukshëm leximin e pikave matëse dhe ka zvogëluar mundësinë e gabimeve gjatë leximit të pikës matëse, ngase leximi dhe faturimi bëhet në të njëjtën kohë si dhe për shkak të leximeve nga distanca tek konsumatorët të cilët kanë të vendosur njehsorët e mençur.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave të zgjidhura nga KESCO për vitin 2025, apo më saktësisht statusi i ankesave të zgjidhura.




Fig. 6.37 Statusi i ankesave të konsumatorëve të zgjidhura për vitin 2025

Nga figura e mësipërme vërehet se KESCO nga 12,530 ankesa të zgjidhura të konsumatorëve, prej tyre 5,398 ankesa i ka aprovuar në favor të konsumatorëve apo 43.08%, ndërsa 7,132 i ka refuzuar, apo e shprehur në përqindje 56.92%.

Më poshtë është paraqitur diagrami me raportin e ankesave të paraqitura si dhe të zgjidhura tek furnizuesi me shërbim universal KESCO sipas viteve 2014-2025.




Fig. 6.38 Ankesat e konsumatorëve në KESCO sipas viteve

6.9 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Shoqëria Elektroserver” SHPK

Furnizuesi i energjisë elektrike “Shoqëria Elektroserver” SHPK si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike në katër komunat e pjesës veriore të Kosovës, ka filluar operimin në shkurt të vitit 2024.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën janar-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka 24,429 konsumatorë aktiv të cilët faturohen në baza të rregullta mujore. Po ashtu sipas të dhënave të dërguara vërtetohet se 1,086 konsumatorë janë të pasivizuar përkohësisht dhe 28 me pasivizim të përhershëm.

Nga numri i përgjithshëm i konsumatorëve të raportuar, 21,718 janë konsumatorë familjar ku përfshihet edhe faturimi i shpenzimeve të përbashkëta, si dhe 2,711 konsumatorë jo familjar ku përfshihet edhe ndriçimi publik. Nga ky numër i konsumatorëve vetëm 12,976 konsumatorë kanë të nënshkruar kontratë të furnizimit me energji elektrike.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i konsumatorëve si dhe faturave të lëshuara nga ky furnizues për periudhën janar-dhjetor 2025 për katër komunat.




Fig. 6.39 Numri i konsumatorëve të faturuar gjatë vitit 2025

Sipas të dhënave të raportuara mbi ankesat e pranuar nga konsumatorët të “Shoqëria Elektroserver” SHPK për vitin 2025, vërehet se numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruar në Departamentin për Konsumatorë është 16,879, dhe se të zgjidhura apo përfunduara janë të gjitha 16,879 ankesat.

Më poshtë është paraqitur grafiku i ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura sipas natyrës së ankesave për vitin 2025.




Fig. 6.40 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Nga të dhënat e raportuara, vërehet se nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve, më së shumti ankesa ka pasur lidhur me faturat për shkak të leximeve jo të sakta apo faturimit prej 11,020 apo shprehur në përqindje prej 65.29%, ankesat lidhur me transferimin dhe shlyerjen e borxhit

përmes kësteve prej 4,660 apo shprehur në përqindje 27.61%, ankesat lidhur me vonesat në regjistrimin e pagesave prej 786 apo shprehur në përqindje 4.66%, ankesat lidhur me pagesat jo të sakta, apo regjistrim jo i saktë i pagesave prej 381 apo shprehur në përqindje 2.26% si dhe ankesat lidhur me borxhe prej 32 apo shprehur në përqindje 0.19%. Sipas të dhënave të raportuara, vërtetohet se të gjitha ankesat e parashtruara nga konsumatorët janë të shqyrtuara dhe zgjidhura.

Ne figurën e mëposhtme janë paraqitur edhe thirrjet e pranuar në qendrën e thirrjeve të furnizuesit nga konsumatorët.




Fig. 6.41 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Grafiku paraqet kërkesat përmes qendrës së thirrjeve. Në total janë regjistruar 195 kërkesa. Pjesa më e madhe ndërlihet me verifikimin e vlerës së faturës (24 raste), ndërprerjet e energjisë elektrike (22 raste), pasojnë ankesat për mos pranim të faturave (11 raste) kurse më së paku ka kërkesa për sqarimin e faturave të energjisë elektrike

1.3.1 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “KESCO” SH.A

Furnizuesi i energjisë elektrike “KESCO” SH.A si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike, ka filluar operimin më herët, por që ka rritur aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e pa rregulluar nga periudha qershor të vitit 2025, përkatësisht pas hapjes së tregut të energjisë elektrike. Ky furnizues ka raportuar mbi numrin e konsumatorëve të regjistruar dhe faturuar si dhe numrin e ankesave të pranuar dhe zgjidhura për këtë periudhë kohore.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën qershor-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka 434 konsumatorë aktivë me të cilët ka të nënshkuara kontrata për furnizimin e 4,337 pikave matëse (shifrave).

Gjatë periudhës raportuese, furnizuesi i energjisë elektrike ka pranuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe ankesash nga konsumatorët, të cilat lidhen kryesisht me çështje të furnizimit me energji elektrike dhe shërbimeve kontraktuale.

Në total, janë regjistruar 4 ankesa në kategori të ndryshme. Nga ky numër, 2 raste janë përfunduar, ndërsa 2 raste janë në proces të shqyrtimit.

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur edhe thirrjet e pranuar në qendrën e thirrjeve të furnizuesit nga konsumatorët.




Fig. 6.42 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Figura paraqet kërkesat përmes qendrës së thirrjeve, me gjithsej 1,154 raste të regjistruara. Numri më i madh i kërkesave lidhet me informatat mbi mungesën e energjisë elektrike (354 raste), pasuar nga kërkesa për informata të tjera (241 raste) dhe mungesë faze (184 raste). Një numër i konsiderueshëm kërkesash lidhen edhe me Informata mbi prishje (182 raste). Më pak kërkesa janë regjistruar për Informata mbi ankesën me shkrim (1 rast), ankesa të tjera (8 raste) dhe ndërprerja e linjës telefonike nga pala (9 raste). Në përgjithësi, shumica e thirrjeve lidhen me probleme të furnizimit me energji dhe kërkesa për informacione.

6.10 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Korporata Energjetike Kosovës” SH.A

Furnizuesi i energjisë elektrike “Korporata Energjetike e Kosovës” - KEK si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike, ka filluar operimin me herët por që ka rritur aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga periudha qershor e vitit 2025 përkatësisht pas hapjes së tregut të energjisë elektrike. KEK ka raportuar mbi numrin e konsumatorëve të regjistruar dhe faturuar si dhe numrin e ankesave të pranuar dhe zgjidhura për këtë periudhë kohore.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën qershor-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka 158 konsumatorë me të cilët ka të nënshkruara kontrata për furnizimin e 3,967 pikave matëse (shifrave),

kurse si KEK FMF (Furnizues i Mundësisë së Fundit) ka raportuar se ka furnizuar më shumë se 8,000 pika matëse.

Gjatë periudhës raportuese, Furnizuesi i energjisë elektrike ka pranuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe ankesash nga konsumatorët, të cilat lidhen kryesisht me çështje të furnizimit me energji elektrike dhe shërbimeve kontraktuale.

Në total, janë regjistruar 614 kërkesa dhe ankesa në kategori të ndryshme. Nga ky numër, 389 raste janë përfunduar, ndërsa 201 raste janë në proces të shqyrtimit, apo shprehur në përqindje 63% e ankesave dhe kërkesave janë të përfunduara si rezultat i trajtimit nga furnizuesi.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave dhe kërkesave të paraqitura dhe zgjidhura nga furnizuesi KEK për vitin 2025 si dhe atyre që ende janë në proces.




Fig. 6.43 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Analiza e strukturës së ankesave tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre lidhet me çështje procedurale dhe informuese, të cilat janë trajtuar plotësisht nga furnizuesi. Konkretisht, kategoritë si kërkesat për faturë, kundërshtimet e faturave për shkak të kërkesave për kthim me çmime të rregulluara, kundërshtimet për dalje në treg, deklaratimet për furnizim nga KESCO, paqartësitë lidhur me tregun e hapur, si dhe kërkesat për sqarim rreth konsumit, tarifave dhe prosumerave-Vetë prodhuesit, janë përfunduar në masën 100%.

Megjithatë, raporti evidenton një numër të lartë rastesh në proces në disa kategori specifike. Problemi më i theksuar paraqitet të kontestimi i pikës matëse – jo shfrytëzues, ku nga 171 raste të regjistruara, 169 janë ende në proces. Po ashtu, vërehet ngarkesë e lartë edhe në rastet e faturimit të dyfishtë KESCO-KEK dhe në rastet kur konsumatorët deklarojnë se nuk kanë pikë matëse në emrin e tyre.

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur edhe thirrjet e pranuar në qendrën e thirrjeve të furnizuesit nga konsumatorët.




Fig. 6.44 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Grafiku paraqet kërkesat e regjistruara përmes qendrës së thirrjeve, me gjithsej 240 raste. Nga këto, 240 kërkesa lidhen me informata për ndërprerje të energjisë.

6.11 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “VoltKos” SHPK

Furnizuesi i energjisë elektrike “VoltKos” SHPK si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike, ka filluar operimin në qershor të vitit 2025 dhe ka raportuar mbi numrin e konsumatorëve të regjistruar dhe faturuar si dhe numrin e ankesave të pranuar dhe zgjidhura për këtë periudhë kohore.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën qershor-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka 72 konsumatorë me te cilët ka të nënshkruara kontrata për furnizimin e 608 pikave matëse (shifrave).

Gjatë periudhës raportuese, Furnizuesi i energjisë elektrike ka pranuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe ankesash nga konsumatorët, të cilat lidhen kryesisht me çështje të furnizimit me energji elektrike dhe shërbimeve kontraktuale.

Në total, janë regjistruar 34 kërkesa dhe ankesa në kategori të ndryshme. Këto kërkesa dhe ankesa kanë pasur të bëjnë kryesisht me ndërprerje e energjisë elektrike, probleme me furnizim-faza, probleme me trafo, tejkalime të fuqisë së kontraktuar, vonesa në ndërrimin e njehsorëve-zgjatje e procedurave për rritje të fuqisë, dëmtime të siguresave si dhe vizita nga punonjësit e OSSH si rrjedhojë e kërkesave të shkyçjes për shkak të borxheve të mëhershme ndaj furnizuesve paraprak.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave dhe kërkesave të parashtruara dhe zgjidhura nga furnizuesi VoltKos, si dhe atyre që janë në proces për vitin 2025.




Fig. 6.45 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Përveç dy kërkesave/ankesave, të gjitha kërkesat dhe ankesat e pranura gjatë kësaj periudhe janë trajtuar dhe mbyllur brenda afateve të përcaktuara ligjore, çka reflektohet nga përputhja e numrit të rasteve të pranura me ato të zgjidhura për secilën kategori.

Ne figurën e mëposhtme janë paraqitur edhe thirrjet e pranura ne qendrën e thirrjeve te furnizuesit nga konsumatorët.




Fig. 6.46 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Grafiku paraqet kërkesat përmes qendrës së thirrjeve, me gjithsej 149 raste të regjistruara. Numri më i madh i kërkesave lidhet me informatat për kohën e kthimit të furnizimit (56 raste), pasuar nga informatat mbi ndërprerjet e energjisë elektrike (40 raste) dhe informatat rreth faturave, vlerës së depozitës garantuese dhe vetë-prodhuesve (31 raste). Më pak kërkesa janë regjistruar për sqarim të procedurave (11), kërkesa për tarifa financiare (10) dhe informatë rreth mënyrës së furnizimit me rrymë (1 rast).



Fig. 6.48 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Grafiku paraqet kërkesat përmes qendrës së thirrjeve. Në total janë regjistruar 20 kërkesa. Pjesa më e madhe ndërlidhet me ndërprerjet e energjisë elektrike (9 raste), pasojnë ankesat për faturim nga furnizuesit paraprak (3 raste) dhe kërkesat për shtim të njëjësorëve në portofol (3 raste). Kërkesat për sqarim të faturimit të dyfishtë nga KESCO janë 2, ndërsa nga 1 rast është regjistruar për konfirmim të ndërrimit të furnizuesit, përjashtim të njëjësorëve nga portofoli dhe verifikim të shifrës.

6.13 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “EDS International KS”

Furnizuesi i energjisë elektrike “EDS International KS” SHPK si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike, ka filluar operimin me herët por që ka rritur aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga periudha qershor e vitit 2025 përkatësisht pas hapjes së tregut të energjisë elektrike . Ky furnizues ka raportuar mbi numrin e konsumatorëve të regjistruar dhe faturuar si dhe numrin e ankesave të pranuar dhe zgjidhura për këtë periudhë kohore.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën qershor-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka 19 konsumatorë me të cilët ka të nënshkruara kontrata për furnizimin e 191 pikave matëse (shifrave).

Gjatë periudhës raportuese, Furnizuesi i energjisë elektrike ka pranuar dhe trajtuar një numër të vogël kërkesash dhe ankesash nga konsumatorët, të cilat lidhen kryesisht me çështje të furnizimit me energji elektrike.

Në total, janë regjistruar 2 kërkesa dhe ankesa në kategori të ndryshme. Këto kërkesa dhe ankesa kanë pasur të bëjnë kryesisht me ndërprerje e energjisë elektrike si dhe sqarim lidhur me faturimin e energjisë elektrike në një pikë matëse.

Më poshtë është paraqitur figura me të dhënat e ankesave dhe kërkesave të parashtruara dhe zgjidhura nga furnizuesi EDS International KS për vitin 2025.




Fig. 6.49 Ankesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Të gjitha kërkesat dhe ankesat e pranuar gjatë kësaj periudhe janë trajtuar dhe mbyllur brenda afateve të përcaktuara ligjore, çka reflektohet nga përputhja e numrit të rasteve të pranuar me ato të zgjidhura për secilën kategori.

Ne figurën e mëposhtme janë paraqitur edhe thirrjet e pranuar në qendrën e thirrjeve të furnizuesit nga konsumatorët.




Fig. 6.50 Kërkesat e konsumatorëve përmes qendrës së thirrjeve

Grafiku paraqet kërkesat e regjistruara përmes qendrës së thirrjeve, me gjithsej 4 raste. Nga këto, 2 kërkesa lidhen me konfirmimin e shifrës, ndërsa 2 kërkesa me informata për ndërprerje të energjisë.

6.14 Raportimi i Furnizuesit të energjisë elektrike “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” SH.P.K”

Furnizuesi i energjisë elektrike “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” SH.P.K si furnizues i licencuar për furnizimin me energji elektrike, ka filluar operimin me herët. Ky furnizues ka raportuar mbi numrin e konsumatorëve të regjistruar dhe faturuar si dhe numrin e ankesave të pranuar dhe zgjidhura për këtë periudhë kohore.

Sipas të dhënave të dërguara për periudhën qershor-dhjetor 2025, vërtetohet se ky furnizues ka vetëm 2 konsumatorë me te cilët ka të nënshkruara kontrata për furnizimin e 2 pikave matëse (shifrave).

Po ashtu ka raportuar se përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ankesa si dhe kërkesa të raportuara nga konsumatorët.

6.15 Të dhënat e raportuara nga NQ Termokos

Nga të dhënat e raportuara nga Ngrohitorja e Qytetit NP Termokos SH.A., vihet re që, përgjatë vitit 2025, konsumatorët kanë parashtruar ankesa dhe kërkesa të ndryshme sa i përket shërbimeve që i ofron ndërmarrja, si: verifikim i cilësisë së ngrohjes, verifikim i sipërfaqes ngrohëse, kërkesa për ndërrimin e emrit të shifrës, kërkesa për intervenime të ndryshme, ankesa lidhur me faturimin pa matje, aplikime për lidhje të re, shkyçje dhe ri kyçje në sistemin e shpërndarjes etj.

Më poshtë është paraqitur diagrami me raportin e ankesave/kërkesave të parashtruara si dhe të zgjidhura tek ngrohitorja e qytetit Termokos gjatë vitit 2025.




Fig. 6.51 Ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Pra, nga sa mund të shihet, NQ Termokos përgjatë vitit 2025 i ka pranuar gjithsej 4,635 kërkesa dhe ankesa të konsumatorëve dhe se, gjithsej, 4,809 prej tyre janë shqyrtuar, ku përfshihen edhe kërkesa të bartura nga viti 2024 dhe konsumatorët kanë pranuar përgjigje në ankesat/kërkesat e tyre. Duhet theksuar se, kërkesa dhe ankesa të pashqyrtuara në total janë 815, por që, si të tilla do të trajtohen nga ndërmarrja dhe konsumatorët do të pranojnë Përgjigje.

Më tutje, nga NQ Termokos përgjatë këtij viti raportues, ka raportuar se ka lidhur 941 kontrata për furnizim me ngrohje, me konsumatorët familjar (amvisëri) ndërkaq, 147 kontrata për furnizim me ngrohje janë lidhur me konsumatorët jo familjar (biznesor).

6.16 Të dhënat e raportuara nga NQ Gjakova

Sipas të dhënave të raportuara nga NQ Gjakova, kyçje të reja për konsumatorë familjar (amvisëri) dhe jo familjar (biznesor) janë dhënë gjithsej 3. Më tej, kontrata të furnizimit me energji termike të lidhura ndërmjet ndërmarrjes dhe konsumatorëve, për këtë vit raportues janë 180. NQ Gjakova më tej ka aplikuar 134 shkyçje dhe ri kyçje të konsumatorëve. Tutje, numri i tërësishëm i ankesave të pranuar nga konsumatorët është 19 ankesa, e që ndërlidhen me mënyrën e faturimit, përkatësisht kalimit nga faturimi me matje në faturim me sipërfaqe.

Më poshtë është paraqitur diagrami me raportin e ankesave/kërkesave të parastruara si dhe të zgjidhura tek ngrohtorja e qytetit Gjakova gjatë vitit 2025.




Fig. 6.52 Ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve sipas natyrës për vitin 2025

Në ankesat e pranuar, përgjigje janë lëshuar gjithsej tridhjetë e pesë e që përfshinë një përgjigje të përbashkët, për një ankesë kolektive prej gjashtëdhjetë banorëve.

7 SEKTORI I ENERGJISË TERMIKE

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe në Zveçan. Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson afërsisht 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

7.1 Karakteristikat teknike të sistemeve të energjisë termike

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme të ngrohjes qendrore, me një kapacitet të instaluar prodhues që vlerësohet rreth 289 MW_{th}. Ngrohtorja Termomit në Mitrovicë dhe sistemi i ngrohjes në Zveçan, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përmbushin kërkesat për licencim, rregullim dhe monitorim nga ZRrE-ja, çka pamundëson sigurimin e të dhënave të azhurnuara dhe të besueshme. Për këtë arsye, në vijim paraqiten vetëm të dhëna të detajuara për NQ Termokos dhe NQ Gjakova.

7.1.1 Impiantet e prodhimit të energjisë termike

Impiantet për prodhimin e energjisë termike të NQ Termokos përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 120 MW_{TH}, si dhe ngrohtorja ndihmëse në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me kapacitet prej 14 MW_{TH}. Me vënien në funksion të stacionit të ekstraktimit të energjisë termike nga njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, këtij kapaciteti i është shtuar edhe kapaciteti i instaluar i ko-gjenerimit prej 140 MW_{TH}. Kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë dekomisionuar, për shkak se është planifikuar të shërbejnë si kapacitet rezervë për t'u aktivizuar në rast të avarive eventuale në njësitë e TC Kosova B. Mirëpo aktualisht këto impiante të prodhimit të energjisë termike nuk janë funksionale sepse stacioni i përgatitjes së lëndës djegëse – mazutit është demontuar për shkak të ndërtimit të objektit administrativ, dhe gjithashtu, ekspertiza teknike e ndërmarrë në vitin 2024 ka konstatuar se kaldajat kanë pësuar dëmtime të pariparueshme strukturale mekanike, elektrike dhe ndërtimore, dhe rrjedhimisht operimi i tyre i sigurt dhe efikas është i pamundur.

Ngrohtorja e re me biomasë e qytetit të Gjakovës është e pajisur me dy njësi për prodhimin e energjisë termike me kapacitet të instaluar 2×5.5 MW_{TH}, respektivisht 11 MW_{TH}, si dhe me një njësi ko-gjenerimi me kapacitet prodhimi të energjisë termike prej 4 MW_{TH} dhe energjisë elektrike prej 1.12 MW_{EL}. Në total, ngrohtorja e re me biomasë ka kapacitet të përgjithshëm të instaluar termik prej 15 MW_{TH}.

7.1.2 Sistemet e Shpërndarjes të Energjisë Termike

Sistemet e shpërndarjes së energjisë termike në Kosovë përbëhen nga rrjeti primar i shpërndarjes, i cili shtrihet deri në pikat e furnizimit në nënstacione, si dhe nga rrjeti sekondar, që shtrihet nga nënstacionet deri te shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Termokos ka një gjatësi traseje prej 58.5 km, përkatësisht një gjatësi tubacioni prej rreth 117 km. Pjesë integrale e këtij sistemi janë edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë, i vendosur në Bregun e Diellit, si dhe rreth 900 nënstacione aktive, të cilat përbëjnë pikat ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondar. Përveç rrjetit ekzistues të

shpërndarjes, funksionon edhe rrjeti i transportimit të energjisë termike nga TC Kosova B drejt NQ Termokos, me gjatësi rreth 10.5 km.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Gjakovës shtrihet në një gjatësi traseje prej rreth 23.5 km, përkatësisht me gjatësi tubacioni prej rreth 47 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 257 nënstatione aktive, të cilat shërbejnë si pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondar.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore të NQ Termokos dhe NQ Gjakova paraqitet në tabelën më poshtë.

Tab. 7.1 Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

| Kompania (Qyteti) | Kapaciteti i instaluar [MW _{TH}] | Kapaciteti operacional [MW _{TH}] | Rrjeti i energjisë termike | |
|-------------------------|---|---|--------------------------------------|---------------------------------------|
| | | | Gjatësia e rrjetit (trasesë) [km] | Nr. i nënstationeve |
| TERMOKOS (Prishtinë) | 2 x 58 = 116 | 2 x 49.3 = 98.6 | Rrjeti i shpërnd. | |
| | 2 x 7 = 14 | 2 x 6.3 = 12.6 | 58.5 | 920 |
| | 1 x 4 = 4 | 3.6 | Rrjeti i Transp. | (aktive-900) |
| | [Kogjenerimi] 2 x 70 = 140 | 2 x 68.7 = 137.4 | 10.5 | |
| Nën-total | 274.0 | 252.2 | 69.0 | 920 |
| NQ GJAKOVA (Gjakovë) | 2 x 5.5 = 11 | 2 x 5.5 = 11 | Rrjeti i shpërnd. | 390 |
| | [kogjenerimi*] 1 x 4 = 4 | [kogjenerimi*] 1 x 4 = 4 | 23.5 | (aktive-257) |
| Nën-total | 15.0 | 15.0 | 23.5 | 390 |
| Total | 289.0 | 267.2 | 92.5 | 1,310 (Aktive - 1,157) |

* 2 kaldataj e prodhimit të energjisë termike në Ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë funksionale

** Njësia e kogjenerimit e NQ Gjakova ka kapacitetin termik 4MW_{TH} dhe kapacitetin elektrik 1.12 MW_{EL}

7.2 Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë termike

Duke iu referuar zhvillimit të sektorit të energjisë termike në Kosovë në përgjithësi, vërehet se gjatë viteve të fundit ky sektor ka filluar të trajtohet në mënyrë më strategjike dhe të koordinuar në nivel kombëtar. Me përfundimin e hartimit të Studimit të fizibilitetit për zhvillimin e sistemeve të reja të energjisë termike (ngrohjes qendrore) në disa qytete të Kosovës është shënuar një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Studimi është zhvilluar në kuadër të platformës WBIF, me Bankën Evropiane për Investim si institucion udhëheqës financiar, dhe ka analizuar aspektet teknike, ekonomike dhe financiare të krijimit dhe funksionalizimit të sistemeve të ngrohjes qendrore në nivel komunal.

Studimi ka përfshirë analizën e potencialit për zhvillimin e sistemeve të energjisë termike në tetë qytete të Kosovës, përkatësisht në Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Drenas, Obiliq dhe Zveçan, duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe të ardhshme për ngrohje, strukturën urbane, burimet e mundshme të energjisë, si dhe kostot dhe përfitimet afatgjata të investimeve të tilla. Rezultatet e këtij studimi ofrojnë një bazë të rëndësishme analitike për vendimmarrje në lidhje me zgjerimin e sektorit të energjisë termike në Kosovë dhe për orientimin e investimeve publike dhe private në këtë fushë.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i sektorit të energjisë termike në Kosovë pritet të bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi, duke u fokusuar në zgjidhje që kontribuojnë në rritjen e sigurisë energjetike dhe në diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji. Në veçanti, zgjerimi i sistemeve të ngrohjes qendrore parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në sektorin rezidencial dhe atë publik, duke lehtësuar ngarkesën mbi sistemin elektroenergetik, sidomos gjatë periudhave të pikut dimëror.

Njëkohësisht, zhvillimi i këtij sektori pritet të ketë ndikim pozitiv në mbrojtjen e mjedisit, përmes zvogëlimit të emetimeve ndotëse dhe përmirësimit të efijencës së përgjithshme energjetike. Integrimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përdorimi i teknologjive më efikase dhe zbatimi i standardeve moderne të menaxhimit të sistemeve të energjisë termike do të kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare për efijencë të energjisë dhe tranzicion energjetik të qëndrueshëm në Kosovë.

7.2.1 Zhvillimet në NQ Termokos

Përgjithësisht në vitin 2025 operimi i sistemit të NQ “Termokos” është zhvilluar në kushte teknikisht stabile dhe pa ndërprerje në furnizim. I gjithë furnizimi me energji termike është realizuar përmes ko-gjenerimit nga TC Kosova B, ndërsa impiantet me mazut nuk janë aktivizuar fare. Kjo përbën një zhvillim të rëndësishëm operativ, pasi dëshmon funksionalitetin dhe besueshmërinë e sistemit të ko-gjenerimit si burim primar i ngrohjes për Prishtinën.

Prodhimi total i energjisë termike nga pajisjet e ko-gjenerimit në TC Kosova B ka arritur mbi 362 GWh, ndërsa energjia neto e pranuar nga Termokos pas humbjeve në transport ka qenë rreth 355 GWh. Furnizimi real i konsumatorëve ka qenë rreth 326 GWh, çka përfaqëson një sezon me volum të lartë operimi dhe ngarkesë të qëndrueshme në rrjet.

Një nga zhvillimet më pozitive të këtij sezoni lidhet me menaxhimin e humbjeve teknike. Humbjet në rrjetin e transportit KEK–Termokos kanë qenë konstante rreth 2% gjatë gjithë sezonit, pa devijime mujore, duke reflektuar stabilitet hidraulik operim të mirë të infrastrukturës transportuese. E njëjta mund të konstatohet edhe për rrjetin e shpërndarjes, ku kryesisht ka pasur operim stabil me një nivel të humbjeve teknike prej 6.53%, që në terma praktikë, kjo tregon se rrjeti i shpërndarjes është në gjendje të mirë teknike, dhe investimet e viteve të fundit në rehabilitim dhe zgjerim kanë dhënë efekt të drejtpërdrejtë.



Zhvillimi më i ndjeshëm dhe njëkohësisht më sfidues në vitin 2025 ka qenë implementimi i projektit “Prishtina Heat Save” dhe ndikimi i tij në sistemin e faturimit, ku kanë qenë të përfshirë mbi 18,500.

Gjatë këtij viti, Termokos ka raportuar të dhëna të matjes në nivel apartamenti për rreth 12,500 konsumatorë, përmes alokatorëve dhe njehsorëve të energjisë termike. Kjo përfaqëson një hap të madh strukturor drejt faturimit të bazuar në

konsum real, në përputhje me politikat e efijencës së energjisë. Megjithatë, implementimi ka qenë i

pjesëshëm dhe teknikisht jo plotësisht i konsoliduar. Një pjesë e objekteve të përfshira në projekt nuk kanë arritur të kalojnë plotësisht në faturim sipas konsumit për shkak të:

- instalimeve të papërfunduara,
- problemeve në leximin e të dhënave dhe llogaritjes së konsumit individual sipas metodologjisë,
- dhe nevojës për ndërhyrje shtesë teknike.

Si rezultat, gjatë këtij viti ka vazhduar të implementohen dy lloje të faturimit: faturimi sipas sipërfaqes ngrohëse dhe faturimi sipas konsumit të matur, gjë që ka krijuar kompleksitet operacional dhe pakënaqësi te një pjesë e konsumatorëve.

Gjatë këtij viti janë realizuar 854 kycje të reja, me mbi 72,600 m² sipërfaqe të re ngrohëse, kryesisht në sektorin banesor. Janë lidhur gjithsej 1,037 kontrata të reja furnizimi, që tregon vazhdimësi të zgjerimit të shërbimit dhe interes të qëndrueshëm për ngrohjen qendrore, ndërsa nga aspekti financiarë ka sjellë rritje të të hyrave nga shitja e energjisë termike (ngrohjes).

Megjithatë, përkundër rritjes së faturimit, arkëtimi ka mbetur problematik. Rënia e shkallës së arkëtitimit, krahasuar me vitet/sezonet paraprake, paraqet një nga rreziqet kryesore për likuiditetin e ndërmarrjes dhe kërkon adresim serioz në sezonet e ardhshme, veçanërisht në kontekstin e investimeve kapitale të mëdha që janë në proces.

Janë realizuar 465 çkycje, kryesisht me kërkesë të konsumatorëve, ndërsa janë realizuar 753 rikycje, me sipërfaqe dukshëm më të madhe se ajo e çkycur, duke reflektuar rikthim të besimit në shërbim. Sa i përket ankesave, janë trajtuar mbi 3,300 ankesa dhe kërkesa, kryesisht për verifikim cilësie dhe sipërfaqe, ku shumica dërrmuese janë zgjidhur brenda sezonit.

Sezoni 2024/2025 ka qenë kryesisht aktiv në aspektin e investimeve dhe projekteve zhvillimore.

→ *Projekti “Prishtina Heat Save”*

Projekti për instalimin e matësve të energjisë termike “Prishtina Heat Save” është financuar nga Qeveria Amerikane përmes MCC me 10.9 milionë dollarë grant, nga Komuna e Prishtinës me 2 milionë euro dhe nga NP “Termokos” sh.a. me 1 milion euro si bashkëfinancues. Kontrata për zbatimin e projektit është nënshkruar në prill 2022 ndërmjet Millennium Foundation Kosovo (MFK) dhe kontraktorit “ENERCO LLC” sh.p.k. – Prishtinë, ndërsa implementimi ka filluar më 27.07.2022. Pas nëntorit 2022, bazuar në Marrëveshjen Trepalëshe ndërmjet MCC, Komunës së Prishtinës dhe NP “Termokos” sh.a., projekti ka kaluar në përgjegjësi të Termokos-it, me fondet e mbetura të MCC të menaxhuara nga Njësia e Implementimit të Projektit, e integruar në strukturën e Termokos-it deri në përfundim të projektit; vlera e fazës së parë ka qenë 12,910,384.18 euro dhe ka përfunduar në janar 2025.

Faza e dytë e projektit për vitin 2025 është menduar të financohet nga Termokos me 1 milion euro dhe parashikohej të përfshihen e rreth 2,500 konsumatorëve të rinj, ndërkohë që po shqyrtohen mundësi për sigurimin e donatorëve shtesë me qëllim zgjerimin e projektit në të gjitha zonat e mbuluara me rrjet të ngrohjes qendrore, për të mundësuar faturimin sipas konsumit real. Projekti përfshin mirëmbajtjen dhe instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese në objektet ku instalimet nuk janë përfunduar në fazën e parë, si dhe vazhdimin e instalimeve në objekte të reja brenda kufijve të buxhetit, ndërsa gjatë periudhës shkurt 2025 – prill 2025 janë realizuar punime në terren që

përfshijnë gjithsej 1,572 njësi banesore, me instalimin e 1,535 alokatorëve të nxehtësisë dhe 268 njehsorëve të energjisë termike në lagjet Kodra e Diellit, Dardania, Kalabria, Mati 1, Qendra dhe Ulpiana.

→ *Projekti “Solar 4 Kosova II”*

Projekti “Solar 4 Kosova II” është projekti më i madh në Ballkan dhe i dyti në Evropë, pas Danimarkës, në fushën e prodhimit të energjisë termike nga energjia diellore. Projekti përfshin ndërtimin e një impianti solar termik dhe integrimin e tij në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore, përfshirë zgjerimin e rrjetit deri në 50 MW.

Kostoja totale e projektit parashihet të jetë rreth 80.7 milionë Euro. Financimi do të sigurohet nga Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) me 53.1 milionë euro (21.5 milionë euro grant dhe 31.6 milionë euro kredi), nga BERZH me 23.2 milionë euro kredi, si dhe nga NP “Termokos” sh.a. me 4.4 milionë euro si bashkëfinancues.

Në kuadër të zhvillimeve të projektit, janë përfunduar studimi i fizibilitetit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), është definuar dhe aprovuar lokacioni në zonën Hade e Re (25 ha), si dhe është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente dhe mbikëqyrëse të projektit.

Gjatë vitit 2025 periudhës raportuese janë realizuar dhe janë në proces këto aktivitete kryesore: sigurimi i pëlqimeve elektroenergjetike nga KEDS dhe kushteve të kyçjes në rrjetin e ujësjellësit, aprovimi i PPR-së (“Planing Project Report” – Raporti i Planifikimit të Projektit) dhe në parim i Masterplanit të ri të zgjerimit të rrjetit, aprovimi nga KfW i Termave të Referencës dhe nisja e procesit të parakualifikimit, përgatitja e dizajnit të optimizuar të impiantit solar termik, shpallja e tenderit për Lotin 1 në janar 2025, si dhe zhvillimi i procedurave për shpronësim dhe lejeve përkatëse. Aktualisht është në zhvillim procesi i vlerësimit të aplikacioneve për parakualifikim për tenderin “Solar 4 Kosova II”.

→ *Projekti për ndërtimin e infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmeues të kogjenerimit në 240 MW_{TH} (2025-2029)*

Projekti për zgjerimin e kapaciteteve gjeneruese në 240–280 MW_{TH} ndodhet në fazë përgatitore, me studime të avancuara, dizajne teknike dhe diskutime për financim me EIB, Bashkimin Europian dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Projekti është pjesë e Masterplanit për zgjerimin e rrjetit dhe parashikon dyfishimin e kapaciteteve gjeneruese nga 140 në 280 MW_{TH}, me burim Termocentralin “Kosova B”.

Vlera totale e projektit parashihet të jetë 63.4 milionë euro, me financim të planifikuar nga: EIB (31.7 milionë euro kredi), Komisioni European – IPA (17.6 milionë euro grant), Qeveria e Republikës së Kosovës (9.0 milionë euro) dhe NP “Termokos” sh.a. (5.1 milionë euro bashkëfinancim).



Nga kapaciteti shtesë prej 140 MW_{TH}, 40 MW_{TH} do t’i dedikohen komunës së Obiliqit, ndërsa 100 MW_{TH} do të mbesin për NP “Termokos” sh.a.

Zhvillimet kryesore të deritanishme përfshijnë: nënshkrimin e marrëveshjes me EIB në qershor 2022 për financimin e studimeve paraprake (1.5 milionë euro), angazhimin e konsorciumit “Tetra Tech” si kompani konsulente, aprovimin e Planit të Dekarbonizimit në janar 2024, prezantimin e trasës së rrjetit TC “Kosova B” – Termokos, definimin e lokacionit për HRS-2 dhe prezantimin e kalkulimit bazë hidraulik të rrjetit transmetues, përfshirë kyçjen për komunën e Obiliqit dhe impiantin solar.

Në tërësi, mund të konstatohet se sistemi i ngrohjes qendrore në Prishtinë operon në mënyrë të qëndrueshme nga aspekti teknik dhe po hyn në një fazë të rëndësishme transformimi përmes investimeve kapitale me vlera të konsiderueshme. Megjithatë, sfidat që lidhen me funksionalizimin e plotë të matjes së konsumit, përmirësimin e arkëtimit, disiplinën financiare dhe planifikimin realist të kostove mbeten kritike për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe për realizimin e plotë të potencialit të këtyre investimeve në vitet e ardhshme.

7.2.2 Zhvillimet në NQ Gjakova



Në vitin 2025 NQ Gjakova përgjithësisht ka arritur të stabilizoj furnizimin e konsumatorëve me ngrohje duke arritur një operim të qëndrueshëm të prodhimit të energjisë termike nga biomasa rrejtit të shpërndarjes.

Lidhur me matjen e furnizimit/konsumit të ngrohjes, duhet theksuar se në kuadër të projektit të SECO-s janë instaluar matës të energjisë termike në shumicën e nënstacioneve dhe ky fakt ka ndikuar

pozitivisht në matjen e konsumit/furnizimit; megjithatë matja në nënstacione nuk është e plotë për shkak se për rreth 50 nënstacione nuk është regjistruar matja e konsumit për arsye se ose nuk janë të pajisura me matës ose matësit nuk kanë funksionuar për shkaqe teknike, çka ka pamundësuar llogaritjen e plotë të humbjeve sasiore të energjisë termike. Megjithatë mund të konstatohet se operimi i sistemit është teknikisht stabil, me sfidë kryesore kompletimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemit të matjes.

Është me rëndësi të theksohet se në tetor 2025 është aktivizuar, për herë të parë pas instalimit, njësia e ko-gjenerimit duke mundësuar një prodhim të njëkohshëm të energjisë termike dhe elektrike.

Gjatë këtij viti nuk ka pasur ndonjë zhvillim sa i përket projekteve zhvillimore investive, të cilat konsiderohen të nevojshme sidomos për zgjerim të rrjetit dhe shtimin e konsumatorëve shfrytëzues të ngrohjes.

7.3 Performanca e ndërmarrjeve të energjisë termike

Gjatë sezonit të ngrohjes 2024/2025, NQ Termokos ka siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me energji termike gjatë 24 orëve, duke konfirmuar stabilitetin operacional të sistemit. Kjo është arritur falë funksionimit të besueshëm të impianteve të kogjenerimit në TC Kosova B, si dhe përmirësimeve të realizuara përmes investimeve në rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike.

Në NQ Gjakovë, gjatë sezonit të ngrohjes 2024/2025, janë vënë në funksion njësitë për prodhimin vetëm të energjisë termike. Sezoni i furnizimit ka nisur me kohë, më 15 tetor 2024, duke eliminuar vonesat e evidentuara në sezonin paraprak, dhe furnizimi është zhvilluar në mënyrë stabile gjatë gjithë periudhës së ngrohjes. Ky rezultat është mundësuar nga sigurimi në kohë dhe në sasi të mjaftueshme i lëndës djegëse, përkatësisht biomasës.

7.3.1 Prodhimi, furnizimi dhe humbjet në sistem

NQ Termokos

- Prodhimi i energjisë termike

Gjatë sezonit 2024/2025, NQ Termokos e ka bazuar prodhimin e energjisë termike ekskluzivisht në impiantet e ko-gjenerimit në TC Kosova B. Ngjashëm me sezonin paraprak, prodhimi i energjisë termike nga ngrohtorja e NQ Termokos nuk është realizuar, ndërsa i gjithë furnizimi është siguruar përmes sistemit të ko-gjenerimit.

Sasia e energjisë termike e ekstraktuar nga kogjenerimi në sezonin 2024/2025 ka qenë **362,547 MWH_{TH}**, që është 32,930 MWH_{TH} dhe 10% krahasuar me sezonin e kaluar (329,617 MWH_{TH}). Ndërsa sasia e energjisë termike e pranuar në stacionin e shkëmbimit të nxehtësisë në NQ Termokos ka qenë **355,297 MWH_{TH}**, që gjithashtu shënon një ndryshim prej 32,272 MWH_{TH} ose 10% krahasuar me sezonin e kaluar (323,025 MWH_{TH}).

Të dhënat e përmbledhura të prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi për sezonin 2024/2025 paraqiten në tabelën vijuese:

Tab. 7.2 Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi

| Energjia Termike nga Kogjenerimi – NQ Termokos, Sezoni 2024/2025 | | | |
|--|-------------------------|--|---|
| Muaji | Njësia | En.term. e ekstraktuar (matur në TC Kosova B)/Prodhimi Bruto | En.term. e pranuar (matur në NQ Termokos)/Prodhimi neto |
| Tetor 24 | MWh _{TH} | 24,259 | 23,774 |
| Nentor 24 | MWh _{TH} | 59,257 | 58,072 |
| Dhjetor 24 | MWh _{TH} | 70,453 | 69,044 |
| Janar 25 | MWh _{TH} | 72,911 | 71,453 |
| Shkurt 25 | MWh _{TH} | 64,016 | 62,736 |
| Mars 25 | MWh _{TH} | 50,972 | 49,953 |
| Prill 25 | MWh _{TH} | 20,679 | 20,265 |
| Gjithsej | MWh_{TH} | 362,547 | 355,297 |

- Furnizimi me energji termike

Gjatë sezonit 2024/2025, NQ Termokos ka vazhduar të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor të energjisë termike, duke u mbështetur kryesisht në përmirësimin e vazhdueshëm të prodhimit, mirëmbajtjen e rrjetit dhe rehabilitimet e kryera.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike (ngrohje qendrore) gjatë këtij sezoni ka qenë **331,824 MWh_{TH}**, që shënon një ndryshim prej 46,096 MWh_{TH} dhe 16 % krahasuar me sezonin 2023/2024 (285,728 MWh_{TH}). Ky nivel furnizimi konsiderohet i kënaqshëm dhe i përputhshëm me objektivat e planifikuara për një furnizim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm.

- Humbjet në sistem

Sistemi i energjisë termike i NQ Termokos ka karakteristikat e veta lidhur me humbjet në sistem, për shkak të integritetit të energjisë termike nga ko-gjenerimi. Humbjet në rrjet përbëhen nga dy komponentë: humbjet në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos dhe humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes.

Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos, me gjatësi 10.5 km, janë përcaktuar përmes matjeve të kryera në stacionin e ekstraktimit në TC Kosova B dhe stacionin e pranimin në NQ Termokos. Gjatë sezonit 2024/2025, humbjet sasiore në këtë rrjet kanë qenë **7,250 MWh_{TH}** ose **2%** llogaritur në totalin e prodhimit bruto.

Në tabelën vijuese paraqiten detaje të mëtejshme për humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike për këtë sezon.

Tab. 7.3 Energjia termike dhe humbjet e në rrjetin e transmetimit TC Kosova B – NQ Termokos– sezoni 2024/2025

| Humbjet në rrjetin e trans. En. Term. Sezoni 2024-2025 | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Total |
|---|--------|--------|---------|--------|--------|--------|--------|---------|
| Energjia termike e ekstraktuar - matur në TC Kosova B [MWh] | 24,259 | 59,257 | 70,453 | 72,911 | 64,016 | 50,972 | 20,679 | 362,547 |
| Energjia termike e pranuar - matur në NQ Termokos [MWh] | 23,774 | 58,072 | 69,044 | 71,453 | 62,736 | 49,953 | 20,265 | 355,297 |
| Humbjet në sasi të energjisë [MWh] | 485 | 1,185 | 1,409 | 1,458 | 1,280 | 1,019 | 414 | 7,250 |
| Humbjet në [%] | 2.00% | 2.00% | 2.00% | 2.00% | 2.00% | 2.00% | 2.00% | 2.00% |

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes së energjisë termike zakonisht përcaktohen mbi bazën e matjeve të energjisë termike në hyrje të rrjetit të shpërndarjes dhe sasisë së energjisë termike të furnizuar në nënstacionet e konsumatorëve. Megjithatë, për shkak të mungesës së matjes së plotë të furnizimit në nivel nënstacionesh, përlogaritja e furnizimit është realizuar përmes përafrimeve, duke u bazuar kryesisht në parametrat si kërkesa specifike për kapacitet ngrohës (W/m^2) dhe orët e ngarkesës së plotë, përkatësisht konsumi specifik (kWh/m^2).

Vlera e përlogaritur e konsumit për sezonin 2024/2025 është **331,824 MWh_{TH}**. Duke zbritur këtë vlerë nga sasia e energjisë termike të futur në rrjetin e shpërndarjes **354,998 MWh_{TH}**, rezulton se humbjet sasiore në rrjetin primar të shpërndarjes për këtë sezon janë **23,174 MWh_{TH}**, që në përqindje përfaqëson 6.53 %.

Ky rezultat lidhet kryesisht me ndikimin e projekteve të rehabilitimit të rrjetit të shpërndarjes, përfshirë zëvendësimin e segmenteve të amortizuara të tubacioneve, si dhe me përmirësimet e realizuara në nënstacionet termike.

Në tabelën vijuese paraqiten të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet totale të energjisë termike, si në rrjetin e transportimit ashtu edhe në rrjetin e shpërndarjes:

Tab. 7.4 Performanca energjetike e NQ Termokos – sezoni 2024/2025

| NQ Termokos - Sezoni i Ngrohjes 2024/2025 | | |
|---|----------------------|---------|
| Përshkrimi | Njësia | Vlera |
| Prodhiimi bruto në stabilimentet e ngrohtores | [MWh _{th}] | 0 |
| Prodhiimi bruto në stabilimentet e kogjenerimit | [MWh _{th}] | 362,547 |
| Humbja sasiore në rrjetin e transportit (TC Kosova B - NQ Termokos) | [MWh _{th}] | 7,250 |
| Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit | [%] | 2.00 |
| Konsumi vetanak | [MWh _{th}] | 299 |
| Prodhiimi neto i energjisë termike | [MWh _{th}] | 354,998 |
| Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes | [MWh _{th}] | 23,174 |
| Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes | [%] | 6.53 |
| Furnizimi i konsumatorëve me energji termike | [MWh _{th}] | 331,824 |

NQ Gjakova

- Prodhiimi i energjisë termike

Në sezonin 2024/2025, NQ Gjakova ka vazhduar operimin komercial të ngrohtores së re me biomasë. Pavarësisht përmirësimeve në organizimin e furnizimit, prodhimi i energjisë termike ka qenë i kushtëzuar nga disponueshmëria e lëndës djegëse. Prodhimi bruto i energjisë termike në këtë sezon ka qenë 20,244 MWh_{TH} që paraqet një ndryshim prej 2,548 MWh_{TH} dhe 14 % krahasuar me sezonin paraprak 17,696 MWh_{TH}, ndërsa prodhimi neto i energjisë termike ka arritur 20,184 MWh_{TH}.

Për realizimin e këtij niveli prodhimi gjatë sezonit 2024/2025 janë shpenzuar 10,800 ton lëndë djegëse – biomasë.

- **Furnizimi me ngrohje**

Gjatë sezonit 2024/2025, NQ Gjakova ka realizuar furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm me energji termike për konsumatorët. Furnizimi është zhvilluar pa ndërprerje dhe ka vazhduar deri në përfundimin zyrtar të sezonit të ngrohjes, në përputhje me planifikimin e paraparë.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike gjatë këtij sezoni ka qenë 19,866 MWh_{TH}, që paraqet një ndryshim prej 4,726 MWh_{TH} (rreth 30%) krahasuar me sezonin paraprak 15,140 MWh_{TH}.

- **Humbjet në sistem**

Sa i përket humbjeve në prodhimin e energjisë termike, fillimisht duhet theksuar se pajisjet matëse në impiantet e ngrohtores së re janë të instaluar. Megjithatë, është e nevojshme të sigurohet leximi i saktë i këtyre pajisjeve, si dhe përpunimi dhe raportimi korrekt i të dhënave të prodhimit të energjisë termike. Sipas raportimeve të ndërmarrjes, efikasiteti i kaldajave për prodhimin e energjisë termike vlerësohet rreth 85%, çka nënkupton humbje gjatë procesit të shndërrimit të energjisë së lëndës djegëse në energji termike, të vlerësuara në 3,513 MWh_{TH}.

Humbjet në rrjetin primar të shpërndarjes përcaktohen si diferenca ndërmjet sasisë së energjisë termike të futur në rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë së energjisë termike të furnizuar/konsumuar. Në mungesë të matjes së drejtpërdrejtë të furnizimit në nivel nënstationesh, përlllogaritja e konsumit është realizuar përmes përafrimeve, duke u bazuar kryesisht në parametrat si kërkesa specifike për kapacitet ngrohës (W/m²) dhe orët e ngarkesës së plotë, përkatësisht konsumi specifik (kWh/m²).

Në tabelën vijuese paraqiten të dhënat e përmbledhura për prodhimin, furnizimin dhe humbjet e energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes:

Tab. 7.5 Performanca energjetike e NQ Gjakova – sezoni 2024/2025

| NQ Gjakova - Sezoni i Ngrohjes 2024-2025 | | |
|---|--------------------------|--------|
| Përshkrimi | Njësia | Vlera |
| Sasia e lendës djegëse -biomasë | [ton] | 10,800 |
| Vlera kalorifike | [MWh _{th} /ton] | 2.6 |
| Energjia e futur nga lënda djegëse - biomasa | [MWh _{th}] | 28,018 |
| Efikasiteti i kalidajave | [%] | 84% |
| Prodhimi bruto i energjisë termike | [MWh _{th}] | 23,439 |
| Konsumi vetanak | [MWh _{th}] | 60 |
| Prodhimi neto i en.termike / Energjia e futur në rrjetin e shpërndarjes | [MWh _{th}] | 23,379 |
| Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes | [MWh _{th}] | 3,513 |
| Humbjet në përqindje | % | 15% |
| Furnizimi i konsumatorëve me energji termike | [MWh _{th}] | 19,866 |

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e prodhimit, furnizimit dhe humbjeve në sistem të përmbledhura për tërë sektorin e energjisë termike.

Tab. 7.6 Performanca energjetike e sektorit të energjisë termike – sezoni 2024/2025

| Sektor i Energjisë Termike - Sezoni 2024/2025 | | | | |
|--|----------------------|-------------|------------|----------|
| Përshkrimi | Njësia | NQ Termokos | NQ Gjakova | Gjithsej |
| Prodhimi bruto i energjisë termike | [MWh _{th}] | 362,547 | 23,439 | 385,986 |
| Humbjet sasiore në rrjetin e transportit | [MWh _{th}] | 7,250 | - | 7,250 |
| Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit | [%] | 2.00 | 0.00 | 2.00 |
| Konsumi vetanak | [MWh _{th}] | 299 | 60 | 359 |
| Prodhimi neto i energjise termike | [MWh _{th}] | 354,998 | 23,379 | 378,377 |
| Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes | [MWh _{th}] | 23,174 | 3,513 | 26,687 |
| Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes | [%] | 6.53 | 15.03 | 7.05 |
| Furnizimi i konsumatorëve me energji termike | [MWh _{th}] | 331,824 | 19,866 | 351,690 |

7.4 Faturimi, arkëtimi dhe sipërfaqja e ngrohjes

7.4.1 Faturimi dhe arkëtimi

Sa i përket faturimit për ngrohjen e furnizuar duhet përmendur se, krahas faturimit sipas sipërfaqes ngrohëse, në sezonën 2024 /2025 ka filluar implementimi i faturimit bazuar në matjen e konsumit. Konkretisht, në NQ Termokos numri i konsumatorëve të faturuar me matje ka qenë afërsisht 50% nga numri i tërësishëm i konsumatorëve, ndërsa në NQ Gjakova, për dallim nga sezoni i kaluar këtë sezonë numri i konsumatorëve të faturuar me matje ka qenë rreth 60%.

NQ Termokos, gjatë sezonit 2024/2025, ka shënuar një rritje të faturimit krahasuar me sezonin paraprak, kryesisht si rezultat i shtimit të numrit të konsumatorëve dhe rritjes së sipërfaqes ngrohëse, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të furnizimit. Faturimi total i realizuar në këtë sezon ka qenë **10,395,032 €**, që paraqet një ndryshim prej 641,486 € dhe rreth 7 % krahasuar me sezonin 2023/2024 (9,753,546 €). Nga faturimi total i realizuar gjatë sezonit 2024/2025, vlera e faturuar pa matje ka qenë

4,968,833 € (48%) dhe vlera e faturuar me matje 5,426,199 € (52 %). Raporti ndërmjet faturimit me matje dhe pa matje, si dhe vlerat respektive, janë paraqitur në diagramin më poshtë.




Fig. 7.1 Pjesëmarrja e vlerave të faturimit me matje dhe pa matje në faturimin total

NQ Termokos në sezonin 2024/2025 ka arkëtuar shumën prej **6,631,648 €** që paraqet shkallën e përgjithshme të arkëtimit prej **63.80%**. Duhet theksuar se niveli i arkëtimit është më i ulët krahasuar me sezonin e kaluar 2023/2024 ku përqindja e arkëtimit ishte 68.89%. Duhet përmendur se në këtë sezonë arkëtimi i pagesave nga grupi i konsumatorëve shtëpiak është më i ulët (55.61%) për dallim nga sezoni i kaluar (58.85%); përderisa arkëtimi i pagesave të Konsumatorëve komercial e institucional ka qenë 76.17%.

Tek NQ Gjakova gjatë sezonit 2024/2025 faturimi ka qenë– **919,819 €**, ndërsa arkëtimi si shumë monetare ka arritur vlerën prej **663,252€**, që paraqet një shkallë të arkëtimit prej 72.11%.

Detajet në lidhje me faturimin dhe arkëtimin janë treguar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tab. 7.7 Faturimi dhe arkëtimi– sezoni 2024/2025

| Sezoni i ngrohjes 2024/2025 | Sipërfaqja ngrohëse [m ²] | Pjesëmarrja në përqindje | Faturimi [€] | Arkëtimi [€] | Shkalla e arkëtimit [%] |
|--------------------------------|---------------------------------------|--------------------------|--------------|--------------|-------------------------|
| NQ "Termokos" Prishtina | | | | | |
| Amvisëri | 1,427,341 | 65.28% | 6,255,502 | 3,478,627 | 55.61% |
| Komercial e Institucional | 759,113 | 34.72% | 4,139,530 | 3,153,021 | 76.17% |
| Gjithsej | 2,186,454 | 100.00% | 10,395,032 | 6,631,648 | 63.80% |
| NQ "Gjakova" Gjakovë | | | | | |
| Amvisëri | 48,521 | 32.15% | - | - | - |
| Komercial e Institucional | 102,402 | 67.85% | - | - | - |
| Gjithsej | 150,923 | 100.00% | 919,811 | 663,252 | 72.11% |




Fig. 7.2 Faturimi dhe arkëtimi NQ Termokos – sezoni 2024/2025

7.4.2 Sipërfaqja për ngrohje

Në sezonën 2024/2025 NQ Termokos ka pasur sipërfaqen e përgjithshme ngrohëse të konsumatorëve prej **2,186,454 m²**, që ndahet në grupet e konsumatorëve të amvisërisë dhe komercial e institucional sipas proporcionit 65% : 35%.

Ndërsa sipërfaqja totale ngrohëse e NQ Gjakova është **150,923 m²**, e ndarë në proporcionin rreth 80% konsumatorët e amvisërisë dhe rreth 20% konsumatorët komercial e institucional.

Në grafikët e mëposhtëm paraqiten sipërfaqet ngrohëse të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, të ndara sipas grupeve të konsumatorëve.




Fig. 7.3 Sipërfaqja ngrohëse sipas grupeve të konsumatorëve në sezonin 2024/2025

Adresa e Rregullatorit

Zyra e Rregullatorit për Energji

Rruga: Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës), Kati 2

Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 247 615

Fax: +383 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Tel: +383 (0) 38 247 615 lok. 101

Sekretaria:

Tel: + 383 (0) 38 247 615 lok. 104

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:

Tel. + 383 (0) 38 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org